



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS**

---

**RAPORT AUDITIMI PERFORMANCE**

**“Efektiviteti i masave të marra për mbrojtjen e konsumatorit nga abuzimet me peshën dhe matjet”**





## RAPORT AUDITIMI PERFORMANCE

### **“Efektiviteti i masave të marra për mbrojtjen e konsumatorit nga abuzimet me peshën dhe matjet”**

---

Auditimi është kryer në bazë të programit të auditimit nr.612/2 prot., datë 29.07.2021, miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Faza studimore e auditimit nisi në datë 07.06.2021 me shkresën nr.612 prot., datë 27.05.2021, ËNjoftim për fillim Projekt Auditimi Performance dhe përfundoi me hartimin e programit të cituar më lart.

Faza e terrenit të auditimit nisi më datë 29.07.2021 dhe përfundoi më 22.10.2021.

Projekt Raporti i Auditimit mori formë përfundimtare dhe me shkresat nr.612/4 dhe nr.612/5 prot., datë 23.11.2021, iu përcoll subjekteve të audituara.

Në respektim të afatit 1-mujor, grupi i auditimit priti observacionet nga subjektet nën auditim. Nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë u paraqitën observacione me shkresën nr.612/7 prot., datë 28.12.2021, si dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë u paraqitën observacione me shkresën nr.612/6 prot., datë 24.12.2021, trajtuar në Kapitullin ËShtojca/Anekseë nr.1.

Dosja audituese kaloi në filtrin e Kryeaudituesit dhe Drejtorit të Departamentit të Auditimit të Performancës, Drejtorisë së Kontrollit të Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë, Drejtorit të Përgjithshëm dhe më pas iu përcoll Kryetarit për Vendimin Përfundimtar.



<b>PËRMBAJTJA</b>		<b>Faqe</b>
<b>1.</b>	<b>PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDIMIT</b>	<b>5</b>
1.1	Konteksti i Problemit Social	5
1.2	Rëndësia e auditimit të performancës	6
<b>2.</b>	<b>SUBJEKTI/ET NËN AUDITIM</b>	<b>6</b>
2.1	Hyrje në subjektet nën auditim	6
2.2	Politikat e subjektit	10
2.3	Rëndësia e produkteve të subjektit	10
2.4	Pesha në buxhet	10
2.5	Risqet e aktivitetit të subjektit	12
2.6	Feedback-u i subjektit përgjatë gjithë auditimit	15
<b>3.</b>	<b>QASJA DHE DETAJET E AUDITIMIT</b>	<b>15</b>
3.1	Fokusimi dhe përkufizimi i problemit	15
3.2	Objektivi i auditimit	16
3.3	Piramida e pyetjeve audituese	16
3.4	Kriteret	17
3.5	Qasja/metodologjia e auditimit	19
<b>4.</b>	<b>SHTJELLIMI I PYETJEVE DHE NËNPYETJEVE</b>	<b>19</b>
4.1	A ka qenë efektiv sistemi i metrologjisë në mbrojtjen e konsumatorëve nga abuzimet me peshën dhe matjet, përgjatë periudhës 2018-2020?	19
4.1.1	A kanë rezultuar efektive politikat dhe masat e marra nga MFE për garantimin e mbrotjes së konsumatorit nga abuzimet me peshën dhe matjet?	19
4.1.1.1	A është hartuar nga MFE dhe DPM, kuadri rregullator në përputhje me standartet e BE për metrologjinë?	20
4.1.1.2	A ka qenë efektive MFE në mbështetjen financiare të DPM-së, për zhvillimin e sistemit të metrologjisë?	33
4.1.2	A kanë qenë efektive masat e marra nga DPM për mbrotjen e konsumatorit nga abuzimet me peshën dhe matjen?	37
4.1.2.1	A janë realizuar objektivat strategjike për metrologjinë nga DPM?	38
4.1.2.2	A janë mirëadministruar burimet njerëzore dhe financiare nga DPM në funksion të realizimit të objektivave institucional?	40
4.1.2.3	A ka ndikuar në mbrojtjen e konsumatorëve veprimtaria e metrologjisë ligjore pranë DPM?	43
4.1.2.4	A ka qenë efektiv bashkëpunimi ndërinstitucional i DPM?	56
<b>5.</b>	<b>PËRMBLEDHJA</b>	<b>58</b>
<b>6.</b>	<b>SHTOJCAT/ANEKSE</b>	<b>60</b>
<b>7.</b>	<b>GRUPI I PUNËS DHE PËRGJEGJËSITË HIERARKIKE</b>	<b>83</b>



### Lista e shkurttimeve

<b>AK</b>	Autoriteti Kontraktor
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>BIPB</b>	(Bureau International des Poids et Mesures) Byroja Ndërkombëtare e Peshave dhe Masave
<b>DML</b>	Drejtoria e Metrologjisë Ligjore
<b>DMSHI</b>	Drejtoria e Metrologjisë Shkencore dhe Industriale
<b>DPA</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit
<b>DPD</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
<b>DPM</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë
<b>DPS</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit
<b>DPT</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
<b>DSC&amp;P</b>	Drejtoria e Sigurimit të Cilësisë dhe Parapaketimeve
<b>EA</b>	European Accreditation Akreditimi Evropian
<b>MLA</b>	Multilateral Agreement Marrëveshja shumëpalëshe
<b>EURAMET</b>	(European Association of National Metrology Institutes) Shoqata Evropiane e Insiteuteve Kombëtare të Metrologjisë
<b>EUROSAI</b>	European Organization of Supreme Audit Institutions (Organizata Evropiane e Insiteucioneve Supreme të Auditimit)
<b>IC</b>	Infrastruktura e Cilësisë
<b>ILAC</b>	Organizata Ndërkombëtare për Akreditimin e Laboratorëve
<b>INTOSAI</b>	The International Organisation of Supreme Audit Institutions (Organizata Ndërkombëtare e Insiteucioneve Supreme të Auditimit)
<b>IRR</b>	Norma e Brendshme e Kthimit
<b>ISHMT</b>	Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut
<b>ISHTI</b>	Inspektorati Shtetëror Teknik Industrial
<b>ISSAI</b>	International Standards of Supreme Audit Institutions (Standardet Ndërkombëtare të Insiteucioneve Supreme të Auditimit)
<b>KLSH</b>	Kontrolli i Lartë i Shtetit
<b>KMK</b>	Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorit
<b>MBZHR</b>	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
<b>METE</b>	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
<b>MFE</b>	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
<b>MSHMS</b>	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
<b>MZHETTS</b>	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes
<b>NIST</b>	National Institute of Standards and Technology Instituti Kombëtar i Standardeve dhe Teknologjisë
<b>NPV</b>	Vlera Aktuale Neto
<b>OIML</b>	Organisation Internationale de Métrologie Légale (Organizata Ndërkombëtare e Metrologjisë Ligjore)
<b>PBA</b>	Planifikimi Buxhetor Afatmesëm
<b>PBB</b>	Prodhimi i Brendshëm Bruto
<b>RSH</b>	Republika e Shqipërisë
<b>SI</b>	Sistemi Ndërkombëtar i Njësi (International System of Units)
<b>TVSH</b>	Tatimi mbi vlerën e shtuar
<b>VKM</b>	Vendim i Këshillit të Ministrave
<b>WELMEC</b>	Western European Legal Metrology Cooperation (Bashkëpunimi i Metrologjisë Ligjore për Evropën Perëndimore)



## 1. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDIMIT

### 1.1 KONTEKSTI I PROBLEMIT SOCIAL

Në një shoqëri të tregut të lirë, cilësia dhe siguria e produkteve, merret përsipër nga sektori privat, si dhe tregu vendos rregullat e prodhimit dhe tregtisë. Megjithatë, në praktikë çdo vend ka një sektor publik dhe shteti rregullon disa aktivitete të sektorit privat, veçanërisht në fushat e prodhimit, shërbimeve dhe tregtisë. Çështja është se, cilat fusha rregullohen dhe në çmënyrë rregullohen ato. Në botën globale, kjo krijon probleme pasi rregulla të ndryshme në vende të ndryshme sjellin vështirësi për prodhuesit dhe tregtarët ndërkufitarë. Në këto kushte, është shumë i rëndësishëm fakti që të gjitha vendet tregtuese të kenë një sistem eficient rregullator teknik, i cili kërkon dy elemente thelbësore, rregulla dhe monitorim. Nga njëra anë, kjo kërkohej me synim mbrojtjen e konsumatorit dhe shtetit dhe nga ana tjetër heqjen e kufizimeve të panevojshme për të bërë biznes dhe tregti të lirë. Ky optimizim i rregullave teknike varet gjerësisht nga infrastruktura e cilësisë që disponohet, e cila ka disa element kyç si, standardizimi, **metrologjia (matja)**, akreditimi, testim-certifikimi, vlerësimi i konformitetit. Pikërisht kjo infrastrukturë përbën themelin e reformave në tregun brendshëm, të cilat krijojnë premisat për vendime të rëndësishme lidhur me cilësinë e jetës së qytetarëve, në lidhje me mbrojtjen e shëndetit, ambientit, sigurinë e përgjithshme teknike, mbrojtjen e interesave ekonomike të konsumatorit dhe të sektorit privat, në lidhje me cilësinë e produkteve dhe shërbimeve të prodhuara në Shqipëri.

Në jetën tonë të përditshme, jo në pak raste vihen re disa probleme të saktësisë së matjes, të cilat veç ose së bashku, në marrëdhëniet midis palëve (institucione publike me njëra tjetrën, institucione publike me subjekte private, ndërmjet subjekteve tregëtare dhe konsumatorit, ose ndërmjet dy subjekteve tregëtare), mund të sjellin efekte negative social-ekonomike.

Konkretisht, disa probleme të saktësisë së matjes, mund të krijohen në:

- Produktet e shportës së konsumit, që ne blejmë, mund të ndodh që po të peshosh bukën, mishin, etj., do të rezultojë se ka diferencë ndërmjet asaj që e quajmë òpeshë, sasi nominale me peshën apo sasinë e vërtetë;
- Shkëmbimet tregtare ndërmjet tregtarëve të shumicës dhe pakicës, përdorimi i instrumentave matës (peshore të ndryshme) të pasakta, bën që palët në transaksione të bëhen njëkohësisht subjekt dhe objekt i matjeve të pasakta dhe çdo tregtar do të bazohet mbi atë që blen me apo pa dashje, duke u transformuar në vjedhje ose abuzim për konsumatorin final;
- Fushën e mjekësisë, si pasojë e mos verifikimit dhe kalibrimit të aparateve dhe pajisjeve mjekësore, si p.sh, aparaturat me lazer dhe ultratinguj, aparatet optike, termometri i blerë në farmaci, etj, mund të ndikojë negativisht në shëndetin e konsumatorit dhe rritjen e kostove financiare;
- Matjen e saktë të konsumit të energjisë elektrike apo ujit, kohës telefonike që ne konsumojmë, ndikon direkt në rritjen e kostove financiare për konsumatorin;
- Matjen e saktë të sasisë së furnizimit me karburant, ku si pasojë e përdorimit të një instrumenti matës të pasaktë, rriten kostot financiare, pasi shpenzojmë për një sasi të caktuar karburanti, ndërkohë mund të ndodhë që faktikisht të furnizohemi me më pak sasi;
- Pajisjet e rendit dhe sigurisë publike, radarët e matjes së shpejtësisë apo analizuesit e pranisë së alkoolit që përdor policia rrugore gjenerojnë matje, dhe gabimi i këtyre instrumentave matës ndikon direkt vendimmarrjen e autoriteteve publike, si dhe për rrjedhojë në kostot sociale dhe ekonomike të konsumatorit.
- Pajisjet që shërbejnë për matjen e zhurmave, ndotjes së mjedisit, të cilat ndikojnë në mënyrën e të jetuarit dhe shëndetin e njeriut.

Për ta ilustruar me disa fakte konkrete, nga informacioni i publikuar në faqen zyrtare të institucionit që kryen inspektime në fushën e metrologjisë (Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut), rezulton se përgjatë periudhës 2018-2020, janë kontrolluar gjithësej 9361 produkte (instrumenta matës dhe parapaketime), nga të cilat kanë dalë jo sipas parametrave 529 produkte, ku peshën kryesore të të cilave e zënë parapaketimet (produktet e ndryshme të paketuara që blenë konsumatori) me 403 produkte dhe pjesën e mbetur e zënë instrumentat matës (taksimetra,



shpërndarës karburanti, peshore) me 126 produkte.<sup>1</sup> Nga këto të dhëna rezulton se numri i produkteve jo në rregull, ka ardhur në rënie, respektivisht në vitin 2018 - 422 produkte; vitin 2019 ó 68 produkte dhe vitin 2020 ó 39 produkte, por duhet marrë në konsideratë fakti se, edhe numri i produkteve të inspektuara përgjatë periudhës 2018-2020 ka ardhur në rënie, rreth 1,000 produkte më pak, të inspektuara.

Në këto kushte krijohet nevoja e sigurimit dhe përdorimit të një sistemi kombëtar metrologjie, i cili duhet të zhvillohet dhe t'aj shërbejë mbrojtjes së konsumatorit.

## 1.2 RËNDËSIA E AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

Auditimi është një pjesë thelbësore e procesit të llogaridhënies për shpenzimin e parave publike, duke dhënë kështu një kontribut të rëndësishëm për miradministrimin e burimeve dhe kryerjen e shërbimeve për qytetarët. Nëpërmjet auditimit të performancës bëhet një ekzaminim i pavarur për të kuptuar nëse angazhimet qeveritare, operacionet, programet, aktivitetet apo institucionet e saj janë duke vepruar në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efijencës dhe efektivitetit dhe nëse ka vend për përmirësim, në aktivitetin e tyre. Kontrolli i Lartë i Shtetit auditon midis të tjerave veprimtarinë ekonomiko-financiare të institucioneve shtetërore e të personave të tjerë juridikë publikë, për të evidentuar nëse aktiviteti i tyre ka rezultuar me efektivitet, efijencë dhe ekonomicitet, duke rekomanduar masat e duhura për përmirësimin e performancës së tyre. Veç këtyre nëpërmjet auditimit, KLSH bën transparente përdorimin e fondeve publike, administrimin e pronës publike dhe ligjshmërinë e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, procedurat, legalizimet, kryerjen në kohë e me cilësi dhe kosto optimale të shërbimeve publike, etj.<sup>2</sup>

Kryerja e auditimeve në përgjithësi dhe atyre të performancës në veçanti nga KLSH, bëhet në përputhje të plotë me standardet INTOSAI dhe me objektivat e Strategjisë për Zhvillim të EUROSIAI 2017-2023. Sipas kësaj strategjie, KLSH ka për objektiv rritjen e cilësisë së auditimit dhe shtimin e numrit të auditimeve të performancës, nëpërmjet audituesve të përgatitur dhe të mirë-trajnuar. Tematika e auditimeve të performancës nis me përzgjedhjen e propozimeve për auditim që në vitin paraardhës, në zbatim të Manualit të Auditimit të Departamentit të Performancës, i miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr.78, datë 30.06.2020<sup>3</sup>.

Si konsumatorë dhe taksapagues, qytetarët shqiptar janë të interesuar të marrin shërbimet e duhura në kohë, me cilësi dhe kosto optimale nga institucionet administratës publike. Veç kësaj, konsumatorët janë të mbrojtur me ligj, jo vetëm për të marrë shërbime me cilësi, por në të njëjtën kohë, midis të tjerave kanë të drejtën e mbrojtjes së shëndetit, mjedisit dhe sigurisë së jetës, si dhe të drejtën e mbrojtjes së interesave ekonomikë etj.<sup>4</sup>

Në këtë kuadër është evidentuar dhe nevoja e **auditimit të efektivitetit** të masave të marra nga MFE dhe DPM për mbrojtjen e konsumatorëve nga abuzimet me peshën dhe matjet.

Bazuar në sa më sipër, si dhe në faktin që Kontrolli i Lartë i Shtetit, në përputhje me funksionin e tij kushtetues, ka për kompetencë auditimin me qëllim mbrojtjen e interesave publike, rritjen e cilësisë së shërbimit publik të ofruar, pa cenuar kostot financiare të ofrimit të tij, Departamenti i Auditimit të Performancës në KLSH, do të kryejë Auditimin e Performancës së masave të marra për mbrojtjen e konsumatorëve nga abuzimet me peshën dhe matjet, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë.

## 2.2. SUBJEKTET NËN AUDITIM

### 2.1 HYRJE NË SUBJEKTET NËN AUDITIM

Metrologjia në Shqipëri i ka fillimet e veta në vitin 1946 me themelimin e Drejtorisë së Kontrollit të Instrumenteve Matëse, duke krijuar për herë të parë një strukturë përgjegjëse për peshat dhe masat, e fokusuar kryesisht në metrologjinë ligjore. Në vitin 2003 u krijua Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Kalibrimit, dhe në muajin **Gusht të vitit 2008** Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë. Në vijim ky institucion, për shkak të ndryshimeve ligjore, ka patur ndryshime në

<sup>1</sup> <http://ishmt.gov.al/raporte-vjetore-2/>

<sup>2</sup> Neni 6 i Ligjit nr.154/2014 òPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit

<sup>3</sup> Manuali i Auditimit të Performancës

<sup>4</sup> Ligji nr. 9902, datë 17.04.2008 òPër mbrojtjen e konsumatorëve, neni 4




funksionimin e tij, konkretisht atij iu hoq funksioni i inspektimit metrologjik, i cili i kaloi si kompetencë Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut.

### Subjektet nën auditim ishin Ministria e Financave dhe Ekonomisë, si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë.

Aktualisht DPM është në varësi të MFE dhe aktivitetin e saj përgjatë periudhës 2018-2020, e ka zhvilluar në mbështetje të Ligjit nr.9875, datë 14.02.2008 òPër metrologjinë të ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij. DPM është përgjegjëse për metrologjinë shkencore, industriale dhe ligjore.

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj DPM ka për detyrë të ruajë dhe përdorë etalonet kombëtare të njësisve të matjeve, të ofrojë shërbime të verifikimit e të kalibrimit të prodhuesve dhe përdoruesve të mjeteve matëse, autorizimit të subjekteve private për kryerjen e shërbimeve metrologjike, si dhe monitorimin e tyre. òShtëpia e metrologjisë e përfaqësuar nga DPM në vendin tonë është ndërtuar mbi bazën e katër shtyllave kryesore dhe 19 drejtimeve, të cilat shërbejnë për të pasur një sistem të metrologjisë në përgjigje të sfidave që përballet ekonomia e vendit tonë, pasqyruar në skemën nr.1, si më poshtë.

Skema nr.1 Sistemi i Metrologjisë në Shqipëri



Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

#### Sa më sipër:

1. *Strategjia ligjore e zhvillimit të metrologjisë.* Ka filluar me Ligjin nr.9875, datë 14.02.2008, òPër Metrologjinë, i ndryshuar. Rregullore e brendshme e DPM-së nr.104/1, datë 07.02.2014. Në vitin 2020 është miratuar Ligji i ri për Metrologjinë nr.126/2020, datë 15.10.2020, aktualisht në fuqi, si



dhe janë në proces hartimi dhe miratimi aktet nënligjore për zbatimin e tij.

Në vitin 2008 është miratuar Strategjia afat gjatë kombëtare 2008-2022 e zhvillimit të Metrologjisë, duke vijuar me miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Konsumatorëve 2020.

2. *Metrologjia shkencore, industriale dhe ligjore.* Metrologjia industriale merret me matjet në prodhim dhe kontrollin e cilësisë. Metrologjia Shkencore është ajo pjesë e metrologjisë që përfshin problemet e përgjithshme teorike dhe praktike në lidhje me njësitë e matjes. Metrologjia ligjore është ajo pjesë e metrologjisë e cila i nënshtrohet kontrollit ligjor/rregullator.


3. *Qeverisja.* Për shkak të ndikimit që masat ligjore të metrologjisë kanë në shoqëri dhe pasojat potenciale politike, qeverisja e DPM është e centralizuar. Drejtori ka një lidhje të drejtpërdrejtë të komunikimit me Ministrin përkatës të MFE. Drejtori i DPM-së është përgjegjës para nivelit më të lartë të drejtimit të MFE, pra Ministrit dhe/Sekretarit të Përgjithshëm, i cili është përgjegjës për strategjinë dhe mbikëqyrjen financiare të aktivitetit të DPM-së.

4. *Qëndrueshmëria financiare.* DPM duke qenë një organ rregullator, si autoriteti ligjor dhe shkencor i metrologjisë, financohet nga buxheti i shtetit. Gjithashtu DPM krijon të ardhura nga shërbimet që kryen ndaj të tretëve si, miratimi i tipit, kalibrimi dhe verifikimi, të cilat duhet të paguhen nga klientët, sipas tarifave të miratuara<sup>5</sup>. Nga të ardhurat që realizon DPM, ajo ka të drejtë që të përdorë deri në 10,000,000 lekë si burim financiar për mbulimin e shpenzimeve të disa prej aktiviteteve të saj.

5. *Drejtori i DPM* është përgjegjës për ekzekutimin e përgjegjësive të autoritetit ligjor të metrologjisë siç parashikohet në legjislacionin përkatës, si dhe për zbatimin e planeve të zhvillimit vjetore e afatmesëm të saj. Përfëqëson DPM-në, propozon strukturën organizative dhe organikën e DPM-së, përgjigjet para Ministrit të MFE-së, drejton ngritjen, funksionimin dhe përmirësimin e sistemit të cilësisë në DPM etj.

6. *Struktura organizative,* pasqyruar si më poshtë:

Skema nr.2 Struktura e DPM



Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Drejtorja e Përgjithshme e Metrologjisë është e organizuar dhe funksionon sipas Vendimit të

<sup>5</sup> Udhëzim nr. 2, datë 08.2.2013 ëPër tarifatat dhe pagesat e shërbimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, i ndryshuar





Këshillit të Ministrave nr.1576 datë 17.10.2008 òPër organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, të ndryshuar, si dhe struktura e saj është e miratuar me Urdhrit të Kryeministrit nr.23, datë 23.02.2012, òPër miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë.

Referuar Urdhrit të mësipërm DPM ka në strukturë 105 punonjës dhe është e organizuar në drejtori si më poshtë vijon:

- Drejtoria e Metrologjisë Shkencore dhe Industriale (DMSHI), me 5 sektor.
- Drejtoria e Metrologjisë Ligjore (DML) me 4 sektor rajonal, përkatësisht në Tiranë, Fier, Lezhë dhe Korçë.
- Drejtoria e Sigurimit të Cilësisë dhe Parapaketimeve (DSC&P) me 2 sektor në qendër.
- Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve (DBNJ&SH) me 3 sektor në qendër.

7. *Ndërtesat dhe zyrat qendrore të DPM.*

8. *DPM ka në administrim pajisjet e nevojshme për zbatimin e kërkesave ligjore të metrologjisë, të cilat mbulojnë një gamë të gjerë të instrumenteve matëse të shpërndarë në laboratore deri tek metrologët verifikues.*

9. *Dokumentimi i menaxhimit të cilësisë.* DPM zotëron praktikë të mirë për të vepruar në përputhje me një sistem formal të menaxhimit të cilësisë. Kjo përfshin pajtueshmërinë me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare ISO/IEC 17025 lidhur me shërbimet e kalibrimit laboratorik.

10. *Stafi teknik i metrologjisë shkencore dhe ligjore.* Stafi i përfshirë në testim, kalibrimin dhe verifikimin ligjor të metrologjisë duhet të kenë arsimin e duhur, të trajnohen dhe të kenë përvojë në mënyrë, që të kryejnë me përgjegjshmëri detyrat e tyre funksionale.

11. *Miratimi i tipit të instrumenteve matëse.* Është themelore që një instrument matës i përdorur në aktivitetet e mbuluara nga legjislacioni ligjor i metrologjisë duhet të testohet kundrejt standardeve të përcaktuara dhe të jetë tip i miratuar para se të tregtohet/markuar me shenjën CE. Lloji i instrumentit testohet sipas një rregulloreje teknike të përcaktuar, ose standardeve kombëtare. DPM administron disa akte rregullatore për kryerjen e këtij funksioni.

12. *Shërbimet e kalibrimit dhe verifikimit.* DPM ofron shërbime kalibrimi dhe verifikimi për matjen e instrumenteve brenda fushëveprimit të rregulloreve ligjore të metrologjisë për aq sa ato nuk ofrohen nga subjektet juridike private. Këto shërbime verifikimi të instrumenteve matës ofrohen për rreth 30,000 - 50,000 produkte nga vetë DPM. Gjithashtu DPM, monitoron subjektet private të autorizuar, të cilët mbulojnë një gamë deri 600,000 instrumente matës (kontatorët familjarë të energjisë, kontatorët e ujit, shpërndarësit e karburantit dhe të gazit të lëngshëm).

13. *Subjekte private të autorizuar për riparime të instrumenteve matës.* DPM autorizon subjekte private kompetente në fushat përkatëse për shërbime të riparimit të instrumenteve matëse, si dhe është përgjegjëse për monitorimin e aktivitetit të tyre.

14. *Mbikëqyrja e tregut (Inspektimi).* Autoriteti për inspektimet në fushën e metrologjisë është Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, i cili është i pavarur nga DPM dhe që duhet të operojë dhe ndërtojë një sistem efikas të mbikëqyrjes së tregut.

15. *Sistemi i trajnimit.* Metrologët ligjorë të trajnuar dhe të kualifikuar janë një komponent vital i një sistemi efektiv dhe eficient të metrologjisë. Në DPM mungon një plan trajnimesh, për metrologët ligjorë në vecanti, metrologët e subjekteve private të autorizuar, ndërsa metrologët e metrologjisë shkencore marrin pjesë në trajnime dhe krahasime ndërlaboratorike të matjeve etj.

16. *Bashkëpunimi me organizatat rajonale.* Është e rëndësishme nëse DPM është anëtar i një organi rajonal/më gjerë të metrologjisë. DPM është anëtarë me të drejta të plota në: Organizatën e Instituteve Kombëtare të Metrologjisë (EURAMET) që nga data 26.05.2010; Konferencën e Përgjithshme të Peshave GCPM që nga data 07.10.2007; Organizatës së Bashkëpunimit Evropian në Metrologjinë Ligjore (WELMEC). Gjithashtu DPM kryen pjesëmarrje periodike në ndërkrahasime laboratorike në nivel Evropian.

17. *Ndërlidhësi me organizatat ndërkombëtare.* Sistemi i certifikimit OIML u jep furnizuesve të instrumenteve matëse mundësinë e marrjes së një certifikate OIML. Këto certifikata mund të pranohen për qëllime të miratimit të llojit/tipit nga autoriteti kombëtar i metrologjisë ligjore, DPM.

18. *Koordinimi brenda sistemit të cilësisë.* Për DPM është e rëndësishme për të siguruar që masat ligjore të metrologjisë të integrohen në mënyrë të përsosur me masat kombëtare të



standardizimit/me fjalë të tjera, standardet kombëtare të matjes dhe akreditimi përdoren në mënyrë optimale në zbatimin e legjislacionit ligjor të metrologjisë me MFE, MSHMS, MBZHR, DPA, ISHMT.

19. *Forumi Konsultativ*. Palët e interesuara luajnë një rol të rëndësishëm në përcaktimin e zgjedhjeve në lidhje me regjimin ligjor të metrologjisë. Palët e interesuara përfshijnë furnizuesit e instrumenteve matëse, subjekteve të shitjes me pakicë dhe konsumatorëve.

## 2.2 POLITIKAT E SUBJEKTIT

Drejtimit kryesore të politikës shtetërore në fushën e metrologjisë, e cila bazohet tek mbrojtja e konsumatorëve dhe rritja e cilësisë së jetës të qytetarëve, janë si më poshtë:

- Përdorimin e njërive matëse në përputhje me Sistemin Ndërkombëtar të Njësisë;
- Matje uniforme në Republikën e Shqipërisë dhe besim në rezultatet e matjeve të kryera në funksion të tregut;
- Lëvizjen e lirë të instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara;
- Lëvizjen e lirë të produkteve të parapaketuara;
- Komunikimin e shpejtë, të saktë dhe lehtësisht të kuptueshëm dhe shkëmbim informacioni për çështjet metrologjike;
- Mbrojtjen e konsumatorëve dhe të shtetit nga rezultatet e pasakta të matjeve të instrumenteve matëse.

## 2.3 RËNDËSIA E PRODUKTEVE TË SUBJEKTIT

Metrologjia është pjesë e rëndësishme e infrastrukturës së cilësisë, e cila përbëhet nga: Standardizimi, Akreditimi, Testim-certifikimi dhe Vlerësimi i konformitetit, të cilat krijojnë premisat për vendime të rëndësishme lidhur me cilësinë e jetës së qytetarëve, në lidhje me mbrojtjen e shëndetit, ambientit, sigurinë e përgjithshme teknike, mbrojtjen e interesave ekonomike të konsumatorit, të sektorit publik dhe privat për cilësinë e produkteve dhe shërbimeve në Shqipëri. Metrologjia ligjore është një aktivitet i rëndësishëm i DPM-së, që ka qëllim mbrojtjen e interesave ekonomike të konsumatorëve nga matjet e pasakta në transaksionet tregtare dhe zyrtare, në fushat e sigurisë, shëndetit, ambientit etj., nëpërmjet verifikimit metrologjik ligjor të instrumentave matës. Një sistem efikas dhe mirëfunksionues i metrologjisë ligjore ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve, në efektivitetin e aktivitetit të sektorit publik dhe në rritjen efektive ekonomike në sektorin privat.

Shërbimet verifikuese të metrologjisë ligjore të organizuara në bazë të shërbimeve të specializuara sipas fushave kryesore (masë, volum&rrjedhje, matës material gjatësie) kryhen në laboratorët e qendrave rajonale të verifikimit, ashtu dhe në vend-përdorim të instrumenteve matës, me anë të autolaboratorëve, që synojnë gatishmërinë e ofrimit, cilësinë e shërbimeve, si dhe përfshirjen në skemën e kontrollit të instrumenteve matës të reja.

DPM, në zbatim të kërkesave të Ligjit nr. 9875, datë 14.02.2008 òPër metrologjinë i ndryshuar, për shërbime metrologjike, që nuk i kryen vetë për mungesë të kapaciteteve të nevojshme, ka autorizuar subjekte juridike për verifikimin periodik të matësve të energjisë elektrike, matësve të ujit të pijshëm dhe për verifikim të cisternave rrugore, si dhe persona fizik dhe juridik për riparimin e distributorëve të karburantit dhe peshoret automobilistike, aktiviteti i të cilëve monitorohet periodikisht nga DPM. Pra, veprimtaria e subjekteve private të përfshira në shërbime metrologjike është me ndikim të ndjeshëm në zhvillimin social - ekonomik, pasi përfshin dy fusha (konsumi energjik dhe i ujit të pijshëm më kryesisht) me shtrirje mjaft të gjerë territoriale dhe me rëndësi jetësore për vendin.

## 2.4 PESHA NË BUXHET DHE PBB

Gjatë periudhës 2018-2020, buxheti i planifikuar për funksionimin e DPM-së, gjithësej ka qenë 427,278 mijë lekë, pasqyruar në tabelën, si më poshtë:

Tabela nr.1 Buxheti i DPM për vitet 2018, 2019, 2020 (000 lekë)

2018	Llogaria Ekonomike	Buxheti Fillestar	Plani (me ndryshime)	Fakti
I	600	90,000	76,140	76,134



KONTROLLI I LARTË I SHITIT  
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS  
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT ËFEKTIVITETI I MASAVE TË MARRA PËR MBROJTJEN E  
KONSUMATORIT NGA ABUZIMET ME PESHËN DHE MATJET<sup>6</sup>

	601	14,000	12,700	12,658
	602	27,800	28,512	28,300
	605	6,500	5,788	5,788
	602 (Pjesa që mbulohet nga të ardhurat)	10,000	10,000	10,000
	231	6,000	6,000	3,600
	<b>Totali</b>	<b>154,300</b>	<b>139,140</b>	<b>136,480</b>
<b>2019 II</b>	<b>Llogaria Ekonomike</b>	<b>Buxheti Fillestar</b>	<b>Plani (me ndryshime)</b>	<b>Fakti</b>
	600	87,300	87,300	79,556
	601	16,700	16,700	13,242
	602	25,800	25,800	22,676
	605	8,500	7,000	3,726
	602 (Pjesa që mbulohet nga të ardhurat)	10,000	10,000	9,528
	231	6,000	6,000	4,233
	<b>Totali</b>	<b>154,300</b>	<b>152,800</b>	<b>132,961</b>
<b>2020 III</b>	<b>Llogaria Ekonomike</b>	<b>Buxheti Fillestar</b>	<b>Plani (me ndryshime)</b>	<b>Fakti</b>
	600	87,300	80,300	77,058
	601	16,700	13,700	12,826
	602	30,500	26,358	17,826
	605	3,160	3,850	3,847
	602 (Pjesa që mbulohet nga të ardhurat) <sup>6</sup>	8,000	8,000	5,472
	231	5,000	2,452	2,280
	606	200	678	678
<b>Totali</b>	<b>150,860</b>	<b>135,338</b>	<b>119,987</b>	
<b>IV</b>	<b>TOTALI I+II+III</b>		<b>427,278</b>	<b>389,428</b>

Burimi: DPM, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar tabelës së mësipërme, rezulton se, DPM në vitin 2018 ka patur një performancë të mirë lidhur me realizimin e buxhetit sipas llogarive ekonomike, konkretisht për këtë vit buxheti është realizuar me 98%, për të vijuar me rënie të realizimit të buxhetit për vitin 2019 me 87% dhe vitin 2020 me 89%. Kjo situatë e krijuar për vitet 2019-2020, ka ardhur pasi në vitin 2019, DPM ka patur mangësi në plotësimin e strukturës me burime njerëzore, e për rrjedhojë fondi i planifikuar për pagat, si edhe fondi i investimeve nuk janë realizuar plotësisht. Në vitin 2020, vihet re një realizim i ulët i fondit të shpenzimeve operative, si dhe të pjesës takuese të të ardhurave të institucionit, ku për shkak të Pandemisë COVID-19, një pjesë e aktiviteteve janë anuluar.

Në një analizë makroekonomike, rezulton se përgjatë periudhës 2018-2020, buxheti i DPM-së ka ardhur në rënie, nga 136,480 mijë lekë në vitin 2018 në 119,987 mijë lekë në vitin 2020, ose 16,493 mijë lekë më pak, kjo edhe për shkak të rënies së konsiderueshme në vlerë të ardhurave të realizuara nga institucioni në vitin 2020 (79,427,961 lekë) në krahasim me vitin 2018 (131,459,248 lekë), pra 52,031,287 lekë më pak. Nga të ardhurat gjithësej që realizon DPM, sipas VKM nr.571, datë 29.08.2012, institucioni ka të drejtë që të përdorë prej tyre, deri në vlerën 10,000,000 lekë, ku destinacioni i përdorimit të të cilave, është i përcaktuar me Udhëzimin e përbashkët të ish Ministrisë së Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës, sot Ministria e Infrastrukturës dhe Energjitikës dhe Ministrisë së Financave nr.3, datë 01.04.2013<sup>7</sup>.

Referuar Udhëzimit të mësipërm, këto të ardhura duhet të përdoren për:

- Pagesat e tarifave për rikalibrimin periodik të etalonëve;
- Mirëmbajtjen dhe sigurimin e lëndës së parë për etalonët;
- Pjesëmarrjen në ushtrime ndërkrahasimi laboratorike ndërkombëtare;
- Shpenzimet operative (udhëtim, siguracion, dieta) përgjatë procesit të rikalibrimit të etalonëve në institucione ndërkombëtare;
- Pjesëmarrjen në Komitetet teknike për fushat e matjeve;
- Mbulimin e shpenzimeve të ekspertëve të vlerësimit të kompetencës së laboratorëve të etalonëve;
- Shpenzimet për sigurinë e laboratorëve të etalonëve kombëtarë;

<sup>6</sup> VKM nr.571, datë 29.08.2012 ËPër lejin e përdorimit të pjesshëm të të ardhurave të realizuara nga drejtoria e përgjithshme e metrologjisë gjatë shërbimeve metrologjike, për zhvillimin, mirëmbajtjen dhe njohjen ndërkombëtare të etaloneve kombëtare të matjeve

<sup>7</sup> Për mënyrën e përdorimit të të ardhurave nga DPM



- Energjinë dhe karburantin e konsumuar për ruajtjen e regjimit klimaterik në laboratorët e etalonëve kombëtarë.

Lidhur me shpenzimet operative të DPM (që përbëjnë pjesën kryesore të shpenzimeve të institucionit) për vitin 2020, nga institucioni janë shpenzuar 23,298,056 lekë, nga të cilat 17,826,299 lekë janë mbuluar nga buxheti i shtetit dhe 5,471,757 lekë nga pjesa takuese e të ardhurave. Në tabelën më poshtë kemi pasqyruar vetëm llogaritë ekonomike që kanë peshën më të madhe në shpenzimet operative:

Tabela nr.2 Shpenzimet operative më kryesore të DPM për vitin 2020

Emërtimi	Totali i Shpenzimeve		Mbulimi i tyre	
	Plan	Fakt	Buxheti i Shtetit	Të ardhurat
Materiale të përgjithshme	1,682,702	1,682,702	1,682,702	
Shërbime nga të tretët	18,572,941	6,042,391	4,985,140	1,057,251
Elektricitet	6,600,044	3,442,816	2,385,565	1,057,251
Shërbime të tjera	1,859,670	1,859,670	1,859,670	
Shpenzime transporti	6,383,684	6,378,290	5,378,290	1,000,000
Karburant dhe vaj	5,000,000	4,999,861	3,999,861	1,000,000
Shpenzime Udhëtimi (Dieta jashtë)	2,948,440	2,440,800	2,440,800	
Shpenzime Udhëtimi (Dieta brenda)	2,948,440	2,440,800	2,440,800	
Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	1,629,720	1,629,720	1,629,720	
Shpenzime të tjera operative	4,135,937	4,135,937	721,431	3,414,506
Siguria e ndërtesës dhe laboratorëve	4,079,506	4,079,506	665,000	3,414,506

Burimi: DPM, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

▪ Sa i përket peshës që ka buxheti i planifikuar për DPM ndaj buxhetit të MFE, si dhe buxhetit të shtetit gjithësej, rezulton se për periudhën 2018-2020, pesha **mesatare** që ka patur buxheti i këtij institucioni (buxheti i shtetit + pjesën takuese të të ardhurave), ndaj buxhetit të MFE, ka qenë rreth 0.25%.

Tabela nr.3 Pesha e buxhetit të planifikuar për DPM ndaj buxhetit të MFE

Viti	Buxheti i MFE	Buxheti i DPM	Pesha në %
2018	54,107,434	139,140	0.26%
2019	55,940,139	152,800	0.27%
2020	59,857,139	135,338	0.23%
<b>Gjithësej</b>	<b>169,904,712</b>	<b>427,278</b>	<b>0.25%</b>

Burimi: MFE dhe DPM, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Sa i përket peshës së buxhetit të DPM ndaj buxhetit të shtetit, përgjatë periudhës 2018-2020, mesatarisht ka qenë 0.045%.

## 2.5 RISQET E AKTIVITETIT TË SUBJEKTIT

Risqet e aktivitetit të subjektit janë ato me të cilat ndeshet DPM në realizimin e përgjegjësive të veta, referuar mbrojtjes së konsumatorëve nga abuzimet tregtare me peshën dhe me matjet, si dhe impaktit potencial mbi verifikimin fillestar dhe periodik dhe monitorimin e kësaj veprimtarie në instrumentet matës në fushat e përfshira të metrologjisë (peshat, masat e lëngjeve të rrjedhshme dhe statike, energjisë elektrike, ujë etj.).

Risqet e aktivitetit të institucionit janë analizuar dhe paraqitur duke i evidentuar dhe klasifikuar sipas analizës SWOT: fuqitë, dobësitë, shanset, kërcënimet, si dhe është bërë kategorizimi i tyre. Gjithashtu është bërë kategorizimi i tyre në strategjik, financiar, juridik dhe operacional, si dhe klasifikimi brenda kontrollit dhe jashtë kontrollit menaxherial.

Tabela nr.4 Analiza SWOT

Fuqitë (S)	Dobësitë (W)
Ambiente (godina qendrore) të reja të ndërtuara si dhe laboratorë, autolaboratorë dhe pajisje laboratorike bashkëkohore.	Burime financiare të limituara për përmirësimin dhe inovacionin e shërbimeve në disa fusha të metrologjisë.
Njohja ndërkombëtare e DPM, si qendra e	Niveli i ulët i zbatimit të strategjive dhe monitorimi i tyre për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
 DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS  
 RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT ËEFEKTIVITETI I MASAVE TË MARRA PËR MBROJTJEN E  
 KONSUMATORIT NGA ABUZIMET ME PESHËN DHE MATJET"

metrologjisë në Shqipëri	zhvillimin e sitemit të metrologjisë, si dhe zbatimi kuadrit ligjor të tij
Burimi i financimit (Buxheti i shtetit dhe pjesa takuese e të ardhurave të realizuara nga shërbimet metrologjike)	Niveli i ulët bashkëpunimit ndërinstitucional.
Anëtarësimi me të drejta të plotë i DPM në organizata ndërkombëtare	Mangësi në plotësimin me burime njerëzore të strukturave.
Kryerja e testimeve ndërlaboratorike	Mungesa e një regjistri kombëtar elektronik të instrumentave matës
Ekzistenca e sistemit të menaxhimit të cilësisë në DPM	Mungesa e kryerjes së shërbimit të rikalibrimit të etalonëve dhe e gjurmueshmërisë metrologjike, mungesa e mirëmbajtjes së paisjeve të verifikimit dhe kalibrimit
Kryerja e monitorimeve periodike të subjekteve të autorizuara nga DPM, për kryerjen e shërbimeve metrologjike	Mungesa e përditësimit dhe plotësimit të kuadrit rregullator
Deklarimi në data base të BIPM disa fushave, si ajo e masës	Mungesa e fushatave publicitare dhe bashkëpunimit me shoqatat e konsumatorit, furnizuesit e instrumentave matës dhe përdoruesit fundor të tyre.
	Mungesa e planit të trajnimit të metrologëve të Metrologjisë Ligjore të vetë DPM dhe metrologëve në subjektet e autorizuara për kryerjen e shërbimeve metrologjike
	Planifikim i ulët i numrit të instrumenteve matës për verifikim metrologjik, mungesa e mbulimit të plotë me verifikim të instrumentave matës
	Arkëtimi i tarifave të shërbimit të verifikimit metrologjik nga metrologët që kryejnë shërbimin dhe me para në dorë, jo nëpërmjet rrugëve bankare
	Qarkullimi i stafit, staf i pakualifikuar dhe trajnuar.
	Zgjerimi i bazës etalonuese të laboratoreve elektrik (automatizimi i matjeve të tensionit të vazhduar), forcës, volumeve-rrjedhjeve (instrument matës për kalibrim rezervuaresh) dhe ngritja e laboratorëve: të kohëfrekuencës, të kontrollit të zhurmave dhe të kontrollit të instrumentave matës në fushën e shëndetësisë.
	Mungesa e përcaktimit të afateve konkrete për realizimin e detyrave të parashikuara në planet vjetore të punës
	Shtirja gjeografike e institucionit dhe komunikimi i dobët
<b>Shanset (O)</b>	<b>Kërcënimet (T)</b>
Ekzistenca e disa strategjive sektoriale/ndërsktoriale që synojnë zhvillimin e sistemit të metrologjisë	Reduktimi i vlerës së pjesës takuese të të ardhurave që përdor DPM në financimin e aktivitetit të saj, nga 10,000,000 mijë në 8,000,000 mijë lekë
Kuadri rregullator	Mungesa e bashkëpunimit ndërinstitucional
Anëtarësimi i DPM-së në organizatat ndërkombëtare te metrologjisë	Ndryshimet ligjore të herë pas hershme
Ofrimi i matjes së instrumenteve dhe shërbimin e kalibrimit jashtë Shqipërisë.	Mungesa e akreditimit të të gjithë laboratorëve të DPM
Përdorues besnik të shërbimit të kalibrimit dhe mundësi rritje si rezultat i formalizimit të ekonomisë	Kërkesat për njohje të veprimtarisë të DPM nga organizmat ndërkombëtarë në lidhje me kalibrimet, matjet, transmetimin e gjurmueshmërisë etj.
Projekti Regional Consultaty Found Quality Infrastructure, South East Europe, i cili shërben për trajnimin e specialistëve të DPM	Zhvillimet ekonomike në rajon e më gjerë dhe kërkesat në lidhje metrologjinë.
Tregëtia e lirë	Kriza ekonomike fatkeqësi natyrore

Burimi: DPM, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Tabela nr.5 Kategorizimi i Riskut

Nr.	Risku i Subjektit	Kategorizimi i riskut	Niveli i Riskut
<b>DPM</b>			
1	Niveli i ulët i zbatimit të strategjive dhe monitorimi/rishikimi i tyre, për zhvillimin e sitemit të metrologjisë	Risk Strategjik	I Lartë
2	Zgjerimi i bazës etalonuese të laboratoreve elektrik (automatizimi i matjeve të tensionit të vazhduar), forcës, volumeve-rrjedhjeve (instrument matës për kalibrim rezervuaresh) dhe ngritja e laboratorëve: të kohëfrekuencës, të kontrollit të		I Lartë



	zhurmave dhe të kontrollit të instrumentave matës në fushën e shëndetësisë.		
3	Shtrirja gjeografike e institucionit dhe komunikimi i dobët		I Lartë
4	Mungesa e bashkëpunimit ndërinstytucional		I Lartë
5	Mungesa e planit të trajnimit të metrologëve të Metrologjise Ligjore të vetë DPM dhe metrologëve në subjektet e autorizuara për kryerjen e shërbimeve metrologjike		
6	Planifikim i ulët i verifikimeve periodike për instrumentet matës ligjerisht të kontrolluar dhe arkëtimi i të ardhurave nga ky shërbim, mungesa e mbulimit të plotë me verifikim të instrumentave matës		I Mesëm
7	Mungesa e përcaktimit të afateve konkrete për realizimin e detyrave të parashikuara në planet vjetore të punës		I Mesëm
8	Burime financiare të limituara për përmirësimin dhe inovacionin e shërbimeve në disa fusha të metrologjisë.	Risk Financiar	I Lartë
9	Arkëtimi i tarifave me para në dorë nga metrologët.		I Lartë
10	Mungesa e përditësimit dhe plotësimit të kuadrit rregullator	Risk Rregullator	I Lartë
11	Mungesa e një regjistri kombëtar elektronik të instrumentave matës		I Lartë
12	Mungesa e mirëmbajtjes së paisjeve të verifikimit dhe kalibrimit		I Lartë
13	Qarkullimi i stafit, staf i pakualifikuar dhe trajnuar		I Lartë
14	Mungesa e kryerjes së shërbimit të rikalibrimit të etalonëve dhe e gjurmueshmërisë metrologjike	Risk Operacional	I Mesëm
15	Mungesa e fushatave publicitare dhe bashkëpunimit me shoqatat e konsumatorit, furnizuesit e instrumentave matës dhe përdoruesit fundor të tyre.		I Mesëm

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

### Klasifikimi i riskut:

#### a) Brenda kontrollit menaxherial:

- Burime financiare të limituara për përmirësimin dhe inovacionin e shërbimeve në disa fusha të metrologjisë.
- Niveli i ulët i zbatimit të strategjive dhe monitorimi i tyre për zhvillimin e sitemit të metrologjisë, si dhe zbatimi kuadrit ligjor të tij.
- Niveli i ulët bashkëpunimit ndërinstytucional.
- Mangësi në plotësimin me burime njerëzore të strukturave.
- Mungesa e një regjistri kombëtar elektronik të instrumentave matës.
- Mungesa e kryerjes së shërbimit të rikalibrimit të etalonëve dhe e gjurmueshmërisë metrologjike, mungesa e mirëmbajtjes së paisjeve të verifikimit dhe kalibrimit.
- Mungesa e fushatave publicitare dhe bashkëpunimit me shoqatat e konsumatorit, furnizuesit e instrumentave matës dhe përdoruesit fundor të tyre.
- Mungesa e planit të trajnimit të metrologëve të Metrologjise Ligjore të vetë DPM dhe metrologëve në subjektet e autorizuara për kryerjen e shërbimeve metrologjike.
- Planifikim i ulët i verifikimeve periodike për instrumentet matës ligjerisht të kontrolluar dhe arkëtimi i të ardhurave nga ky shërbim, mungesa e mbulimit të plotë me verifikim të instrumentave matës.
- Arkëtimi i tarifave me para në dorë nga metrologët.
- Qarkullimi i stafit, staf i pakualifikuar dhe trajnuar.
- Zgjerimi i bazës etalonuese të laboratoreve elektrik (automatizimi i matjeve të tensionit të vazhduar), forcës, volumeve-rrjedhjeve (instrument matës për kalibrim rezervuare) dhe ngritja e laboratorëve: të kohëfrekuencës, të kontrollit të zhurmave dhe të kontrollit të instrumentave matës në fushën e shëndetësisë.
- Mungesa e përcaktimit të afateve konkrete për realizimin e detyrave të parashikuara në planet vjetore të punës.
- Mungesa e përditësimit dhe plotësimit të kuadrit rregullator.
- Shtrirja gjeografike e institucionit dhe komunikimi i dobët.

#### b) Jashtë kontrollit menaxherial:

- Reduktimi i vlerës së pjesës takuese të të ardhurave që përdor DPM në financimin e aktivitetit të saj, nga 10,000,000 mijë në 8,000,000 mijë lekë.



- Mungesa e bashkëpunimit ndërinstitucional.
- Ndryshimet ligjore të herë pas hershme.
- Kërkesat për njohje të veprimtarisë të DPM nga organizmat ndërkombëtarë në lidhje me kalibrimet, matjet, transmetimin e gjurmueshmërisë etj.
- Zhvillimet ekonomike në rajon e më gjerë dhe kërkesat në lidhje metrologjinë.
- Kriza ekonomike fatkeqësi natyrore.
- Mungesa e akreditimit të të gjithë laboratorëve të DPM.

## 2.6 FEEDBACK-U I SUBJEKTIT PËRGJATË GJITHË AUDITIMIT

1. Gjatë fazës studimore subjekti i përfshirë në auditim, DPM i është përgjigjur në kohë takimeve prezantuese dhe konsultuese, si dhe intervistave për kërkesat për dokumentacion. Është plotësuar informacioni i kërkuar, kryesisht me dokumentacionin që lidhet me ligjin dhe aktet nënligjore, strategjitë, strukturën, përshkrimet e punës, buxhetin, raportet e aktivitetit, statistikën, megjithëse këto të fundit të kufizuara në raport me atë që ka kërkuar grupi i auditimit.

-Në fund të fazës studimore grupi i auditimit arriti në përfundimin se, DPM tregoi **gatishmëri** në vënien në dispozicion të mjeteve të punës dhe informacionit të kërkuar.

2. Gjatë fazës së terrenit, me përfshirjen si subjekt në auditim edhe të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë, për secilin institucion, MFE dhe DPM, bashkëpunimi me grupin e auditimit ishte si vijon:

-DPM i është përgjigjur në kohë gjenerimit të përgjigjeve zyrtare për çështjet e adresuara, së bashku me evidencën e nevojshme.

-Gjithashtu MFE, iu përgjigj në kohë kërkesës së grupit të auditimit për dokumentacion.

**Në mënyrë të përmbledhur nga të dy institucionet është treguar gatishmëria për të bashkëpunuar me grupin e auditimit, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar sipas afatit të përcaktuar.**

## 3. QASJA DHE DETAJET E AUDITIMIT

### 3.1. FOKUSIMI DHE PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT

Në jetën tonë të përditshme, jo në pak raste vihen re disa probleme të saktësisë së matjes, të cilat veç ose së bashku, në marrëdhëniet midis palëve (institucione publike me njëra tjetrën, institucione publike-subjekte private, ndërmjet subjekteve tregëtare dhe konsumatorit, ose ndërmjet dy subjekteve tregëtare), mund të sjellin efekte negative social-ekonomike. Disa probleme të saktësisë së matjes, mund të krijohen në produktet e shportës së konsumit që ne blejmë në lidhje me peshën e tyre, fushën e mjekësisë, si pasojë e mos verifikimit dhe kalibrimit të aparateve dhe pajisjeve mjekësore, si p.sh. aparatet me lazer dhe ultratinguj, aparatet optike, termometri i blerë në farmaci, etj, matjen e konsumit të ujit, kohës telefonike, verifikimin e pajisjeve e rendit dhe sigurisë publike, radarët e matjes së shpejtësisë, pajisjet që shërbejnë për matjen e zhurmave, ndotjes së mjedisit, etj.

Pra, nga njëra anë, kjo kërkohet me synim mbrojtjen e konsumatorit dhe shtetit dhe nga ana tjetër heqjen e kufizimeve të panevojshme për të bërë biznes dhe tregti të lirë. Ky optimizim i rregullave teknike varet gjerësisht nga infrastruktura e cilësisë që disponohet, e cila ka disa element kyç si, standardizimi, **metrologjia (matja)**, akreditimi, testim-certifikimi, vlerësimi i konformitetit.

Në këto kushte, krijohet nevoja e sigurimit dhe përdorimit të një **sistemi kombëtar metrologjie**, i cili duhet të jetë në gjendje të realizojë matje të harmonizuara dhe të njohura ndërkombëtarisht, në përputhje me sistemin ndërkombëtar të njësive të matjeve.

Grupi i auditimit përgjatë fazës studimore të auditimit, hodhi hipotezën se, ky sistem vuan nga një mungesë efektiviteti dhe efikasiteti, pasi nuk është arritur niveli i kërkuar i përgatitjes teknike profesionale të stafit të strukturave verifikuese të metrologjisë, mungesës së bashkëpunimit ndërinstitucional, realizimit plotësisht të objektivave strategjik, mbulimit të fushave të ndryshme (si atë të shëndetësisë, ujit, cilësisë së produkteve ushqimore, kohës telefonike, sigurimit teknik, etj) me verifikim metrologjik, ndërmarrjen e nismave ligjore, të cilat në periudhë afatgjatë mund të ndikojnë negativisht në cilësinë e shërbimit metrologjik të ofruar, por edhe në garantimin e mbrotjes së konsumatorit nga abuzimet me peshën dhe matjen.



Këtë hipotezë grupi i auditimit e vërtetoi përgjatë fazës së terrenit, ku në përfundim të saj, arriti në mesazhin e auditimit. Gjithashtu në përfundim të punës audituese, grupi i auditimit krijoi bindjen e arsyeshme se, saktësia e matjeve (produktet e parapaketuara dhe instrumentat matës) është thelbësore për pothuajse të gjitha aspektet e aktivitetit njerëzor duke filluar nga kontrolli i prodhimit, matja e cilësisë së mjedisit, vlerësimi i shëndetit dhe sigurisë, vlerësimi i konformitetit të produkteve të mbrojtja e konsumatorit dhe siguria e tregtisë së ndershme.

### 3.2 OBJEKTIVI I AUDITIMIT

Jo vetëm si konsumatorë, por edhe si taksapagues, qytetarët shqiptarë janë të interesuar të marrin shërbimet e duhura në kohë, me cilësi dhe me kosto optimale nga institucionet e administratës publike. Si një shërbim publik dhe privat, metrologjia, ka ndikim në garantimin e mbrotjes së konsumatorit nga abuzimet me peshën dhe matjen, eliminimin e praktikave të padrejta tregëtare, forcimin e konkurrencës së ndershme në treg, si dhe përmirësimin e infrastrukturës së cilësisë në Shqipëri.

Sa më sipër me qëllimin që sistemi i metrologjisë të përmbushi pritshmëritë e konsumatorit final, grupi i auditimit përcaktoi si objektivi:

*“Auditimin e efektivitetit dhe eficiencës së masave të marra (duke u fokusuar në vlerësimin e kuadrit rregullator, strategjitë, burimeve njerëzore dhe financiare, bashkëpunimin ndërinstytucional) nga MFE dhe DPM për zhvillimin e sistemit të metrologjisë, për periudhën 2018-2020”.*

Grupi i auditimit nëpërmjet analizës së veprimtarisë së këtij institucioni, u përpoq, të evidentojë arritjet, prirjet dhe problematikat që kanë ndikuar në sistemin e metrologjisë në Shqipëri, si dhe arritjen në përfundime dhe rekomandime për përmirësimin e mëtejshëm.

### 3.3 PIRAMIDA E PYETJEVE AUDITUESE

#### Piramida e pyetjeve

1. A ka qenë efektiv sistemi i metrologjisë në mbrojtjen e konsumatorëve nga abuzimet me peshën dhe matjet, përgjatë periudhës 2018-2020?

1.1 A kanë rezultuar efektive politikat e marra nga MFE për garantimin e mbrotjes së konsumatorit nga abuzimet me peshën dhe matjet?

1.2 A kanë qenë efektive masat e marra nga DPM për mbrotjen e konsumatorit nga abuzimet me peshën dhe matjen?

1.1.1A është hartuar nga MFE dhe DPM, kuadri rregullator në përputhje me standartet e BE për metrologjinë?

1.1.2 A ka qenë efektive MFE në mbështetjen financiare të DPM-së, për zhvillimin e sistemit të metrologjisë?

1.2.1. A janë realizuar objektivat strategjikë për metrologjinë nga DPM?

1.2.2. A janë mirëadministruar burimet njerëzore dhe financiare nga DPM në funksion të realizimit të objektivave institucional?

1.2.3. A ka ndikuar në mbrojtjen e konsumatorëve veprimtaria e metrologjisë ligjore pranë DPM?

1.2.4. A ka qenë efektiv bashkëpunimi ndërinstytucional i DPM?

Burimi: Punuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

### 3.4 KRITERET

Tabela nr.6 Kriteret Audituese

Pyetja kryesore	Pyetje të nivelit të parë	Pyetjet e nivelit të dytë	Kriteret audituese	Referenca e kriterëve
-----------------	---------------------------	---------------------------	--------------------	-----------------------





KONTROLI I LARTË I SHTETIT  
 DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS  
 RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT ËFECTIVITETI I MASAVE TË MARRA PËR MBROJTJEN E KONSUMATORIT NGA ABUZIMET ME PESHËN DHE MATJET"

<p><b>A ka qenë efektiv sistemi i metrologjisë në mbrojtjen e konsumatorëve ve nga abuzimet me peshën dhe matjet, përgjatë periudhës 2018-2020?</b></p>	<p>1.1.A kanë rezultuar efektive politikat e marra nga MFE për garantimin e mbrotjes së konsumatorit nga abuzimet me peshën dhe matjet?</p>	<p>1.1.1 A është hartuar nga MFE dhe DPM, kuadri rregullator në përputhje me standartet e BE për metrologjinë?</p>	<p>a-Ligj nr. 126, dt. 15.10.2020 (METROLOGJINE)ë;          b-Ligji nr. 9875, datë 14.02.2008 ëPër metrologjinëë i ndryshuar;          c-Ligji nr. 9902, datë 17.4.2008 ëPër mbrojtjen e konsumatoritë i ndryshuar;          ç-Kontrata koncensionare MFE-N.I shpk nr 15326 prot dt 21.08.2019 ëSherbimin e kontrollit ligjore te instrumentave mases nepermjet verifikimit te instrumentave te shperndarjes se karburanti dh gazit te lengshemë          d-Rregullore e brendshme Nr.104-1, date 07.02.2014 dh-Strategjia Kombëtare ëPër mbrojtjen e konsumatorit dhe mbikëqyrjen e tregut 2014-2020ë dhe Plani i Veprimit          e-Guid 8.7 vleresimi i trupes inspektuese WELMEC ë-Guide_10.6_Sigurimi i instrumentit shperndarsit te karburantit _v2.0_2019 WELMEC          f-Guid per instrumentin e shperndarsit e karburantit OIML          g-EURAMET and the Operation of NMIs Guide nr 10</p>	<p>a- Ligj nr. 126 Neni 8 9 41 48          b- Ligji nr. 9875Neni 8 13          c- Ligji nr. 9902Neni 49          ç- Kontrata 15326 ë Detyrimet e detyrat e AKë ëDetyrimet e detyra të koncensionaritë òaneksetë Amendim i kontratesë          d- Rregullore Nr.104-1 ëDetyrat e Metrologeve MI, Msh, Mië          dh- Strategjia ëObjektivat e MFE për metrologjinë ne Rshë          e-ë -ëelmeç 8.7 ,10.6          f- OIML 10.2          g-EURAMET G 10</p>
		<p>1.1.2.A ka qenë efektive MFE në mbështetjen financiare të DPM-së, për zhvillimin e sistemit të metrologjisë?</p>	<p>a- Shkresa nr.-19650 , date -30-01-2018 dërguar nga Min Fin Ekonomisë miratimit te detajimit te fondeve shpenzimeve korrente për vitin 2018.          b-Shkresa nr.23016/3 , date -14-02-2019- dërguar nga Min Fin Ekonomisë miratimit te detajimit te fondeve shpenzimeve korrente për vitin 2019.          c-Shkresa -24325/100, date -27-01-2020 dërguar nga Min Fin Ekonomisë miratimit te detajimit te fondeve shpenzimeve korrente për vitin 2020.          ç-Kerkesat e DPM në fazat e pergatitje se PBA-ve 2018,2019,2020          d-Udhezimi nr.9 date 20.03.2018 Per Procedurat Standarte te Zbatimit te Buxhetit-1          dh-Udhezimi i buxhetit nr 2 date 06.02.2012 i Korrektuari.          e-Ligji Nr. 10 296, datë 8.7.2010 ëPër menaxhimin financiarë dhe kontrollinë          ë-Ligj Nr.9936, datë 26.6.2008 ëPer menaxhimin e sistemit buxhetorë në RShë i ndryshuar (Ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 23.10.2015 )          f- Udhezimi 30_date 27_12_2011 menaxhimin i aktiveve te njsp me ndryshimet.          g-Strategjia per Menaxhimin e Financave Publike 2014-2020.</p>	<p>a-b-c Tavanet buxhetore të 2018,209,200          ç-Kërkesat e DPM me produkte dhe objektiva per fundeë          d- II.1 Buxheti Vjetor          d- II. Procedurat          e- Neni 5,8,9,10,11,12,13,14,15,16          ë- Neni 4,9,24,25,2741,42,45,49,65,67          f- II. Menaxhimi i riskut          f-III Regjistrimi i aktiveve</p>
	<p>1.2.A kanë qenë efektive masat e marra nga DPM për mbrotjen e konsumatorit nga abuzimet me peshën dhe matjen?</p>	<p>1.2.1. A janë realizuar objektivat strategjikë për metrologjinë nga DPM?</p>	<p>a- Strategjia Kombëtare ëPër mbrojtjen e konsumatorit dhe mbikëqyrjen e tregut 2014-2020ë dhe Plani i Veprimit          b-Strategjia e DPM 2008-2021 miratuar me VKM nr. 753, datë 16.9.2015.          c- Strategy of metrology development in Montenegro.          Ç- Raporti i Parë i Monitorimit1 Tetor 2018 ó          d- Raport i Komisionit Evropian mbi zbatimin e direktivës së instrumenteve matës 2014/32/UE, 16.02.2014.</p>	<p>a-Objektivat e DPM, f aqë73,74          b-objektivat ë60 fusha te metrologjise 2020ë          c- Objektiva, aktivite, rezultate</p>
	<p>1.2.2. A janë mirëadministruar burimet njerëzore dhe financiare nga DPM në funksion të realizimit të objektivave institucionale?</p>	<p>a-Ligji Nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civilë (i ndryshuar);          b-Vendim Nr. 109, datë 26 Shkurt, 2014, i Këshillit të Ministrave ë Për vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civilë, i ndryshuar;          c-Rregullore e brendshme Nr.104-1, date 07.02.2014          d-Ligji Nr. 10 296, datë 8.7.2010 ëPër menaxhimin financiarë dhe kontrollinë          e-Udhezim-Nr 30 ndryshime date 2016-12-07-24          ë-Ligj Nr.9936, datë 26.6.2008 ëPer menaxhimin e sistemit buxhetorë në RShë i ndryshuar (Ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 23.10.2015 )          f-Udhezimi nr.9 date 20.03.2018 Per Procedurat Standarte te Zbatimit te Buxhetit-1</p>	<p>a- Ligji Nr. 152/2013 Neni 10,17,21,22,23,24,25          d- Ligji Nr. 10 296 Neni 5,8,9,10,11,12,13,14,15,16          c- Rregullore Nr.104-1 Rr 104 ëDetyrimet e punonjesve te DPMë          e- Udhezim-Nr 30 Faqe 3-16          ë- Ligj Nr.9936 Neni4,9,24,25,2741,42,45,49,65,67          f- Udhezimi nr.9 faqe.13,16,30 ëArketimet e arifaveë          ëdokumentacionië ëDetyrat e nj/shpenzueseë          h- Strategjia ëObjektivat e njesive te</p>	



			g-Udhezimi i buxhetit nr 2 date 06.02.2012 i Korrektuari. h-Strategjia per Menaxhimin e Financave Publike 2014-2020 g- Rregullore nr 1214 prot 20.10.2010 e administrimit e dokumentacionit financiare te atij me nr serie ne DPM. gj-VKM nr.1576, datë 17.10.2008 ëPër mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, i ndryshuar	pergjithshme shpenzuese g- Rregullore nr 1214 ë arketimet e tarifave te sherbimeve MLö gj- VKM nr.1576 ëpersoneli i miratuar i MLö ëShperndarja ne 4 Rajoneë
	1.2.3. A ka ndikuar në mbrojtjen e konsumatorëve veprimtaria e metrologjisë ligjore pranë DPM?		a-Ligji nr. 9875, datë 14.02.2008 ëPër metrologjinë i ndryshuar; b-Vendim Nr. 770, datë 2.11.2016 ëPër miratimin e rregullit teknik per instrumentat matëse ligjerisht të kontrolluaraë . c-Urdheri nr 7025 dt 24.08.2017 ëMiratimin e rregullores per autorizimin e personave juridik per kryerjen e veprimtarise se metrologjise ligjore per kryerjen e sherbimit te riparimit te instrumentave mateseë d-Udhezim Nr 1897/3 dt 03.08.2016 parapaketimet. e-Rregullore e brendshme Nr.104-1, date 07.02.2014 ë-Vkm nr 1351 date 03.10.2008 Miratimi i rregullores teknike metrologjike per instrumetet, ligjerisht te kontrolluaraë - Udhëzim Nr. 3492, - VKM Nr. 109 , ë; -VKM nr.1576, ;-VKM nr. 1160, -VKM nr.1161, -VKM nr. 1162 -VKM nr. 631, -VKM nr. 1055, -VKM nr.1351, -VKM nr. 1352, -VKM nr.1052, -VKM nr.77,	a- Ligji nr. 9875 Neni 8,Kreu V metrologjia ligjore 18-33 b- Vendim Nr. 770 ë.procedurat e knformitetitë, ëdokumentacioni teknikë e-Rregullore 104-1 ëDetyrat e Metrologjisë ligjoreë - Udhëzim Nr. 3492,ëDetyrimet e DPMë - Urdheri nr 7025 ëDokumentacionië, Detyrat kriteret e subjektitë Detyrat e DPMë VKM-të ëZbatimi i detyrimeve teknikeë ëper devijimet standarte dhe verifikimet e instrumentave matesë - Udhezim Nr 1897/3 ë detyrimet e subjekteve, detyrat e DPMë
	1.2.4. A ka qenë efektiv bashkëpunimi ndërinstytucional i DPM?		a-Ligj Nr. 90/2012 ëPër organizimin e funksionimin e administratës shtetoreë b-Udhëzim Nr. 3492, datë 30.4.2015 ëPer kordinimin nderinstytucional te procedurave standarte te kontrollit sasiore, cilësor dhe fiskal te naftes bruto e nënprodukteve te sajëë ç-Vendim Nr. 867, datë 10.12.2014 ëPër procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administrates shtetoreë d-Ligji nr. 9875, datë 14.02.2008 ëPër metrologjinë i ndryshuar;	a- Ligj Nr. 90/2012 neni 3,24,29 b- Udhëzim Nr. 34923.1 Tregtimi me shumicë,3.2 tregti me pakice.4.1 rafinerite e naftes,6.2 shkembim informacioni. ç- Vendim Nr. 867, Kreu II,III c-Vendim Nr. 247 ëKrijimi i ëeb faqes DPMë d-Ligji nr. 9875 neni 8 ëDetyrat dhe të drejtat e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë. Neni 12 Etalonet kombëtare të matjev

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

### 3.5. QASJA/METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Grupi i auditimit për të vlerësuar kryerjen e detyrave funksionale të subjekteve nën auditim, përgatiti intervistat për nivelin drejtues të tyre, konkretisht intervistën drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të DPM, si dhe Sekretarit të Përgjithshëm të MFE. Intervistat ishin gjysëm të strukturuar, pra me pyetje të hapura dhe të mbyllura, si dhe çdo përgjigje e tyre u testua me dokumentacionin shoqëruar dhe justifikues, i cili sipas rastit përmbante të dhëna sasiore dhe/ose cilësore.

Për sa më sipër bazuar në dokumentacionin e grumbulluar dhe të analizuar, të dhënat e kërkuara dhe të plotësuar nga subjektet nën auditim, komunikimet me stafin, pasqyrimin në media të këtij aktiviteti, si dhe në praktikën e mira të vendeve të BE-së në këtë fushë, qasja audituese u drejtua nga rezultati dhe u përdorë qasja pragmatiste, një miks i qasjes sasiore dhe cilësore.

Nëpërmjet qasjes sasiore, u testuan të dhënat e parashikuara me ato të realizuara, si dhe ato të raportuara me ato të kontrolluara dhe monitoruara. Nëpërmjet qasjes cilësore u vlerësua zbatimi i detyrave funksionale nga strukturat përkatëse.

## 4. SHTJELLIMI I PYETJEVE DHE NËNPYETJEVE

### 4.1.A ka qenë efektiv sistemi i metrologjisë në mbrojtjen e konsumatorëve nga abuzimet me peshën dhe matjet, përgjatë periudhës 2018-2020?



Në përfundim të realizimit të programit të auditimit, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit mbi veprimtarinë e MFE dhe DPM, u arrit në këtë **mesazh auditimi:**

Megjithëse prej vitesh është ndërtuar sistemi kombëtar i metrologjisë, efektiviteti i kërkuar prej tij, ende nuk rezulton të jetë në nivelin e duhur. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, përgjatë periudhës 2018-2020, ka shfaqur mungesë efieience dhe efektiviteti, në ushtrimin e detyrave, në funksion të zhvillimit dhe fuqizimit të sistemit të metrologjisë. Nga ana tjetër, me gjithë përpjekjet e bëra, nuk është arritur niveli i kërkuar i përgatitjes teknike profesionale të stafit të strukturave verifikuese të metrologjisë dhe i bashkëpunimit të tyre me institucionet që janë pjesë e infrastrukturës së cilësisë.

Gjithashtu ndërmarrja e disa nismave ligjore nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë, në periudhë afatgjatë rrezikojnë të ndikojnë negativisht në cilësinë e shërbimit metrologjik të ofruar, por edhe në garantimin e mbrotjes së konsumatorit nga abuzimet me peshën dhe matjen.

Me qëllim zhvillimin, si dhe mbrojtjen e plotë të konsumatorit, është i nevojshëm jo vetëm konsolidimi i këtij sistemi në fushat ekzistuese, por edhe zgjerimi në fusha të reja, veçanërisht në atë të shëndetësisë, të cilësisë së produkteve ushqimore, të sigurimit teknik, etj.

#### **4.1.1.A kanë rezultuar efektive politikat dhe masat e marra nga MFE për garantimin e mbrotjes së konsumatorit nga abuzimet me peshën dhe matjet?**

Përcaktimet në Ligjin nr.126/2020 ËPër Metrologjinë, vlerësohet të mbartin risqe që: (i) pengojnë lëvizjen e lirë të mallrave; (ii) cenojnë cilësinë dhe transparencën e shërbimit të verifikimit të shpërndarësve të karburantit ofruar prej subjektit privat; (iii) si dhe mbrojtjen e konsumatorit nga abuzimet me peshën dhe matjet.

Gjithashtu përjashtimi që i bëhet institucionit publik në ushtrimin e plotë të funksionit të inspektimit të instrumenteve të verifikuara prej koncesionarit/subjekteve të autorizuara nga DPM, rrezikon të bëjë të pakontrollueshëm instrumentet matëse, përdoruesit e tyre dhe shërbimin e verifikimit metrologjik.

Nga ana tjetër, shërbimi i metrologjisë ligjore për verifikimin e shpërndarësve të karburantit dhe gazit të lëngshëm, është deleguar (nëpërmjet koncesionimit) pa ofruar siguri që autoriteti deleges të ketë kapacitete të mjaftueshme për të monitoruar dhe mbikëqyrur zbatimin e detyrave të deleguara si dhe pasur një metodologji dhe manual mbi mënyrën e monitorimit. Mungesa e ekspertëve metrolog, në komisionin e monitorimit të zbatimit të kontratës koncesionare për shërbimin e verifikimit të shpërndarësve të karburantit dhe gazit të lëngshëm, nuk ofrojnë siguri të arsyeshme mbi cilësinë e shërbimit të ofruar prej koncesionarit.

#### **4.1.1.1.A është hartuar nga MFE dhe DPM, kuadri rregullator në përputhje me standartet e BE për metrologjinë?**

Në një sistem metrologjik të peshave dhe matjeve që funksionon mirë në ambjentin tregtar, në bazë të tij qëndrojnë ligje dhe rregullore efektive për të siguruar një treg të rregullt. Ligjet dhe rregulloret duhet të sigurojnë mbrojtjen e konsumatorit duke parandaluar praktikat mashtruese dhe çorientuese, por nuk duhet të jenë të tilla që të rëndojnë bizneset gjatë ushtrimit në kushte normale të aktivitetit. Ato gjithashtu duhet të nxisin konkurrencën e drejtë midis subjekteve të biznesit në aspekte të ndryshme të sistemit të peshave dhe matjeve tregtare. Ligjet, rregulloret dhe standartet teknike duhet të jenë mjaft fleksibile për t'iu përshtatur teknologjisë së re dhe praktikave të marketingut. Përcaktimi i balancës së saktë të këtyre faktorëve të shumtë është një sfidë e madhe dhe e vazhdueshme për sistemin dhe strukturat përgjegjëse të peshave dhe matjeve.

Aktivitetet e sitemit të metrologjisë të peshave dhe matjeve, shpesh, janë të padukshme për publikun. Në përgjithësi, publiku sheh vetëm transaksionet që ndodhin në treg, të tilla si peshimi i mishit, peshimi i produktit në sportelin e arkës dhe shpërndarja e karburantit etj. Infrastruktura komplekse e metrologjisë dhe aktivitetet e shumta të përfshira në zbatimin e legjislacionit të kësaj fushe nuk janë të dukshme për konsumatorët pasi një treg që funksionon mirë, shpesh saktësia e peshave dhe e matjeve merret si e mirëqenë. Ky realitet i bën të rëndësishme përpjekjet e vazhdueshme për të edukuar publikun dhe ligjvënësit, si dhe ndihmuar në sigurimin e mbështetjes për sistemin e metrologjisë të peshave dhe matjeve.



Reforma ligjore në Shqipëri në fushën specifike të Metrologjisë ka kërkuar jo vetëm një rishikim të plotë të legjislacionit ekzistues, por edhe përfshirjen e një sërë fushash dhe institucionesh të reja ligjore shtetërore e private që nuk ekzistonin gjatë regjimit të kaluar totalitar dhe në vitet 90. Për mbështetjen e këtij rindërtimi të plotë të sistemit ligjor ka qenë dhe janë të nevojshme përpjekje të rëndësishme legjislative. Në dimanikën e zhvillimit të sistemit të Metrologjisë në Shqipëri janë ndërmarrë shumë nisma ligjore e ndryshimesh të Ligjit për Metrologjinë ku në mënyrë të përmbledhur paraqiten si më poshtë:

Tabela nr.7 Kronologjia e ndryshimeve të kuadrit rregullator për metrologjinë në Shqipëri

Ligji Nr.	Datë	Përshkrimi
7625	20.10.1992	ËPër njësitë e matjes dhe kontrollin e mjeteve matëseö (metrologjinë)
8818	27.9.2001	ËPër aderimin e Republikës së Shqipërisë në ökonventën për krijimin e organizatës ndërkombëtare të metrologjisë ligjoreö
8996	30.1.2003	ËPër njësitë e matjes dhe kontrollin e mjeteve matëseö (metrologjinë), shfuqizon Ligjin nr.7625/92
9542	22.5.2006	ËPër disa ndryshime në ligjin nr.8996, datë 30.1.2003 ëpër njësitë e matjes dhe kontrollin e mjeteve matëse (metrologjinë)ö
9721	30.4.2007	ËPër një ndryshim në ligjin nr.8996, datë 30.1.2003 ëpër njësitë e matjes dhe kontrollin e mjeteve matëseö
9875	14.2.2008	shfuqizohet Ligji nr.8996/2003
10217	21.1.2010	Për disa ndryshime në ligjin nr.9875, datë 14.2.2008 ëPër metrologjinëö
14	14.02.2013	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9875, datë 14.2.2008 ëPër metrologjinëö, i ndryshuar
100	23.09.2015	ëPër disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9875, datë 14.2.2008, ëPër metrologjinëö, i ndryshuar
9	05.03.2018	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9875, datë 14.2.2008, ëPër metrologjinëö, i ndryshuar
15326	21.08.2019	Shërbimi i kontrollit ligjor të instrumenteve matës nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm (koncensionit 20 vjeçar)

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Baza ligjore në fuqi, ku mbështetet sistemi i metrologjisë nën drejtimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, në ushtrimin e aktivitetit për periudhën 2018-2020, është si më poshtë:

Ligji Nr.9875 datë 14.2.2008, ëPër metrologjinëö, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit më datë 4 Gusht 2006 Shqipëria synon të jetë pjesë e Komunitetit Evropian. Në këtë kuadër përafrimi i legjislacionit të vendit tonë me atë të BE-së në fushën e metrologjisë, implementimi dhe zbatimi i Direktivës së Instrumenteve Matës të BE-së, ka një vlerë të veçantë për vetë faktin se përdorimi i instrumenteve matës është prezent në jetën e përditshme të konsumatorit. Në progres-raportin e Komisionit Evropian të vitit 2020, dorëzuar më datë 6 Tetor 2020 në Bruksel<sup>8</sup>, është evidentuar se, *janë bërë përparime në lidhje me përafrimin e legjislacionit në fushën e metrologjisë.*

DPM është anëtare me të drejta të plota në EURAMET dhe anëtare e asociuar në WELMEC, si dhe ka të deklaruar aftësitë e matjes në fushën e masës, në databazën e Krahasimit të Byrosë Ndërkombëtare të Peshave dhe Masave (BIMP) në lidhje me metrologjinë. Në këto kushte implementimi dhe zbatimi i direktivave/rekomandimeve të këtyre organizatave, si dhe harmonizimi i kuadrit rregullator të vendit tonë me praktikatat e reja dhe më të mira, do të ishte një vlerë e shtuar për metrologjinë shqiptare dhe do të rriste përpjekjet për mbrojtjen e konsumatorit nga abuzimet me peshën dhe matjet. Edhe në ëStrategjinë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjen e Tregut 2020<sup>9</sup>, është vënë theksi dhe cituar se: ë.Për metrologjinë ligjore është shumë i rëndësishëm sigurimi i harmonizimit të rregullave kombëtare me ato ndërkombëtare me qëllim mbështetjen e tregëtisë ndërkombëtare për instrumentet ligjorisht të kontrolluar dhe parapaketimetö.

### **I. Plotësimi i kuadrit rregullator për metrologjinë me aktet nënligjore.**

Bazuar në Ligjin nr. 9875/2008 ëPër Metrologjinëö, ndryshimet dhe aktet nënligjore të tij, është mundësuar ngritja dhe menaxhimi i sistemit kombëtar të metrologjisë ligjore në përputhje me

<sup>8</sup> <https://www.parlament.al/DokumentaIntegrimi?integrimId=2>

<sup>9</sup> Miratuar me VKM nr.753, datë 16.9.2015



nevojat kombëtare dhe pjesërisht me kërkesat e direktivave europiane, si më poshtë vijon:

▪ Referuar raporteve të Planit Kombëtar të Integritimit Evropian 2015-2020 janë përafuar plotësisht ose pjesërisht direktivat:

1-Direktiva nr. 71/316 KE është përafuar e pjesshme nëpërmjet Ligjit nr. 9875/2008 òPër Metrologjinë;

2-Direktiva nr. 80/181/KE e amenduar nga Direktivat nr. 85/1/KE, 89/617//KE dhe 1990/103/KE, është përafuar e plotë me VKM nr. 1162, datë 13.8.2008 ò Për njësitë e tjera matëse;

3-Direktiva nr. 75/107/KE, janë përafuar të plota me VKM nr.1161 datë 13.08.2008 òRregullore për shishet enë matëse;

4-Direktivat nr. 71/317/KE, nr. 74/148/KE, nr. 76/765 KE, nr. 76/766 KE, nr. 86/217 KE dhe nr. 71/347 KE, janë përafuar të plota nëpërmjet VKM nr. 1351, datë 03.10.2008 òPër miratimin e rregullores për kërkesat, teknike dhe metrologjike, për instrumentet matëse, ligjërisht të kontrolluara;

5-Direktivat nr. 76/211/KE, nr. 75/106/KE dhe nr. 80/232/KE janë përafuar të plota nëpërmjet VKM nr. 1352 datë 03.10.2008 òPër miratimin e rregullores për parapaketimet;

6-Direktiva nr. 71/316/KE është përafuar pjesërisht nëpërmjet Urdhërit të Ministrit nr. 195, datë 09.03.2009 òPër verifikimin fillestar dhe pasardhës të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara;

7-Direktiva nr. 2009/23 KE-NAWI, është përafuar me VKM nr. 77, datë 30.1.2013 òPër instrumentet e peshimit jo automatik;

8-Direktiva nr. 2014/32/KE e njohur si òDirektiva e instrumenteve matëse është përafuar pjesërisht nëpërmjet Ligjit nr. 100/2015 òPër disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9875, datë 14.2.2008, òPër metrologjinë, i ndryshuar, me synim harmonizimin e mëtejshëm me *acquis* e BE-së. Përveç kësaj, VKM nr. 770/2016, òPër instrumentet e matjes dhe listën referuese të standardeve përkatëse të harmonizuara, ka përafuar pjesërisht direktivën 2014/32/KE.

Referuar Planit Kombëtar për Integritimin Evropian për vitet 2019-2021, gjatë viteve 2019 dhe 2020 është parashikuar të miratohen aktet nënligjore si më poshtë:

1-Projektvendimi i Këshillit të Ministrave òPër miratimin e rregullores òPër etalonët kombëtar të matjes, i cili do të përafrojë pjesërisht Guidën nr. 1 versioni 2 (01/2015) EURAMET dhe operimi i NMI (Institutit Kombëtar të Metrologjisë), që ka qenë parashikuar të miratohet në tremujorin e tretë të vitit 2019;

2-Projektvendimi òPër njësitë e tjera të matjes jashtë sistemit SIò, i cili do të përafrojë plotësisht Direktivën nr. 2009/3/KE datë 11 mars 2009. Amendimi Direktivës nr. 80/181/KE òPër përafrimin e ligjeve të shteteve anëtare në lidhje me njësitë matëse, që ka qenë parashikuar të miratohet në tremujorin e tretë të vitit 2019;

3-Projektvendimi i Këshillit të Ministrave òPër miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe metrologjike për instrumentet matëse ligjërisht të kontrolluara, i cili do të përafrojë Direktivën nr. 2014/32/KE të datës 26 Shkurt 2014, mbi harmonizimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me vënien në dispozicion në treg të instrumenteve matës, që ka qenë parashikuar të miratohet në tremujorin e dytë të vitit 2020;

4-Ndryshimet në Udhëzimin e Ministrit të MZHETTS nr.1897/3, datë 03.08.2016 për miratimin e rregullores òPër kërkesat dhe procedurat e miratimit, regjistrimit dhe monitorimit të sistemit të kontrollit sasior të prodhuesve të parapaketimeve me shenjë konformiteti, i cili ka përafuar pjesërisht OIML G21 Edicioni 2017 (E) - Guidë për përcaktimin e kërkesave për sistemin e certifikimit të parapaketimeve, që ka qenë parashikuar të miratohet në tremujorin e dytë të vitit 2020.

Sa më lart rezultoi se:

### 1. Gjetje nga auditimi

Përgjatë periudhës 2018-2020, referuar Planit Kombëtar për Integritimin Evropian, MFE dhe DPM nuk kanë marrë masa për hartimin dhe miratimin e:

- Projektvendimit të Këshillit të Ministrave òPër miratimin e rregullores òPër etalonët kombëtarë të matjes;



- Projektvendimit òper njësitë tjera të matjes jashtë sistemit SIò në përafrim të Direktivës nr. 2009/3/KE e cila bën fjalë për njësitë e temperaturave termodinamike Kelvin<sup>10</sup>;
- Projektvendimit për miratimin e rregullores òper kërkesat teknike dhe metrologjike të instrumentave matës ligjërish të kontrolluarò, për harmonizimin me Direktivën nr. 2014/32/KE, në lidhje me vënien në dispozicion në treg të instrumenteve matëse;<sup>11</sup>

## Konkluzione

1. Mungesa e hartimit dhe miratimit të akteve nënligjore të mësipërme, në gjykimin e grupit të auditimit, ka rezultuar në mungesë të përafrimit të plotë, të legjislacionit shqiptar për metrologjinë me legjislacionin e BE, e për rrjedhje në mbështetjen e plotë të tregtisë ndërkombëtare për instrumentet ligjërish të kontrolluar dhe parapaketimet, si dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve metrologjike për konsumatorët.

## Rekomandime

1.1. MFE dhe DPM të marrin masat e nevojshme për hartimin dhe miratimin e Projektvendimit të Këshillit të Ministrave òPër miratimin e rregullores òPër etalonët kombëtar të matjesò; òPër njësitë e tjera të matjes jashtë sistemit SIò; òPër miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe metrologjike për instrumentet matëse ligjërish të kontrolluaraò, me qëllim përafrimin e legjislacionit shqiptar të metrologjisë me Guidën nr. 1 versioni 2 (01/2015) EURAMET, Direktivën nr. 2009/3/KE, Direktivën nr. 2014/32/KE, OIML G21 të legjislacionit të BE-së.

**Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022**

## II. Mbi procesin e hartimit të Ligjit nr.126/2020 “Për Metrologjinë”.

Në vijim të trajtimit të mësipërm mbi plotësimin e kuadrit rregullator për metrologjinë, grupi i auditimit kreu një vlerësim të procesit të hartimit të Ligjit nr.126/2020 òPër Metrologjinëò, të përmbajtjes dhe përafrimit të tij me legjislacionin e BE-së dhe se si mund të ndikoj zbatimi i tyre në performancën dhe cilësinë e shërbimeve metrologjike, ku po parashtrjmë disa fakte, si vijon:

▪ Proçedura për hartimin e projektligjit òPër Metrologjinëò ka filluar me Urdhrin nr.267 datë 15.10.2018 të Ministrit të MFE-së, nëpërmjet të cilit është ngritur grupi i punës (MFE, DPM dhe ISHMT) për rishikimin e draft ligjit òPër Metrologjinëò. Grupi ka detyrë koordinimin e punës sipas fushës së përgjegjësisë që i takon referuar ligjit të metrologjisë dhe konsulton propozimet e bëra nga asistenca e huaj. Pra në vija të përgjithshme, DPM ka përgatitur draftligjin e metrologjisë për pjesën që lidhet me aktivitetin e saj, si dhe ISHMT për inspektimin metrologjik.

▪ Në faqen zyrtare të regjistrit elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike, në të cilin publikohen njoftime dhe konsultime të ndryshme për publikun dhe institucionet përkatëse, në këtë rast MFE, më datë 20.12.2019<sup>12</sup>, është publikuar për konsultim publik Projektligji për Metrologjinë, relacioni shpjegues, si dhe raporti i vlerësimit të ndikimit të këtij Projektligji. Në përmbajtje të **Projektligjit**, më konkretisht në pikat 10 dhe 13 të nenit 8 “**Detyrat dhe kompetencat e DPM**” përcaktohet se DPM:

10. Kryen miratim tipi, verifikim fillestar dhe verifikim periodik të instrumenteve matës ligjërish të kontrolluar.

13. Autorizon dhe monitoron persona juridikë për verifikimin e instrumenteve matëse, ekspertizën metrologjike bazuar në kërkesat e përshkruara.

-Për të vijuar, me përmbajtjen e **raportit të vlerësimit të ndikimit** të Projektligjit, ku pasqyrohet informacioni për **3 opsione**, pra se si do të veprohej me Ligjin nr.9875, datë 14.2.2008 òPër Metrologjinëò, i ndryshuar, konkretisht:

Opsioni 0 ó Të vazhdohet me ligjin nr.9875, datë 14.2.2008 òPër Metrologjinëò, i ndryshuar;

**Opsioni 1: Shfuqizimi i ligjit nr. 9875, datë14.02.2008 òPër metrologjinëò i ndryshuar dhe hartimi i një ligji të ri;**

Opsioni 2: Ndryshimi i ligjit ekzistues nr. 9875, datë 14.02.2008 òPër metrologjinëò i ndryshuar.

<sup>10</sup> <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32009L0003&from=EN>

<sup>11</sup> <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32014L0032&from=EN>

<sup>12</sup> [www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/243](http://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/243).



-Në vijim të opsioneve të mësipërme, nga grupi i punës ngritur pranë MFE, është bërë edhe vlerësimi i kostove dhe përfitimeve monetare të përcaktuar në milionë lekë për 10 vjet, për opsionet nr.1 dhe 2. Më poshtë kemi pasqyruar të dhënat vetëm **për opsionin nr.1**, referuar kushteve në të cilat ndodhemi, pra të hartimit dhe miratimit të Ligjit nr.126/2020 òPër Metrologjinë, si një ligj i ri.

Tabela nr.8 - Të ardhurat që do të realizohen sipas **opsionit 1** - Shfuqizimi i ligjit nr. 9875, datë 14.02.2008 òPër metrologjinë e ndryshuar dhe hartimi i një ligji të ri.

*Në mijë lekë*

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Përfitimi për buxhetin ó në vazhdim	122,1	121	123	125,5	127,9	130,5	133,1	135,7	138,4	141,2
<b>Përfitimi në total</b>	1.298,4									
<b>Përfitimi I zbritur në total =</b> Përfitimi në total x faktorin zbritës	1.043,3									

Burimi: raporti i vlerësimit të ndikimit MFE dhe DPM, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH<sup>13</sup>

-Pra sipas të dhënave të mësipërme, rezulton se, të ardhurat që do të realizohen nga shërbimet metrologjike që do të ofrohen prej DPM për 10 vitet në vazhdim, **do të jenë mesatarisht rreth 130 milion lekë në vit**. Theksojmë se pjesë e kësaj vlere, janë parashikuar edhe të ardhurat që DPM ka realizuar deri në muajin Nëntor të vitit 2019 (datë e raportit të vlerësimit të ndikimit), nga ofrimi i shërbimit të verifikimit të shpërndarësve të karburantit dhe gazit të lëngshëm.

▪ Duke vijuar me Ligjin nr.126 të Metrologjisë, miratuar datë 15.10.2020, si dhe shkronjat ògò dhe òhò në nenin 8 "**Detyrat dhe kompetencat e DPM**" të ligjit (ose pikat 10 dhe 13 të nenit 8, të Projektligjit të publikuar në faqen zyrtare cituar më sipër), ku përcaktohet se DPM:

- g) Kryen miratim tipi, verifikim fillestar dhe verifikim periodik të instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara, **përveç rasteve** kur me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi **është autorizuar ofrimi i këtyre shërbimeve** nga ana e personave juridikë privatë;
- h) Autorizon dhe monitoron personat juridikë për verifikimin e instrumenteve matëse, bazuar në kërkesat e përshkruara, **përveç rasteve** kur këto shërbime u janë dhënë personave juridikë privatë me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi.

-Pra përcaktimet e mësipërme të Ligjit nr.126/2020 òPër Metrologjinë, në dallim nga përcaktimet e bëra në Projektligjin e publikuar në faqen zyrtare të cituar më sipër, **ndryshojnë**, pasi në variantin e ligjit të miratuar është shtuar paragrafi ò...**përveç rasteve** kur me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi **është autorizuar ofrimi i këtyre shërbimeve** nga ana e personave juridikë privatë, pra që lidhet **me dhënien me koncesion** të shërbimit të verifikimit të shpërndarësve të karburantit dhe gazit të lëngshëm. Thënë kjo, pasi pjesa tjetër e funksioneve të DPM (miratim tipi, verifikim fillestar dhe verifikim periodik të instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara, si dhe autorizimi dhe monitorimi i personave juridikë për verifikimin e instrumenteve matëse, bazuar në kërkesat e përshkruara), ka qenë edhe para ndryshimeve të mësipërme.

Nëpërmjet përcaktimeve të mësipërme në Ligjin nr.126/2020 òPër Metrologjinë, pra ndryshe nga ato të Projektligjit të publikuar, DPM nuk do të kryejë më shërbimin e verifikimit të shpërndarësve të karburantit dhe gazit të lëngshëm.

*Kjo do të thotë se, të ardhurat nga ky shërbim<sup>14</sup>, të cilat arkëtohen në buxhetin e shtetit<sup>15</sup>, nuk do të arkëtohen në vazhdim.*

-Sa më sipër, nga shqyrtimi i Projektligjit të publikuar në faqen zyrtare të konsultimit publik, në

<sup>13</sup> **Shënim 1:** Tarifat e shërbimit që zbaton DPM janë tarifa me TVSH. Të ardhurat e hedhura në tabelë janë plani pa TVSH, që do të thotë që në buxhet shkojnë në formën e TVSH edhe 20% të ardhura mbi ato që janë në tabelë.

**Shënim 2:** Parashikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve përtej periudhës 2020-2022 është mbështetur në një rritje mesatare me 2 %.

<sup>14</sup>DPM në vitin 2019 ka realizuar 76,000,000 lekë, vetëm nga tarifa e shërbimit të verifikimit të shpërndarësve të karburantit dhe gazit të lëngshëm, ose 60% të të ardhurave gjithësej, që realizon DPM. Këto të ardhura derdhen në buxhetin e shtetit.

<sup>15</sup> VKM nr.571, datë 29.08.2012 òPër lejimin e përdorimit të pjesshëm të të ardhurave të realizuara nga DPM gjatë shërbimeve metrologjike, për zhvillimin, mirëmbajtjen dhe njohjen ndërkombëtare të etalonëve kombëtare të matjeve. Udhëzimi nr.2, datë 08.02.2013 òPër tarifatat dhe pagesat e shërbimeve të DPM-së.



krahasim me variantin e miratuar të ligjit, pra Ligji nr.126/2020 ËPër metrologjinë, dokumentacionit të vënë në dispozicion nga DPM dhe MFE, rezultoi se:

## 2. Gjetje nga auditimi

-Nga krahasimi i Projektligjit të publikuar në web<sup>16</sup> me ligjin e miratuar nr. 126/2020 ËPër Metrologjinë, rezultuan ndryshime në kompetencat e DPM-së. Në Projektligj, në pikat 10 dhe 13 të nenit 8 ËDetyrat dhe kompetencat e DPMë përcaktohet se: *“DPM kryen miratim tipi, verifikim fillestar dhe verifikim periodik të instrumenteve matës ligjërish të kontrolluar; dhe DPM autorizon dhe monitoron persona juridikë për verifikimin e instrumenteve matëse, ekspertizën metrologjike bazuar në kërkesat e përshkruara”*; **ndërsa** referuar Ligjit nr.126/2020 *“Për metrologjinë, në nenin 8, pikat 10 dhe 13 përcaktohet se: ËDPM kryen miratim tipi, verifikim fillestar dhe verifikim periodik të instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara, përveç rasteve kur me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi është autorizuar ofrimi i këtyre shërbimeve nga ana e personave juridikë privatë; si dhe DPM autorizon dhe monitoron personat juridikë për verifikimin e instrumenteve matëse, bazuar në kërkesat e përshkruara, përveç rasteve kur këto shërbime u janë dhënë personave juridikë privatë me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi”*. Ndryshimi i kompetencave të DPM-së **nuk** ka gjetur reflektim as në raportin e vlerësimit të ndikimit<sup>17</sup>, ku në opsionin respektiv, edhe pse shërbimi i metrologjisë ligjore për karburantin dhe gazin e lëngshëm është dhënë me koncesion, kanë vijuar të reflektohen të ardhurat e krijuara nga DPM për këtë shërbim. Sa më sipër, jo vetëm cenon parimin e transparencës gjatë procesit të njoftimit e konsultimit publik<sup>18</sup>, por gjithashtu nuk jep siguri që vlerësimi ekonomik i skenarëve sipas raportit të vlerësimit të ndikimit, të ketë mbështetur Ligjin nr.126/2020 ËPër metrologjinë. Në këtë mënyrë, si dhe duke pasur në konsideratë të ardhurat e DPM, realizuar nga shërbimi i mësipërm në një vit kalendarik<sup>19</sup>, përcaktimet e bëra në Ligjin nr.126/2020 ËPër metrologjinë, **do të ndikojnë direkt në reduktimin e të ardhurave të DPM-së, e për rrjedhojë në të ardhurat e buxhetit të shtetit.**

## Konkluzione

2.Publikimi në faqen zyrtare të MFE, të Projektligjit të metrologjisë për konsultim publik, variant, i cili nuk lidhet me Ligjin e miratuar nr.126/2020, kryesisht në heqjen e disa prej kompetencave të DPM-së, cituar më sipër, si dhe pasaktësia e kryerjes së vlerësimit ekonomik-financiar të Ligjit nr.126/2020 ËPër metrologjinë, në gjykimin e grupit të auditimit tregon mungesë transparence të MFE-së përballë palëve të interesit, në periudhë afatgjatë mund të ndikojë negativisht në të ardhurat e DPM, e për rrjedhojë në të ardhurat e buxhetit të shtetit, si dhe nuk jep siguri që vlerësimi ekonomik i skenarëve sipas raportit të vlerësimit të ndikimit, të ketë mbështetur Ligjin nr.126/2020 ËPër metrologjinë.

## Rekomandime

2.1. MFE të marrë masat e nevojshme për ngritjen e një grupi me qëllim analizën e situatës dhe verifikimin e raportit të analizës ekonomike-financiare të Ligjit nr.126/2020 ËPër metrologjinë, me qëllim dokumentimin e plotë të procedurës së hartimit dhe miratimit të këtij ligji dhe publikimin e versionit përfundimtar së bashku me dokumentacionin shoqërues, në faqen zyrtare të konsultimit publik si dhe në faqen zyrtare të MFE-së.

**Menjëherë**

## **II.1.Përafrimi i Ligjit nr.126/2020 “Për Metrologjinë” me standardet e BE.**

Duke vijuar me parashtrimin e fakteve që lidhen me përafrimin e Ligjit nr.126/2020 ËPër Metrologjinë me standardet e BE-së:

**Në nenin 18,** parashikohet se:

*“3. Instrumentet matëse ligjërish të kontrolluar, vendosen në treg dhe/ose vihen në përdorim vetëm*

<sup>16</sup> [www.konsultimipublik.gov.al](http://www.konsultimipublik.gov.al)

<sup>17</sup> [www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/243](http://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/243)

<sup>18</sup> Në kundërshtim me (neni 5 i ligjit nr. 146/2014 ËPër njoftimin dhe konsultimin publik)

<sup>19</sup> DPM në një 1 vit kalendarik, ka arkëtuar 76,000,000 lekë, vetëm nga tarifa e shërbimit të verifikimit të shpërndarësve të karburantit dhe gazit të lëngshëm, ose 60% të të ardhurave gjithësej, që arkëton DPM.





*nëse janë instrumenta matës inteligjentë (smart);*

*4. Instrumentet matës ligjërish të kontrolluara jo inteligjentë lejohet të vendosen në treg deri në 1 janar 2023;*

*5. Instrumentet matës ligjërish të kontrolluar jo inteligjentë lejohet të përdoren në treg deri në 1 dhjetor 2028".*

**Në nenin 22, pika 1,** parashikohet se:

*Të gjithë instrumentet matëse ligjërish të kontrolluara, që kanë marrë miratimin e tipit dhe plotësojnë kërkesat teknike dhe metrologjike, i nënshtrohen verifikimit që mund të jetë fillestar, pasardhës, periodik i rregullt, i kryer në intervale kohore specifike dhe jashtë radhe.*

***Në varësi të analizës së riskut dhe problematikave të tregut, po në çdo rast jo me pak se 5%, periodiciteti i verifikimeve të lartpërmendura do të jetë, të paktën, objekt dyfishimi.** Verifikimi i instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara, të hidrokarbureve dhe gazit të lëngshëm, që kanë marrë miratimin e tipit dhe plotësojnë kërkesat teknike dhe metrologjike, bëhet jo më pak se dy herë në vit dhe përfshin kontrollin dhe sigurimin e regjimit automatik.*

**Në nenin 34 pika 2,** parashikohet se:

*2. Kostot që dalin gjatë testimit të jashtëzakonshëm dhe matjeve zyrtare të instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara do të paguhen nga:*

*a) pala kërkuese në rastin kur instrumenti ka shenjën e verifikimit të vlefshme dhe nga testimi i jashtëzakonshëm rezulton në përputhje me kërkesat metrologjike;*

*b) përdoruesi i instrumentit matës kur nga testimi i jashtëzakonshëm rezulton që instrumenti është jo në përputhje me kërkesat metrologjike.*

**Në nenin 48 pika 2 dhe shkronja "c" në pikën 3,** parashikohet se:

*2. Në rastet kur kryerja e shërbimeve, objekt i këtij ligji, realizohet ekskluzivisht nga persona juridikë privatë, të autorizuar me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi, inspektimi metrologjik përfshin vetëm **ekzaminimin fizik dhe dokumentar** të produkteve apo proceseve objekt të këtij ligji. Vetëm në raste përjashtimore dhe gjithmonë me vendim gjykate, inspektimi metrologjik mund të përfshijë edhe ekzaminimin laboratorik për të realizuar kontrollin e përcaktuar në pikën 1 këtij neni.*

*3/c. **Bllokim të instrumentit matës** në rast moskonformiteti, **përveç** rasteve të kryerjes së verifikimit nëpërmjet inspektimit nga **persona juridikë privatë**, të autorizuar me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi.*

**Në nenin 50 pika 3,** parashikohet se:

*3. Në rastin e instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara në përdorim, të cilat konstatohen jo në konformitet me rregullat teknike, personat juridikë privatë, të autorizuar me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi, ose inspektori vendosin bllokimin deri në kthimin e tyre në konformitet dhe njoftojnë organet e tjera kompetente shtetërore.*

Sa më sipër rezultoi se:

### **3. Gjetje nga auditimi**

**a) Përcaktimet në nenin 18,** në Ligjin nr.126/2020 òPër Metrologjinë janë në kundërshtim me vetë shkronjën òçò të nenit 1 òQëllimi i ligjitò, konkretisht në pikën parashikohet shprehimisht: **ç) lëvizjen e lirë të instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara, të cilat janë objekt i markimit CE<sup>20</sup>.** Ky nen lejon lëvizjen e lirë të instrumentave matës që kanë markimin CE, pavarësisht nëse janë inteligjent ose jo.

Gjithashtu bien në kundërshtim me:

i. Direktivën e BE-së nr.2014/32/EU të datës 26.02.2014 për sa i përket lëvizjes së lirë në treg të instrumentave matës<sup>21</sup>, paragrafi 13: òPër të siguruar qarkullimin e lirë të instrumentave matës në

<sup>20</sup> Ligji nr.10 489, datë 15.12.2011 òPër tregtimin dhe mbikëqytjen e tregut të produkteve joushqimoreò, i ndryshuar, ku përcaktohet: òMarkim CEò është markimi, me të cilin prodhuesi tregon që produkti është në përputhje me kërkesat e legjislacionit të zbatueshëm, kur ky legjislacion parashikon fiksimin e këtij markimi.

<sup>21</sup> <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32014L0032>



Bashkimin Evropian, Shtetet Anëtare nuk duhet të pengojnë vendosjen në treg dhe/ose vënien në përdorim i instrumenteve matëse që mbajnë markën CE dhe shënimi plotësues metrologjik në përputhje me dispozitat e kësaj direktive.

ii. Direktivën e BE-së nr.2014/31/EU të datës 26.02.2014 për harmonizimin e ligjit të metrologjisë me shtetet anëtare për sa i përket lëvizjes së lirë në treg të instrumentave jo-automatik të peshave<sup>22</sup>, me parimet e lëvizjes së lirë të mallrave (NAWI), **neni 5 “Lëvizja e lirë e instrumenteve”** - Shtetet anëtare **nuk do të pengojnë vënien në dispozicion të tregut të instrumenteve që plotësojnë kërkesat e kësaj Direktive**. Termi i përdorur ojointeligjentë nuk ka të bëjë me fushën e metrologjisë.

b) Frekuenca e verifikimit periodik të shpërndarësve të karburantit dhe gazit të lëngshëm, referuar praktikave të mira në vendet e rajonit si Mali i Zi, Kosova, Serbia, Kroacia, Maqedonia e Veriut dhe Bullgaria<sup>23</sup>, është 1 verifikim në 1-2 vjet, **ndërkohë sipas përcaktimeve në pikën 1, të nenit 22 të Ligjit nr.126/2020** ËPër Metrologjinë, frekuenca e verifikimit në Shqipëri parashikohet 2 herë në vit, me përcaktimin se në të ardhmen edhe mund të rritet. Rritja e frekuencës së verifikimit metrologjik, sjell rritjen e kostos së subjektit që po përfiton shërbimin e verifikimit, e për rrjedhojë edhe kostot për produkt apo shërbim që do të ofrohet nga ky subjekt ndaj palëve të treta, duke rrezikuar që çmimet e rritura si pasojë e verifikimeve të shpeshta, t’i përballojë hallka e fundit e zinxhirit, që është konsumatori.

c) Përcaktimet në **nenin 34, pika 2, të ligjit nr. 126/2020**, trajtojnë ndër të tjera kostot dhe përgjegjësinë pas kryerjes së *“Ekspertizës metrologjike”*. Referuar praktikave të mira, si ligji për metrologjinë në Malin e Zi, në nenin 24<sup>24</sup> të tij, përcaktohet se: ËTestimin e jashtëzakonshëm/Ekspertizën Metrologjikeë pas një ankese për instrumentin matës, e kryen Byroja e Metrologjisë, si dhe në rast se nga testimi, instrumenti rezulton në rregull, kostot i përballon ankimuesi, ose në rast se ndodh e kundërta, **kostot e testimit i paguan subjekti që ka kryer verifikimin metrologjik**. Për analogji, duke iu referuar praktikës së mirë, ËEkspertizën metrologjike/Testimin e jashtëzakonshëm, mund ta kryejë Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (dhe jo një trupë ndërkombëtare e akredituar) dhe në rast se nga testimi, instrumenti rezulton në rregull, shpenzimet duhet t’i paguajë ankimuesi, ose në rast se ndodh e kundërta, shpenzimet duhet t’i paguajë koncesionari/subjekti i autorizuar nga DPM, i cili ka kryer verifikimin e instrumentit në fjalë; **ndërkohë sipas nenit 34 të ligjit të metrologjisë, në rast se, instrumenti nuk rezulton në rregull, megjithëse jo për shkak të përdoruesit të tij**, kostot i paguan përdoruesi i instrumentit matës, duke përjashtuar kështu rastet kur shkak mund të jetë subjekti privat që ka bërë verifikimin jo të saktë.

d) Përcaktimet në **nenin 48 dhe 50 të Ligjit nr.126/2020** ËPër Metrologjinë, bien në kundërshtim me Kreun II ËQëllimi dhe parimet e inspektimit; Kreun III ËOrganizimi dhe funksionimi i inspektorateve në nivel qendror dhe vendor; Kreun IV ËRregulla të përgjithshme për programin e inspektimit, dhe Kreun V ËProcedura e inspektimit në Ligjin nr.10433ë, datë 16.06.2011 ËPër inspektimin në Republikën e Shqipërisë, ku përcaktohet se, **vetëm institucionet shtetërore të nominuara inspektoriate në bazë të ligjit kryejnë detyra inspektimi dhe ndërmarrin sanksione administrative**. Gjithashtu në pikën 2 të nenit 48 të ligjit të metrologjisë, ka një trajtim me dy standarde, pasi kur verifikimi metrologjik i instrumenteve matës kryhet nga koncesionari/subjekti i autorizuar, inspektimi metrologjik përfshin vetëm ekzaminimin fizik dhe dokumentar të produkteve apo proceseve objekt të këtij ligji dhe jo atë laboratorik (sikundër ndodh në rast se ky shërbim ofrohet nga DPM), duke implikuar kështu inspektime më pak të thelluara në rastet e subjekteve private.

## Konkluzione

3. Përcaktimet e mësipërme të Ligjit nr.126/2020 ËPër metrologjinë, në gjykimin e grupit të auditimit, bazuar edhe në praktikën e mira mund të pengojnë lëvizjen e lirë të mallrave, të cenojnë cilësinë dhe transparencën e shërbimit të verifikimit të shpërndarësve të karburantit, ofruar prej

<sup>22</sup> <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32014L0031&qid=1635418184908>

<sup>23</sup> <https://www.welmec.org/legal-metrology-information/country-information/country>

<sup>24</sup> [https://metrologija.me/wp-content/uploads/zakonodavstvo/eng/Law\\_Metrology.pdf](https://metrologija.me/wp-content/uploads/zakonodavstvo/eng/Law_Metrology.pdf)



subjektit juridik privat, si dhe të ndikojnë negativisht në mbrojtjen e konsumatorit nga abuzimet me peshën dhe matjet. Theksojmë se, përjashtimi që i bëhet institucionit publik në ushtrimin e plotë të funksionit të inspektimit, psh., në rastin e karburanteve dhe gazit të lëngshëm, praktikisht i bën të pakontrollueshme instrumentet matës, përdoruesit e tyre dhe cilësinë e shërbimit të verifikimit që ofrohet nga koncesionari, duke rritur mundësinë e dëmtimit të interesave të konsumatorit.

-Për më tepër që sipas shkronjës òcò të pikës 3 në nenin 48, inspektorit të ISHMT, i është hequr e drejta e bllokimit të instrumentit matës (kur ky instrument verifikohet nga koncesionari/subjekti i autorizuar). Kjo do të thotë se, të drejtën e bllokimit òpra marrjen e masës administrative të instrumentit matës, ligji ia ka njohur koncesionarit/subjektit të autorizuar, i cili më përpara ka kryer shërbimin e verifikimit të këtij instrumenti. Ndërkohë theksojmë se, subjektet e autorizuar nga DPM, vetë DPM dhe koncesionari, **kanë të drejtë vetëm verifikimin metrologjik të instrumentit, jo edhe marrjen e masave administrative.** Në këto kushte, në gjykimin e grupit të auditimit, ligjvënësi nuk mund të jetë i sigurt, që koncesionari/subjekti i autorizuar do të bllokojë një instrument, të cilin më përpara e ka verifikuar vetë ai.

-Një çertifikatë e verifikimit të instrumenteve matës siguron një "foto të menjëhershme" të sjelljes metrologjike të instrumentit specifik në kohën e verifikimit. Çdo keqpërdorim i instrumentit pas verifikimit mund të çojë në devijime në performancën metrologjike. Në këtë kuptim, prania e çertifikatës së verifikimit në vetvete nuk siguron garanci për matje të sakta dhe të besueshme në vijimësinë e përdorimit të instrumentit. Për këtë arsye, duhet të ndërmerren inspektime gjatë përdorimit të instrumentit matës.

Në mbështetje të gjetjeve të mësipërme, bazuar në praktikën më të mira ndërkombëtare, vlerësojmë se, inspektimi metrologjik ka rol të rëndësishëm për mbrojtjen e konsumatorit nga abuzimi me peshat dhe matjet. Nëpërmjet rekomandimeve që bëhen në praktikën ndërkombëtare, siç janë: Guidat e OIML D20 D6<sup>25</sup> D9<sup>26</sup>, D3<sup>27</sup>, D1<sup>28</sup>, Kapitulli 2.4 - **Kontrolli metrologjik ligjor** (VIML 2.1), përfshin:

- Kontroll ligjor të instrumenteve matëse (verifikimin);
- Supervizionim e Mbikëqyrje metrologjike (inspektimin);
- Ekspertizë metrologjike<sup>29</sup>.

Referuar, **òGuidës së OIML D20 artikulli 3.3.3"** - Zgjedhja e organizatës verifikuese, rekomandohet:

-Në përgjithësi shërbimi ligjor i metrologjisë do të kryejë verifikimin periodik. Megjithatë, një subjekt privat mund të autorizohet për ta bërë këtë shërbim, që mund të jenë disa përdorues që lejohet ose kërkohet për ta bërë këtë shërbim. Në raste të tilla, shërbimi ligjor i metrologjisë duhet të kualifikojë subjektin që kryen verifikimin dhe **mund të kryejë kontrole "spot check"** për performancën e verifikimit periodik<sup>30</sup>.

## Rekomandime

**3.1.Me qëllim mbrojtjen e konsumatorit nga abuzimet me peshën dhe matjen, si dhe përafrimin e Ligjit nr.126/2020 òPër Metrologjinë me direktivat e BE-së, Ministria e Financës dhe Ekonomisë të marrë masat e nevojshme, si dhe vlerësimin rast pas rasti të gjetjeve më sipër, me qëllim propozimin në Këshillin e Ministrave, të ndryshimeve ligjore në Ligjin nr.126/2020 òPër metrologjinë, konkretisht:**

**-Në nenin 18,** të hiqen pikat 2, 3, 4, 5 dhe 6.

**-Në pikën 1 të nenit 22,** të shtohet paragrafi òAnaliza e riskut dhe problematikave në treg, lidhur me instrumentet matës, me qëllim dyfishimin e peridocitetit të verifikimit, të bëhet nga një grup i përbashkët pune ndërmjet DPM dhe ISHMT, dhe pas miratimit nga ky grup, të vihet në zbatim rritja e peridocitetit të verifikimeve të instrumenteve matës.

<sup>25</sup> [https://www.oiml.org/en/files/pdf\\_d/d016-e11.pdf](https://www.oiml.org/en/files/pdf_d/d016-e11.pdf)

<sup>26</sup> [https://www.oiml.org/en/files/pdf\\_d/d009-e04.pdf](https://www.oiml.org/en/files/pdf_d/d009-e04.pdf)

<sup>27</sup> [https://www.oiml.org/en/files/pdf\\_d/d003-e79.pdf](https://www.oiml.org/en/files/pdf_d/d003-e79.pdf)

<sup>28</sup> [https://www.oiml.org/en/files/pdf\\_d/d001-e12.pdf](https://www.oiml.org/en/files/pdf_d/d001-e12.pdf)

<sup>29</sup> [https://www.oiml.org/en/files/pdf\\_d/d009-e04.pdf](https://www.oiml.org/en/files/pdf_d/d009-e04.pdf)

<sup>30</sup> [https://www.oiml.org/en/files/pdf\\_d/d020-e88.pdf](https://www.oiml.org/en/files/pdf_d/d020-e88.pdf)



-Në vijim të shtohet paragrafi ÷Subjektet private juridike të autorizuara me një nga format e legjislacionit në fuqi të raportojnë periodikisht pranë ISHMT dhe DPM, problematikat e ndeshura në treg lidhur me instrumentet matëse, me qëllim që ky raportim të shërbejë për DPM dhe ISHMT për vlerësimin e riskut.

**-Në shkronjën “b” në pikën 2 të nenit 34,** të riformulohet paragrafi si vijon ÷përdoruesi i instrumentit matës kur nga testimi i jashtëzakonshëm rezulton që instrumenti është jo në përputhje me kërkesat metrologjike, vetëm nëse provohet se, instrumenti nuk është në përputhje me kërkesat metrologjike për shkak të ndërhyrjes së palejuar të vetë përdoruesit.

Në vijim të shtohet shkronja ÷cö me përmbajtje ÷subjekti që ka kryer shërbimin e verifikimit metrologjik, në rastin kur provohet se në instrumentin matës nuk është bërë asnjë ndërhyrje nga përdoruesi i tij;

**-Pika 2 e nenit 48,** të riformulohet si vijon: ÷Kur ka dyshime për një funksionim jokorrekt të instrumentit matës ligjërisht të kontrolluar, si pasojë e një informacioni të ardhur nga të tretë, apo ankese, ose një vlerësimi rrisht nga inpektoriati sipas një metodologjie të mirpërcaktuar, inspektimi metrologjik mund të përfshijë edhe ekzaminimin laboratorik për të realizuar kontrollin e përcaktuar në pikën 1 këtij neni.

-Në vijim në shkronjën ÷cö të pikës 3 të nenit 48 të hiqet paragrafi ÷përveç rasteve të kryerjes së verifikimit nëpërmjet inspektimit nga persona juridikë privatë, të autorizuar me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi.

**-Në pikën 3 të nenit 50,** të hiqet shprehja ÷personat juridikë privatë, të autorizuar me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi.

## **Brenda 6 mujorit të dytë të vitit 2022**

### **III.Koncesioni i shërbimit të verifikimit metrologjik si iniciativë ligjore e ndëmarrë nga MFE dhe si pjesë integrale e Ligjit nr.126/2020 “Për Metrologjinë”.**

-Duke qenë se, qëllimi i auditimit të performancës në këtë kapitull, lidhet me nënpyetjen mbi efektivitetin e politikave për të garantuar mbrojtjen e konsumatorit nga abuzimet me peshën dhe matjen, fokusi ynë do të jetë vetëm vlerësimi i monitorimit të ekzekutimit të kontratës koncesionare nga MFE, me qëllim dhënien e sigurisë së arsyeshme nëse garantohet konsumatori nga abuzimet me peshën dhe matjen.

Krahas nismës ligjore për hartimin e ligjit të ri për metrologjinë, filluar në muajin Tetor 2018, MFE pothuajse paralelisht, që nga viti 2016 ka ndëmarrë dhe nismën ligjore për dhënien me koncension të shërbimit metrologjik (kryer nga DPM) të “*verifikimit periodik të shpërndarësve të karburantit dhe gazit të lëngshëm*”, ku si rezultat në fund të procesit, ndërmjet MFE dhe shoqërisë ÷N.Iö shpk, është nënshkruar kontrata koncesionare nr.15326 prot., datë 21.08.2019. Nëpërmjet kësaj kontrate, subjekti ÷N.Iö i është dhënë e drejta që të kryejë shërbimin e “*verifikimit periodik të shpërndarësve të karburantit dhe gazit të lëngshëm*”, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë gjatë një periudhe 20 vjeçare, si dhe të arkëtojë të ardhurat që vijnë nga mbledhja e tarifës së shërbimit të verifikimit metrologjik.

Pas lidhjes së kontratës, me shkresën nr.2144 prot., datë 31.01.2020, MFE ka njoftuar subjektet përdorues të instrumenteve matës të shpërndarjes së karburantit dhe gazit të lëngshëm ÷mbi kalimin e kontrollit ligjorë nëpërmjet verifikimit të instrumenteve të shpërndarjes së karburantit dhe gazit të lëngshëm shoqërisë ÷N.Iö shpk. Shërbimi fillon të kryhet nga shoqëria koncesionare nga data 31.03.2020 e në vazhdim.

Gjithashtu Sekretari i Përgjithshëm i MFE, në detyrë për periudhën e mësipërme, me shkresën nr.5774 prot., datë 24.03.2020 i ka kërkuar DPM, që pas datës 31.03.2020 të mos kryejë më shërbimin e verifikimit të instrumenteve matës të shpërndarjes së karburantit dhe gazit të lëngshëm, për arsye se, ky shërbim do të kryhet nga subjekti privat i koncensionit.

-Në vijim të këtij komunikimi, pas muajit Mars, DPM e ka ndërprerë ushtrimin e funksionit të saj, pra të verifikimit të instrumenteve të shpërndarjes së karburanteve dhe gazit të lëngshëm.

Në vijim, parashtrijmë disa të dhëna, vendosur në dispozicion nga DPM, për shërbimin e ofruar



prej saj, të verifikimit të shpërndarësve të karburantit dhe gazit të lëngshëm, si më poshtë:

- DPM në një vit kalendarik ka arkëtuar nga tarifa e shërbimit të verifikimit të shpërndarësve të karburantit dhe gazit të lëngshëm, mesatarisht rreth 76,000,000 lekë;
- Tarifa e shërbimit të verifikimit të një shpërndarësi, është 6,000 lekë<sup>31</sup>, e pandryshuar në vite;
- Për kryerjen e këtij shërbimi, përgjatë periudhës 2009-2014 janë investuar 63,975,994 lekë<sup>32</sup> në blerjen e 9 autolaboratorëve dhe pajisjeve të nevojshme (seri enësh standarte volumore çeliku inoks);
- Janë punësuar 9 specialist metrologë, me një pagë mesatare 61,000 lekë/muaj;
- Për realizimin e shërbimit të mësipërm, DPM ka një procedurë verifikimi titulluar "Verifikimi periodik i shpërndarësve të hidrokarbureve të lëngëtao e bazuar në rekomandimet ndërkombëtare të metrologjisë ligjore OIML-së;

#### 4.Gjetje nga auditimi

Dhënia me koncesion e shërbimit të verifikimit të shpërndarësve të karburantit dhe gazit të lëngshëm, ka sjell që, investimet e kryera në DPM në vlerën prej 63,975,994 lekë, për blerjen e autolaboratorëve dhe pajisjeve (**që mund të përdoren vetëm për verifikimin e këtyre instrumenteve**), të mos i shërbejnë më qëllimit për të cilin ato janë shpenzuar, duke i bërë jo efektive dhe jo eficiente, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikat 24 dhe 25 të nenit 3, shkronjën òço të nenit 4, shkronjën òbò të nenit 19, të Ligjit nr.9936, datë 26.08.2008 òPër menaxhimin e sistemit buxhetorò, i ndryshuar.

#### Konkluzione

4.Dhënia me koncesion e shërbimit të verifikimit të shpërndarësve të karburantit dhe gazit të lëngshëm, ka nxjerrë jashtë përdorimit investimet prej 63,975,994 lekë, të kryera në DPM, për blerjen e autolaboratorëve dhe pajisjeve të nevojshme për kryerjen e këtij shërbimi.

#### Rekomandime

4.1.DPM të marrë masat e nevojshme, për transferimin pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit/Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, të autolaboratorëve dhe pajisjeve, përdorur për kryerjen e shërbimit të verifikimit të shpërndarësve të karburantit dhe gazit të lëngshëm, me qëllim shitjen e tyre/vendosjen në përdorim.

**Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022**

### III.1.Përmbajtja e Kontratës Koncesionare

Përgjatë shqyrtimit të Ligjit nr. 126/2020 dhe paralelisht me të edhe të kontratës koncesionare me qëllim krahasimin e tyre, rezultoi se, nenet 14 dhe 21 të kësaj kontrate, kanë të bëjnë me marrjen e kompetencave inspektuese të Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut dhe mbajtjen e një risku të lartë financiar nga MFE ose subjektet përdorues të instrumenteve deri tek konsumatori, ndërkohë që koncesionari ka mbajtur vetëm riskun e investimit, ku rezultoi se:

**-Në nenin 14**, pika 14.3, shkronja òaò: *"Pas fillimit të kryerjes së shërbimit, Palët mund të bien dakort për rritjen e frekuencës së verifikimit të rregullt të instrumenteve matës, për një periudhë tranzitore, në rast se:*

*a. Gjatë kryerjes së verifikimeve në terren rezulton se mbi 5% e totalit të instrumenteve matës të verifikuara rezultojnë me probleme.*

-Në vijim të përcaktimit të mësipërm, sa i përket rritjes së frekuencës, rezultoi se, është parashikuar edhe në nenin 22 pika 1 në Ligjin nr.126/2020 òPër Metrologjinëò, ndërsa në ligjin e mëparshëm të metrologjisë nr.9875, datë 14.02.2008 nuk ka ekzistuar, duke përshtatur kështu ligjin nr.126/2020 òPër Metrologjinëò me kontratën koncesionare.

**-Në nenin 14**, pika 14.6: *"Nëse në çdo kohë, pas datës efektive Koncesionari/Shoqëria Koncesionare pëson një pakësim në të ardhurat e tij sipas kësaj kontrate, për rrjedhojë të rënies së*

<sup>31</sup>Udhëzimin e Përbashkët nr. 2, datë 08.02.2013 òTarifat dhe pagesat e shërbimeve të Drejtorisë të Përgjithshme të Metrologjisë (DPM)ò, miratuar nga Ministria e Financave dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik Tregëtisë dhe Sipërmarrjes

<sup>32</sup> Viti 2009 ó 4 Autolaborator në vlerën 28,766,059 lekë; Viti 2012 ó 2 Autolaborator në vlerën 17,809,935; Viti 2014 ó 3 Autolaborator në vlerën 17,400,000 lekë.



*numrit të inspektimeve me mbi 5%, që vjen vetëm si pasojë e ndryshimeve ligjore, Koncesionari/Shoqëria Koncesionare mund të njoftojë me shkrim Autoritetin Kontraktues dhe të propozojë shtesa/ndryshime të kësaj kontrate me qëllim që Koncesionari/Shoqëria Koncesionare, të vendoset në të njëjtën pozitë financiare siç do të kishte qenë nëse nuk do të kishte ndodhur ky pakësim në numrin e verifikimeve si treguar në këtë paragraf”;*

Ndërsa konstatojmë që nuk parashikohet në asnjë nen të kontratës mbi masat që duhet të marrë koncesionari nëse nuk realizon të ardhurat e parashikuara për buxhetin e shtetit (sikundër parashikohen në Kreun 5 òArsyetimi i Vendimit të Koncesionitò, të studimit të fizibilitetit, ku në zbatim të VKM nr. 575, datë 10.07.2013 òPër miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/PPPò, i ndryshuar, është llogaritur òKrahasuesi i Sektorit Publikò, i cili ka vlerësuar të ardhurat nga koncesionari për llogari të buxhetit të shtetit, do të jenë në formën e të ardhurës nga tatim-fitimi dhe TVSh, në vlerën rreth 240 milionë lekë për vitin 2019, rreth 244 milionë lekë për vitin 2020, e kështu me rradhë për vitet objekt koncesionimi.

**-Në nenin 21,** pika 21.1.6 òKoncesionari ka të drejtë të kryejë inspektime/verifikime shtesë, tek subjektet që kanë në zotërim instrumenta matës të karburanteve, jashtë frekuencës së zakonshme dhe pa aprovimin paraprak të Autoritetit Kontraktues apo subjekteve që do të inspektohen, si dhe ka të drejtë të bëjë kontrole rutinë për të siguruar që shpërndarësit e karburantit, që kanë rezultuar me probleme dhe nuk janë riparuar, të mos jenë në përdorim.

**-Në nenin 21,** pika 21.1.7 - *Bllokimi i menjëhershëm të instrumentave matës kur konstaton probleme teknike dhe mbylljen me një shirit deri në riparimin e tyre”.*

Pra koncesionarit i jepen të drejta të verifikimit si dhe inspektimit metrologjik, të cilat janë jashtë objektit të koncesionit, ku përcaktohet se: òKoncesionari kryen verifikimin fillestar, verifikimin pasardhës, verifikimin jashtë rradhëò. Për pasojë mund të krijojë hapësira për konflikt interesi, duke ndikuar negativisht në transparencën, trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues të subjekteve që tregtojnë karburant, si dhe për rrjedhojë, uljen e cilësisë së shërbimit e mbrojtjen e konsumatorit.

**-Në vijim të këtij argumenti theksojmë se, arsyeja kryesore e ndarjes së inspektimit metrologjik nga strukturat e DPM-së ishte konflikti i interesit.** Kjo ndarje u realizua për arsye që i njëjti institucion që kryen shërbime metrologjike të verifikimit të mos ndërmarrë dhe saksione administrative, **ndërkohë që nëpërmjet kontratës koncesionare, jemi duke u rikthyer në situatën e mëparshme.**

## **5. Gjetje nga auditimi**

Përgjatë shqyrtimit të Ligjit nr. 126/2020 dhe paralelisht me të edhe të kontratës koncesionare, rezultoi se, shoqërisë koncesionare i është dhënë e drejta e inspektimit dhe marrjes së masës administrative të bllokimit të instrumenteve matës, ndërkohë që ajo është shpallur fituese që në krye të herës vetëm për ofrimin e shërbimit të verifikimit të instrumenteve matës, sepse funksionin e inspektimit metrologjik dhe marrjes së masës administrative, e kryen Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut. Theksojmë se, ofrimi i mundësisë ndaj subjektit privat që tashmë kryhen shërbimin e verifikimit metrologjik, që të kryejë edhe inspektimin/bllokimin e instrumenteve matës, mund të krijojë hapësira për konflikt interesi, duke ndikuar negativisht në transparencën, trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues të subjekteve, që tregtojnë karburant, si dhe për rrjedhojë në uljen e cilësisë së shërbimit dhe mbrojtjen e konsumatorit. Këto përcaktime bien në kundërshtim me pikën 1 në nenin 7 të Ligjit nr.126/2020 òPër metrologjinëò, si dhe Kreun II, IV, dhe V në Ligjin nr.10433, datë 16.6.2011 òPër inspektimin në Republikën e Shqipërisëò. Për më tepër që arsyeja kryesore e ndarjes së inspektimit metrologjik nga strukturat e DPM-së ishte për arsye që i njëjti institucion që kryen shërbimin e verifikimit, të mos ndërmarrë dhe saksione administrative, ndërkohë që nëpërmjet kontratës koncesionare, jemi duke u rikthyer në situatën e mëparshme.

## **Konkluzione**

**5.Ofrimi i mundësisë subjektit privat që tashmë kryhen shërbimin e verifikimit metrologjik, që të kryejë edhe inspektimin/bllokimin e instrumenteve matës, në gjykimin e grupit të auditimit mund të krijojë hapësira për konflikt interesi, duke ndikuar negativisht në transparencën, trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues të subjekteve, që tregtojnë karburant, si dhe për rrjedhojë, uljen e**



cilësisë së shërbimit e mbrojtjen e konsumatorit.

**5.1.** Gjithashtu në lidhje me përcaktimin e frekuencës e verifikimit metrologjik, në kushtet e mungesës së një metodologjie të saktë dhe shkencore për llogaritjen e riskut të instrumenteve matës, për saktësinë e tyre të matjes, mund të bëhet shkak për arbitraritet dhe shkelje të konkurrencës së lirë nga operatori i koncesionit, si dhe rritje të kostos së shërbimit të verifikimit të shpërndarësve të karburantit dhe gazit të lëngshëm.

### **Rekomandime**

**5.1.** MFE të marrë masat e nevojshme që pas propozimit në Këshillin e Ministrave të ndryshimeve ligjore në Ligjin nr.126/2020 òPër metrologjinë, të ngrejë një grup pune për të analizuar mbivendosjet e detyrave të koncesionarit me Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, me qëllim eliminimin e tyre në kontratën koncesionare nr.15326 prot datë 21.08.2019.

**Menjëherë**

### **III.1.1. Monitorimi i Kontratës Koncesionare.**

Referuar kontratës koncesionare me nr. 15326, datë 21.08.2019, neni 13, paragrafi 13.2 parashikon monitorimin dhe mbikëqyrjen nga Njësia e Zbatimit të Projektit, ku përcaktohet se AK ka të drejtë<sup>33</sup> që në periudha kohore prej 24 muajsh, të monitorojë në vend objektin e koncesionit. AK ka të drejtë të ushtrojë këtë monitorim në çdo kohë në rast se ka informacion që lidhet me mosekzekutimin e kushteve të kontratës. Sa më sipër gjithashtu parashikohen edhe në nenin 20 òTë drejtat dhe detyrimet e AK-së. Nën gjykimin e grupit të auditimit, monitorimi periodik duhet të jetë **detyrim** dhe jo e drejtë.

Nga ana tjetër, referuar nenit 19 òRaportimi, të kontratës koncesionare, koncesionari **është i detyruar** që cdo 3 muaj të raportojë më shkrim pranë AK-së, mbi realizimin e programit të investimeve në vlerë dhe në natyrë dhe më pas për sasinë e verifikimeve, si dhe cdo informacion tjetër që do të konsiderohet i nevojshëm nga AK. Në fund shoqëria koncesionare, do të dorëzojë një raport për periudhën 12 mujore të aktivitetit të tij.

Për monitorimin e shërbimit të ofruar prej koncesionarit, të cilit i është dhënë me koncesion shërbimi metrologjik i verifikimit të shpërndarësve të karburantit dhe gazit të lëngshëm, pranë MFE-së është ngritur njësia për monitorimin e zbatimit të kontratës (3 punonjës të MFE-së), e cila në përbërjen e saj rezultoi të ketë burime njerëzore me formimin arsimor jurist dhe ekonomist.

- Sipas OIML-së<sup>34</sup> (Organizata Ndërkombëtare e Metrologjisë Ligjore, është mjaft e rëndësishme mbikëqyrja dhe kontrolli i shërbimeve metrologjike të metrologjisë ligjore, i cili përfshin verifikimin periodik, monitorimin dhe inspektimin, për të dyja format, si atij shtetëror, por edhe të trupave private të akredituar.

- Nga ana tjetër, sipas Institutit Kombëtar të Standardeve dhe Teknologjisë (NIST) dhe Kërkesave të Programit të Peshave dhe Matjeve, USA, në lidhje me monitorimin e kompanive private që ofrojnë shërbime metrologjike, kërkohet<sup>35</sup>:

- Aplikimi i **òdëshmisë së testim/certifikatë që lëshohet për vlerësimin e procedurës së testimit të përdorur nga subjekti privat**, për monitorimin e kompanive private, të cilave ju janë deleguar shërbime të metrologjisë ligjore. Pra inspektorët metrologjicë të autoritetit ligjor të metrologjisë, kërkohet që sipas një analize risku të instrumenteve matës, të shkojnë në vendin ku operon biznesi që ka në përdorim instrumente matës dhe të mbikëqyrin procedurën e testimit dhe rezultatin, nga kompania private ose nga biznesi vetë.

- Në referim të Ligjit nr.126/2020 òPër metrologjinë, dhe më konkretisht përcaktimeve të tij në nenin 8, DPM ndër të tjera, **autorizon subjekte private për të kryer shërbime metrologjike dhe i monitoron ato**. Pra kemi një subjekt privat, të cilit i është dhënë me koncesion shërbimi i verifikimit metrologjik të shpërndarësve të karburantit, si dhe nga ana tjetër subjekte private, të cilave i është dhënë autorizimi (formë tjetër ligjore, pra jo me koncesion) nga DPM, për të kryer shërbime të verifikimit metrologjik; Ndërkohë që në rastin e parë, monitorimi kryhet nga një njësi,

<sup>33</sup> Por nuk parashikohet si detyrim.

<sup>34</sup> [https://www.oiml.org/en/files/pdf\\_d/d009-e04.pdf](https://www.oiml.org/en/files/pdf_d/d009-e04.pdf)

<sup>35</sup> <https://www.nist.gov/system/files/documents/2017/04/28/hb-155-final.pdf>



e cila **nuk** ka në përbërjen e saj specialist të fushës, ndërsa në rastin e dytë monitorimi kryhet nga metrolog, të cilët janë specialist të fushës. Nëse do të ecnim me frymën e ligjit, në gjykimin tonë, do të ishte e nevojshme që në njësinë e ngritur pranë MFE-së, të ketë patjetër edhe specialist të fushës së metrologjisë.

Sa më sipër, grupi i auditimit shqyrtoi dhe vlerësoi raportet periodike të subjekti juridik privat për zbatimin e kontratës, si dhe raportet e monitorimit të shërbimit, të përgatitura nga njësia përkatëse, drejtuar titullarit të MFE-së, ku rezultoi se:

## 6. Gjetje nga auditimi

Referuar kontratës koncesionare, në lidhje me monitorimin, në nenin 13.2 parashikohet se AK, nëpërmjet NJZP (Njësisë së Zbatimit të Kontratës) **ka të drejtë** që në periudhë kohore prej 24 muajsh, të monitorojë në vend objektin e koncesionit për të verifikuar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata. Nën gjykimin e pavarur të audituesit, monitorimi, që t'aj shërbejë qëllimit, duhet të jetë **detyrim** më shumë se e drejtë; nga ana tjetër neni 13.2.1 parashikon se AK ngre NJZP si njësi që ngarkohet me mbikëqyrjen e ecurisë së kontratës, por nuk parashikon ekspertizën që duhet të ketë kjo njësi në përbërjen e saj. Konkretisht NJZP **nuk** ka në përbërjen e saj specialist të fushës, në rastin konkret metrolog, me qëllim mbikëqyrjen nga ana teknike të shërbimit që ofrohet nga subjekti juridik privat, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 8 në Ligjin nr.126/2020 òPër metrologjinë, neni 13, paragrafi 13.2 të kontratës koncesionare, dhe Guidave të OIML D1<sup>36</sup> paragrafi 5.3.5 òPërfshirja e sektorit privat/tregtar në metrologji, si dhe Weights and Measures Program Requirements ó Kërkesat e programit të peshave dhe matjeve, të NIST-Instituti Kombëtar i Standardeve dhe Teknologjisë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.<sup>37</sup>

-Raportet e periodike për titullarin e MFE-së, të përgatitura përgjatë periudhës Mars-Dhjetor 2020 nga njësia e monitorimit të zbatimit të kontratës së dhënies me koncesion të shërbimit të verifikimit të shpërndarësve të karburantit dhe gazit të lëngshëm, **përmbajnë informacion identik** me informacionin që pasqyrohet në raportet periodike të subjektit juridik privat, çfarë rrezikon që monitorimi i shërbimit të mos ofrojë siguri mbi ecurinë e projektit, cilësinë e shërbimit të ofruar dhe konformitetit në përputhje të mos jetë bërë sipas përcaktimeve të bëra në pikat 13.2 dhe 13.3 në nenin 13 të kontratës nr.15326, datë 21.08.2019.

## Konkluzione

6. Mungesa e specialistëve metrolog në njësinë e monitorimit të shërbimit metrologjik të ofruar prej subjektit privat, si dhe hartimi i raporteve të monitorimit mbështetur mbi raportet e vetë koncesionarit, mbartin risqe që informacioni për zbatimin e kontratës dhe cilësinë e shërbimit, të mos sigurojë një panoramë të plotë dhe të saktë të situatës, çka mund të sjellë vendimmarrje të gabuar në të ardhmen nga Autoriteti Kontraktor - MFE, në lidhje me zbatimin e kontratës nga subjekti privat.

## Rekomandime

6.1. Me qëllim zbatimin e kontratës koncesionare, lidhur me monitorimin e saj, MFE të marrë masat e nevojshme që të hartojë një **manual të posaçëm për procedurat e monitorimit** të zbatimit të kontratës së shërbimit metrologjik, ku pjesë e tij të jenë edhe procedura dhe metodologjia e monitorimit në terren, të shërbimit të verifikimit metrologjik, sipas një analize risku.

6.2. Gjithashtu MFE të marrë masat e nevojshme, që në përbërjen e njësisë së monitorimit pranë MFE, të përfshihen **specialistë metrologë** të DPM-së/ISHMT-së, me qëllim rritjen e garancisë se po jepet shërbimi me cilësinë dhe kriteret e kërkuara, prej subjektit juridik privat.

6.3 Të rishikohen:

- neni 13.2.2 i kontratës koncesionare dhe të korrigojohet si vijon: òAK nëpërmjet NJZP **ka detyrimin** që në periudha kohore prej 24 muajsh gjatë gjithë periudhës së koncesionit të monitorijë në vend objektin e koncesionit (...)” ;

- neni 13.3 të korrigojohet si vijon: ò AK **ka detyrimin** të ushtrojë mbikëqyrje të përgjithshme

<sup>36</sup>[https://www.oiml.org/en/files/pdf\\_d/d001-e20.pdf](https://www.oiml.org/en/files/pdf_d/d001-e20.pdf)

<sup>37</sup> <https://www.nist.gov/system/files/documents/2017/04/28/hb-155-final.pdf>





*nëpërmjet shqyrtimit të raporteve që dorëzon Koncesionari (...)"*

**Brenda 6 muhorit të parë të vitit 2022**

#### **IV. Të tjera mbi hartimin dhe plotësimin e kuadrit rregullator.**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga DPM, kryesisht të hartimit dhe plotësimit të kuadrit rregullator, nëpërmjet akteve që nxjerrë Drejtori i Përgjithshëm i DPM, në zbatim të ligjit të metrologjisë dhe akteve nënligjore të tij, rezultoi se:

#### **7. Gjetje nga auditimi**

Nga DPM nuk janë hartuar kriteret dhe rregullat për përcaktimin e zonës, në të cilën do të ushtrorë veprimtari të metrologjisë ligjore, subjekti privat i autorizuar prej DPM-së, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2 të pjesës 1 të Urdhrit të Ministrit të MZHETS nr.7025, datë 24.08.2017 òPër miratimin e rregullores për autorizimin e personave juridik për kryerjen e veprimtarive në metrologjinë ligjore dhe për autorizimin e personave juridikë dhe fizikë për kryerjen e shërbimit të riparimit të instrumenteve matësò.

#### **Konkluzione**

7. Mungesa e hartimit të kriterëve dhe rregullave për përcaktimin e zonës, në të cilën do të ushtrorë veprimtari të metrologjisë ligjore subjekti privat i autorizuar prej DPM-së (që do të thotë se një subjekt i autorizuar për kryerjen e shërbimeve metrologjike mund të ushtrorë aktivitet edhe në gjithë territorin e Shqipërisë), në gjykimin e grupit të auditimit vështirëson mundësinë e hyrjes në treg të subjekteve të tjera, duke ndikuar negativisht në konkurrencën në treg dhe në cilësinë e shërbimit të ofruar.

#### **Rekomandime**

7.1. DPM të marrë masat e nevojshme për hartimin dhe miratimin e kriterëve dhe rregullave për përcaktimin e zonës në të cilën do të ushtrorë veprimtari të metrologjisë ligjore, subjekti i autorizuar.

**Menjëherë**

#### **4.1.1.2.A ka qenë efektive MFE në mbështetjen financiare të DPM-së, për zhvillimin e sistemit të metrologjisë?**

Programi Buxhetor Afatmesëm i DPM-së për periudhën 2018-2020 si një instrument operacional për manaxhimin e shpenzimeve publike dhe një komponent kyç i planifikimit, është rezultat i dy procesëve: rishikimit të politikave dhe planifikimit të shpenzimeve dhe investimeve të programit. Planet e shpenzimeve janë hartuar nga DPM brenda burimeve që MFE ka në dispozicion. PBA përdoret për të informuar MFE lidhur me planet e shpenzimeve të DPM-së për tre vitet e ardhshme, të cilat do të çojnë në arritjen e objektivave politike të zhvillimit të Metrologjisë në Shqipëri. Ai përcakton kontekstin afatmesëm të buxhetit vjetor të DPM-së.

Gjithashtu, ai i shërben DPM-së, pasi mundëson përcaktimin prej saj, të politikave dhe programeve në një strukturë koherente, si dhe mundësinë për të përcaktuar kostot dhe prioritetet e saj brenda kontekstit të burimeve të disponueshme, në mënyrë që burimet financiare të mund të shpërndahen tek fushat prioritare të zhvillimit të metrologjisë në periudhën afatmesme.

Roli i MFE-së përgjatë procesit të PBA është kryesor dhe shumë i rëndësishëm. Ministria e Financave dhe Ekonomisë gjatë fazës së rishikimit të politikës së DPM-së, duhet të sigurojë që politikat, objektivat dhe qëllimet janë të përcaktuara qartë dhe se programet buxhetore, si dhe rezultatet e synuara do të realizojnë objektivat dhe qëllimet e politikës në një mënyrë që krijon vlerë për para, **që do të thotë përdorim të shpenzimeve publike në mënyrë ekonomike, eficiente dhe efektive.**

DPM është pjesë e programit mbështetje për **“Mbikqyrjen e Tregut, Infrastrukturën e Cilësinë dhe Pronësisë Industriale”**. Pika (i) metrologjia për matje të sakta dhe të sigurtat për konsumatorët.


DPM ka ndjekur të gjitha fazat e përgatitjes së buxhetit duke respektuar afatet, procedurat dhe udhëzimet përkatëse. MFE nëpërmjet financimit të programit buxhetor të DPM-së, në vetvete, lidhë politikat e financimit me shërbimet publike të metrologjisë, që i ofrohen popullsisë, si shërbime të



ndërmjetme për mbrojtjen e konsumatorit nga pasaktësitë në peshat dhe matjet. Në tabelën e mëposhtme jepen miratimi i tavaneve buxhetore nga MFE sipas kërkesave të DPM dhe realizimit faktik të buxhetit të DPM-së.

Tabela nr.10 PBA, Buxheti i miratuar dhe realizimi në fakt. (000/Lekë)

Buxheti i DPM	PBA	Plani i miratur	Diferenca	Realizimi Fakt	%Fakt/Planit	Diferenca
	1	2	3(1-2)	4	5	6(2-4)
Viti 2018	140,100	139,140	960	136,480	98.1	2,660
Viti 2019	144,300	153,000	-8,700	133,161	87	19,839
Viti 2020	140,300	137,337	2,963	119,986	88.7	17,351
<b>TOTAL</b>	<b>424,700</b>	<b>429,477</b>	<b>-4,777</b>	<b>389,627</b>	<b>91.1</b>	<b>39,850</b>



Burimi: DPM, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Në total për tre vitet 2018-2020, kërkesa për financim sipas PBA-ve është 424,700 mijë lekë, ndërsa MFE ka financuar 429,477 mijë lekë, ose 4,777 mijë lekë më shumë se kërkesat.

*Pra rezulton se: DPM-së nuk i ka munguar mbështetja financiare nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.*

Indikatori i realizimit të shpenzimeve, i cili mat shkallën në të cilën shpenzimet e përgjithshme buxhetore të realizuara pasqyrojnë shpenzimet e planifikuara, është vlerësuar për të tre vitet e fundit buxhetore të mbyllura (vitet 2018, 2019 dhe 2020) dhe i referohet të dhënave të DPM-së. Nga analiza e realizimit plan/fakt të shpenzimeve rezulton se: për vitin 2018 është realizuar 98.1% plani i financimit, në vitin 2019 është realizuar 87% në vitin 2020 është realizuar 88.7%, ndërsa në total për të tre vitet, plani i financimit nga MFE për programin e DPM-së është realizuar 91.1% ose rezultojnë të mos jenë përdorur në vlerë nominale -39,850 mijë lekë. Për pasojë niveli i realizimit të shpenzimeve nga DPM ka qenë më i ulët, pasi nuk janë realizuar shpenzimet e planifikuara të financuara nga MFE, për tre vitet periudhë auditimi.

Tabela e mësipërme dhe grafiku ofron një pamje të përafërt të planit të buxhetit të DPM-së dhe performancës faktike të shpenzimeve të financuar me burimet.

*Sa më lartë DPM nuk ka punuar për të përmbushur objektivat, për të realizuar produktet e përfituara të cilat janë të parashikuara në programin e saj, për të përdorur me efikasitet dhe efektivitet fondet buxhetore të akorduara për çdo zë shpenzimesh.*

Grupi i auditimit vlerësoi se sa efektiv ka qenë financimi i MFE për programin e metrologjisë, duke u nisur nga planifikimin i shpenzimeve buxhetore të lidhur me objektivat dhe indikatorë të performancës të kostove në nivel produktesh. Për këtë qëllim rezultatet në programin buxhetor të DPM-së duhet të identifikohen qartë në gjithë zinxhirin, nga burimet e përdorura deri tek rezultati i arritur, për të siguruar shkallën e efektivitetit të përdorimit nga DPM, të financimit nga MFE dhe për të siguruar nëse është arritur rezultati për objektivin e synuar kundrejt përdorimit të burimeve. Financimi i DPM tregon lidhjet midis burimeve, produkteve dhe rezultateve të arritura për secilin produkt të saj. DPM ka maksimalisht 4 produkte me objektiva në PBA. Realizimi i objektivave matet përmes treguesve të performancës të shoqëruar me vlerën përkatëse të synuar.

ELEMENTI	PËRSHKRIMI
----------	------------



Burime (Inpute DPM)	Inputet, si ndërtesa, si ndërtesa, pajisje, kontribute njerëzore, si dhe kontribute financiare (siç janë financimi i programit nga MFE) për të financuar pagat, investimet dhe transfertat e nevojshme për politikën në fjalë, në dispozicion të DPM-së për të realizuar shërbimet metrologjike.
Aktiviteti	Aktiviteti është kryerja e shërbimeve metrologjike për mbrojtjen e konsumatorit nga pasaktësitë e peshave dhe matjeve.
Produktet e DPM-së	1. Akreditimi i laboratorëve, njohja ndërkombëtare e fushave të reja të metrologjisë. 7 fusha për cdo vit; 2. Numri i kalibrimeve në ekonominë e vendit 2140 në 2018, 2200 në 2019 dhe 2260 në 2020; 3. Numri i kalibrimit të etaloneve sipas 10 fushave të matjes, 10 fusha për cdo vit; 4. Numri i verifikimeve periodike të instrumentave ligjërish të kontrolluar 55.902 në vitin 2018, 61.492 në vitin 2019, 67.641 në vitin 2020.
Rezultatet e DPM	Realizimi faktik i numrit të produkteve të planifikuara dhe efekti pozitiv ose negativ i produkteve mbi konsumatorët.
Impakti DPM	Rritja e mbrojtjes së konsumatorit nga pasaktësitë nga peshat dhe matjet. Rritja e cilësisë së shërbimeve metrologjike.
Ekonomiciteti	Ulja e koston së burimeve që përdoren nga DPM, duke mos çenuar cilësinë e shërbimeve të saj.
Efektiviteti	Vlerësimin e rezultateve përfundimtare me objektivat të vendosura, të DPM

Nga shqyrtimi i të dhënave mbi kostimin e produkteve që në fazën e planifikimit të programit buxhetorë PBA 2019-2022, e cila përmban të dhëna edhe për vitin 2018, vlerësojmë se, treguesit e performancës janë formuluar dhe miratohen si pjesë e PBA-së dhe proceseve të përgatitjes së buxhetit. Gjatë ekzekutimit të buxhetit, treguesit e performancës maten kundrejt vlerës së synuar dhe raportohen si pjesë e proceseve të monitorimit dhe raportimit të buxhetit. Janë implementuar objektivat sipas Strategjisë Kombëtare Ndërsektoriale të Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Mbikëqyrjes së Tregut 2014-2020 për të gjithë produktet e DPM, me përjashtim të produktit nr.4 - Verifikime periodike të instrumentave ligjërish të kontrolluar. Ky tregues nuk është planifikuar sipas objektivave strategjik që janë përkatësisht: 55.902 verifikime në 2018, 61.492 verifikime në 2019, 67.641 verifikime në 2020. Referuar të dhënave financiare të DPM-së, numri i produkteve dhe kosto për çdo produkt, paraqitet në tabelat dhe grafikët e mëposhtëm.

Tabela nr.11 Numri i produkteve objektiva plan/fakt sipas viteve.


Nr	Produkte	Viti 2018			Viti 2019			Viti 2020		
		Plan	Fakt	Diferenca	Plan	Fakt	Diferenca	Plan	Fakt	Diferenca
1	Akreditim	7	3	4	7	3	4	7	3	4
2	Kalibrime brendshme	2140	1272	868	2200	1279	921	2260	1291	969
3	Kalibrime etalonësh	10	10	0	10	10	0	10	0	10
4	Verifikime	55902	47247	8655	61492	46769	14723	67641	36023	31618

Tabela nr.12 Planifikimi i shpenzimeve në PBA dhe realizimi fakt, kosto/produkte (000/Lekë)

Nr	Produkti	2018		2019		2020	
		Plan Kosto/1 produkt	Fakt Kosto/1 produkt	Plan Kosto/1 produkt	Fakt Kosto/1 produkt	Plan Kosto/1 produkt	Fakt Kosto/1 produkt
1	Akreditim	6415.7	14,773.0	6,701.4	14,589.9	6,772.9	13,213.9
2	Kalibrime brendshme	6.3	10.4	6.1	9.8	6.0	8.7
3	Kalibrime etalonësh	807.0	796.4	807.0	753.0	807.0	0.0
4	Verifikime	1.3	1.5	1.2	1.5	1.1	1.9



Grafiku nr.1 Kosto plan/fakt për produktet buxhetore Akreditim, Kalibrim, Kalibrim Etalonësh dhe Verifikim



Burimi: DPM, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar të dhënave më sipër, përveç produktit 3 (Kalibrimi i etaloneve), i cili në vitin 2018 dhe 2019 është realizuar, ndërsa në vitin 2020 nuk është realizuar për shkak të Pandemisë Covid 19, rezultoi se:

### 8. Gjetje nga auditimi

Produktet si: (i) Akreditimi, (ii) Kalibrimi, dhe (iii) Verifikimi, përgjatë periudhës 2018-2020, rezultuan të jenë kryer me kosto më të lartë se objektivat e PBA dhe SNMKMT 2014-2020<sup>38</sup>, si dhe treguesit e performancës të DPM nuk janë realizuar me efektivitet, si pasojë e mosrealizimit të: (i) 12 akreditimeve të laboratorëve dhe njohje CMC; (ii) 2,758 kalibrimeve dhe (iii) 54,996 verifikimeve, në kundërshtim me pikat 24 dhe 25 të nenit 3, shkronjën çç të nenit 4, shkronjën öb të nenit 19, të Ligjit nr.9936, datë 26.08.2008 (Për menaxhimin e sistemit buxhetorë, i ndryshuar. Kjo situatë është ndikuar edhe për shkak të kalimit tek subjektit privat me koncension, të shërbimit të verifikimit (12,400 verifikime) të 6,200 shpërndarësve të karburantit dhe gazit të lëngshëm, ndërsa

<sup>38</sup> Sipas PBA 1.3 lekë, ndërkohë sipas faktit 1.5 lekë.



për vitin 2020 edhe për shkak të pandemisë Covid19ö.

## **Konkluzione**

**8.**Zbatimi efektiv i planit strategjik dhe përfshirja e tij në planet e veprimt 2018-2020 nga DPM, nuk është siguruar nëpërmjet një sistemi monitorimi dhe vlerësimi lidhur me zbatimin e objektivave buxhetor, masave apo aktiviteteve të planifikuara.

**8.1.**DPM nuk ka punuar për të përmbushur objektivat, për të realizuar produktet e përfituara të cilat janë parashikuar në programin buxhetor të saj, me qëllim përdorimin e plotë dhe me efektivitet të fondeve buxhetore të akorduara për çdo zë shpenzimesh.

## **Rekomandime**

**8.1.** DPM të marrë masat e nevojshme që të rishikojë planet strategjike dhe operacionale si një domosdoshmëri për përmirësimin e performancës dhe të efektivitetit të saj, në realizimin e programit buxhetor.

**Në vijimësi**

### **4.1.2.A kanë qenë efektive masat e marra nga DPM për mbrojtjen e konsumatorit nga abuzimet me peshën dhe matjen?**

Metrologjia ligjore në vendin tonë, me gjithë masat e vazhdueshme në përpjekjen për mbrojtjen e konsumatorit nga pasaktësitë e peshave dhe matjeve, nuk ka qenë efektive sa duhet në realizimin e këtij misioni.

Mos realizimi plotësisht i objektivave strategjik, nga DPM në bashkëpunim me MFE, si dhe mos hartimi i strategjisë së posaçme për zhvillimin e metrologjisë, tregon mungesë koordinimi ndërmjet këtyre dy institucioneve për të bashkërenduar veprimet dhe marrë masa konkrete për realizimin e objektivave strategjik, të cilët në fund synojnë zhvillimin më tej të sistemit të metrologjisë, si dhe mbrojtjen e konsumatorit.

Mungesa e ngritjes së disa laboratorëve, deklarimit në BIPM të fushave të tjera të matjes (termometrisë dhe gjatësisë), si dhe e përfshirjes së disa instrumenteve të tjerë në procesin e verifikimit metrologjik, në gjykimin e grupit të auditimit, ndikojnë negativisht në vendosjen e kohës së saktë në telekomunikacion, televizione, transport, etj., si dhe saktësinë e matjes së instrumenteve matës në fushën e energjetikës, industrisë nxjerrëse dhe përpunuese të mineraleve, hidrokarbureve, të shëndetësisë dhe për rrjedhojë në mbrojtjen e konsumatorit.

#### **4.1.2.1.A janë realizuar objektivat strategjikë për metrologjinë nga DPM?**

Në një shoqëri ideale të tregut të lirë, gjithçka merret përsipër nga sektori privat dhe tregu vendos rregullat e prodhimit dhe tregtisë. Megjithatë, në praktikë, çdo vend ka një sektor publik dhe shteti rregullon disa aktivitete të sektorit privat, veçanërisht në fushat e prodhimit, shërbimeve dhe tregtisë. Çështja është se cilat fusha rregullohen dhe në çmënyrë rregullohen ato. Në botën globale, kjo krijon probleme pasi rregullore të ndryshme në vende të ndryshme sjellin vështirësi serioze për prodhuesit dhe tregtarët ndërkufitarë. Ky problem përkeqësohet për mallrat e prodhuara sepse rregullore të ndryshme mund të pengojnë shitjen e produktit të prodhuar nga një vend për një vend tjetër. Disa vende përdorin sistemin rregullator si pengesë ndaj tregtisë me qëllim mbrojtjen e industrive të tyre të prodhimit. Kjo e bën shumë të rëndësishëm faktin që të gjitha vendet tregtuese **të kenë një sistem eficient rregullator teknik.** Një sistem i mirë rregullator kërkon dy elemente thelbësore, rregulla të mira dhe monitorim të mirë. Nga njëra anë, kjo kërkohet me synim mbrojtjen e konsumatorit dhe shtetit dhe nga ana tjetër të mos vendosë kufizime të panevojshme për të bërë biznes në atë vend. Ky optimizim i rregullave teknike varet gjerësisht nga infrastruktura e disponueshme e cilësisë. Elementët kyç të infrastrukturës së cilësisë (**IC**) janë standardizimi (për rregullat), inspektimi, metrologjia dhe akreditimi (për monitorimin).

Sistemi IC është elementi kyç për infrastrukturën e cilësisë së një vendi. Gjithashtu, është thelbësore në proceset e ngjashme të Organizatës Botërore të Tregtisë dhe për lëvizjen e lirë të mallrave nga pikëpamja e BE-së. Sistemi IC është gjithashtu i rëndësishëm për mbrojtjen e tregut të brendshëm nga importet e cilësisë së ulët. Lëvizja e lirë e mallrave do të mund të arrihej vetëm duke eliminuar masat që kufizojnë tregtinë, jo vetëm detyrimet doganore dhe kufizimet sasiore, por



të gjitha masat me efekt të barazvlefshëm (proteksionizmi<sup>39</sup>). Kjo imponon ekzistencën e një kuadri të përbashkët legjislativ që do të siguronte qarkullimin e mallrave pa kufizim mes vendeve, si dhe infrastruktura e cilësisë (IC) duhet të nënshtrohet disa rregullave të vendosura në nivel evropian dhe ndërkombëtar.

Si një element kryesor i infrastrukturës së cilësisë, edhe metrologjia ka njohur zhvillimet e veta, duke filluar prej vitit 2003, ku për herë të parë institucioni i kirjuar në vitin 1946 (Drejtoria e Kontrollit të Instrumenteve Matës), u quajt Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Kalibrimit. Këto zhvillime kanë konsistuar në ambiente të përshtatshme për laborator dhe pajisje pune, burime njerëzore të kualifikuara, rritjen e numrit të shërbimeve të ofruara prej institucionit të metrologjisë. Pavarësisht këtyre zhvillimeve, duke patur në konsideratë që metrologjia të jetë një lloj si në vendet e BE-së, por edhe më gjerë, është vlerësuar gjithmonë e nevojshme që, për zhvillimin e sektorit të metrologjisë të ndërmerren nisma të tilla, si hartimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i kuadrit rregullator, hartimi dhe zbatimi i strategjive të ndryshme, etj.

Konkretisht për zhvillimin e sektorit të metrologjisë, përgjatë dy dekadave të fundit, janë hartuar disa strategji, ku megjithëse asnjë prej tyre nuk ka qenë posaçërisht për këtë sektor, përsëri janë përcaktuar objektiva konkret për të realizuar nga institucionet përgjegjëse për metrologjinë në Shqipëri.

- Sa më sipër, strategjia e parë, në të cilën përfshihej edhe sektori i metrologjisë, është miratuar me VKM nr.797, datë 14.11.2007<sup>40</sup>, me afat 2007-2013. Në këtë strategji më tepër u vendos theksi tek përmirësimet ligjore të fushës së metrologjisë, akreditimit, standardizimit, etj. Pra nuk u vendosën objektiva cilësorë dhe sasiorë të matshëm, posaçërisht për metrologjinë, me qëllim zhvillimin e saj.

- Duke vijuar më tej, në vitin 2008, me VKM nr.272, datë 05.03.2008<sup>41</sup>, u miratua strategjia e dytë, e cila ndryshe nga e para, në fund të periudhës së saj, parashikonte që Drejtoria e Metrologjisë të kthehej në Institutin e Metrologjisë Kombëtare, si dhe vendosi objektiva të qartë dhe të matshëm për zhvillimin e metrologjisë. Këto objektiva parashikoheshin për të realizuar në disa periudha të ndryshme, si 2008-2012, 2013-2017, 2018-2022 dhe 2023-2030.

- Për të ardhur në fund me strategjinë e miratuar me VKM nr.753, datë 16.9.2015<sup>42</sup>, në të cilën u përcaktuan objektiva për zhvillimin e sektorit të metrologjisë brenda vitit 2020. Kjo strategji parashikoi dy periudha 2014-2015 dhe 2016-2020, për realizimin e objektivave nga DPM. Theksojmë se, në objektivat për metrologjinë, për të realizuar përgjatë periudhës 2014-2020, ishin përcaktuar rritja e numrit të inspektimeve metrologjike, ulja moskonformiteteve të produkteve të parapaketuara, etj., të cilat me ndryshimet ligjore të mëvonshme, që çuan në krijimin e Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, i kaluan për zbatim këtij institucioni.

Sa më sipër grupi i auditimit vlerësoi realizimin e objektivave strategjik, përcaktuar për të realizuar brenda periudhës, objekt auditimi, 2018-2020. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga MFE dhe DPM, si raporti i monitorimit të strategjisë në Qershor të vitit 2021, numri i verifikimeve dhe kalibrimeve, të kryera nga DPM, krahasimet ndërlaboratorike, akreditimin e laboratorëve, deklarimin në BIPM të fushave të tjera të matjes, etj, rezultoi se:

## 9. Gjetje nga auditimi

Nga auditimi i aktivitetit të DPM-së në bashkëpunim me MFE, referuar planit të veprimit afatgjatë 2016-2020 në Strategjinë Ndërsektoriale të Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Mbikëqyrjes së Tregut (SNMKMT) dhe Strategjisë miratuar me VKM nr.272, datë 05.03.2008, rezultoi se, **nuk janë realizuar objektivat strategjik**, si më poshtë vijon:

- Kryerja e verifikimeve periodike e instrumenteve matës në përdorim në masën 10% më shumë se viti paraardhës. Përfunduar vitin 2020, për shkak të pandemis Covid-19, numri i verifikimeve është rritur me rreth 7% çdo vit;
- Koordinimi me Institutin e Fizikës Bërthamore që të ketë matje të rrezatimit jonizues;

<sup>39</sup> Politika e vendosjes së pengesave ligjore, tarifore apo restriksioneve të tjera mbi të mallrat e importuara me qëllimin që këto mallra të mos të jenë në gjendje të konkurrojnë me produktet apo të mirat vendase.

<sup>40</sup> Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Mbikëqyrjen e Tregut, për periudhën 2007-2013

<sup>41</sup> Për miratimin e Strategjisë Sektoriale për zhvillimin e infrastrukturës së cilësisë në Shqipëri

<sup>42</sup> Strategjia Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjen e Tregut 2020



- Krijimi i 14 fushave të reja matjesh;
- Sigurimi i shërbimeve elektronike dhe mekanike në universitete dhe në industri në lidhje me riparimin, projektimin dhe ndërtimin e pajisjeve të matjeve;
- Kryerja e trajnimeve të rregullta për industrinë në të pakën 30 fusha, duke përfshirë metrologjinë e përgjithshme dhe vlerësimin e pasaktësive;
- Deklarimi në databasën të BIPM<sup>43</sup>-së të fushave të matjes. Aktualisht DPM ka vetëm 3 fusha të deklaruara (masë, presion dhe volum);
- Përfshirja në skemën e kontrollit metrologjik ligjor të dy instrumenteve matës në fushën e mjekësisë;
- Realizimi i 10,750 kalibrime në fushën e masës, forcës, volumit, gjatësisë, presionit, temperaturës, matjeve elektrike, lagështirës, kohë-frekuencës, densitetit (janë realizuar rreth 7,500 kalibrime);
- Ngritja e laboratorëve të kohë-frekuencës, të kontrollit të zhurmave dhe të kontrollit të instrumenteve matës në fushën e shëndetësisë;
- Realizimi i fushatave ndërgjegjësuere për biznesin;
- Akreditimi i laboratorëve sipas fushave përkatëse nga trupa akreditues nënshkrues të MLA<sup>44</sup> me EA në fushën e kalibrimeve;
- Zgjerimi i bazës etalonuese në 7 fusha të reja matje: laboratorin e masës, elektrikut, rrjedhjeve, optikës, përdredhjeve dhe presionit;
- Hartimi i VKM òPër bashkëpunimin midis autoriteteve kombëtare përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e konsumatorëve;
- Gjithashtu rezultoi se, nga DPM nuk është hartuar strategjia e zhvillimit të metrologjisë, referuar përcaktimit të bërë në nenin 8 të Ligjit nr.9875, datë 14.02.2008 òPër metrologjinë, i ndryshuar, në fuqi deri në Dhjetor të vitit 2020.

## Konkluzione

**9.** Mungesa e realizimit plotësisht të objektivave strategjik nga DPM në bashkëpunim me MFE, si dhe e hartimit të strategjisë së posaçme për zhvillimin e metrologjisë, në gjykimin e grupit të auditimit, tregon mungesë koordinimi dhe punë të dobët, ndërmjet këtyre dy institucioneve në bashkërendimin e veprimeve dhe marrjen e masave konkrete për realizimin e objektivave strategjik, të cilët në fund synojnë zhvillimin e sistemit të metrologjisë, si dhe mbrojtjen e konsumatorit.

**9.1.** Mungesa e ngritjes së disa laboratorëve, deklarimit në BIPM të fushave të tjera të matjes (termometrisë dhe gjatësisë), si dhe e përfshirjes së disa instrumenteve të tjerë në procesin e verifikimit metrologjik, në gjykimin e grupit të auditimit, ndikojnë negativisht në vendosjen e kohës së saktë në telekomunikacion, televizione, transport, etj., si dhe saktësinë e matjes së instrumenteve matës në fushën e energjetikës, industrisë nxjerrëse dhe përpunuese të mineraleve, hidrokarbureve, të shëndetësisë dhe për rrjedhojë në mbrojtjen e konsumatorit.

## Rekomandime

**9.1.** DPM në bashkëpunim me MFE të marrin masat e nevojshme, për hartimin dhe miratimin e strategjisë së posaçme për zhvillimin e metrologjisë, pjesë e të cilës të jenë edhe objektivat e mësipërm, në koherencë me ndryshimet ligjore në fushën e metrologjisë, të pa realizuar deri në fund të vitit 2020.

**9.2.** Gjithashtu DPM të marrë masat e nevojshme, që të kryejë rikalibrimin e etalonëve kombëtar, në laboratorët e vendeve anëtare të BIPM, duke vlerësuar mundësitë reale për ta kryer vetë këtë

<sup>43</sup> Byroja ndërkombëtare e peshave dhe masave, si organizmi më i lartë në të cilin deklarohen aftësitë matëse dhe kalibruese të instrumenteve matës, çka sjellë që certifikatat e kalibrimit të lëshuara nga ky laborator do të njihen ndërkombëtarisht.

<sup>44</sup> **Marrëveshja Shumëpalëshe e EA (EA MLA)** është një marrëveshje e nënshkruar midis anëtarëve të EA, ku nënshkruarit njohin dhe pranojnë ekuivalencën e sistemeve të akreditimit të operuara nga anëtarët nënshkrues, si dhe besueshmërinë e rezultateve të vlerësimit të konformitetit të ofruara nga Organet e Vlerësimit të Konformitetit, të akredituar nga anëtarët nënshkrues. E bën objektivin **"I akredituar një herë, i pranuar kudo"** efektiv. Pranimi në treg i EA MLA dhe rrjedhimisht i rezultateve të vlerësimit të konformitetit të ofruara nga Organet e Vlerësimit të Konformitetit të akredituara nga nënshkruarit e EA MLA është me rëndësi të madhe për tregun e brendshëm në Evropë në lehtësimin e tregtisë ndërkufitare si dhe në demonstrimin e pajtueshmërisë me legjislacionin evropian për produktet dhe shërbimet duke kontribuar në mbrojtjen e shëndetit, sigurisë dhe mjedisit. Përfitimet e saj janë: Mbështetja e zbatimit të legjislacionit evropian dhe kombëtar; Rritja e tregtisë dhe e rritja ekonomike; Kufizimi i kostove dhe burimeve duke eliminuar një sërë detyrimesh administrative; Rritja e konkurrencës; Rritja e cilësisë; Krijimi i besimit.



shërbim, me qëllim reduktimin e kostove, kohës së realizimit, si dhe rritjen e sigurisë së transportit të etalonëve.

### Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022 dhe në vijimësi

#### 4.1.2.2.A janë mirëadministruar burimet njerëzore dhe financiare nga DPM në funksion të realizimit të objektivave institucional?

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë është person juridik, publik, i specializuar për metrologjinë, me qendër në Tiranë dhe e organizuar në qendra rajonale, në varësi të ministrit përgjegjës për ekonominë<sup>45</sup>, organizimi dhe funksionimi i së cilës rregullohet me VKM nr. 1576, datë 17.10.2008, e ndryshuar. Sipas ligjit nr. 9875, datë 14.02.2008 ÷Për metrologjinë o i ndryshuar, DPM drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili emërohet nga Kryeministri, me propozimin e ministrit përgjegjës për ekonominë dhe rekrutimi i nëpunësve bëhet sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013 ÷Për Nëpunësin Civilo.

Me VKM nr. 1576, datë 17.10.2008 ÷Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, e ndryshuar, është përcaktuar organizimi dhe me qendra rajonale në Tiranë, Korçë, Fier dhe Lezhë.

Përgjatë periudhës 2018-2020 struktura organike është miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 112, datë 06.08.2008 me 110 punonjës. Pas kësaj date, me Urdhrin e Kryeministrit nr.23, datë 23.02.2012 ÷Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Metrologjisë janë shtuar 10 punonjës (pra 120 gjithsej), duke bërë edhe një rindarje të sektorëve brenda DMSHI; duke hequr sektorin e auditit të brendshëm me dy persona; duke shtuar Drejtorinë e sigurimit të cilësisë me 7 punonjës të ndarë në dy sektor (sigurimi i cilësisë dhe parapaketimet); DMSHI ka një rindarje të sektorëve nga dy në tre, duke mbajtur sektorin e juridik, integritit dhe komunikimit, dhe sektorin e burimeve njerëzore dhe shërbimeve, si dhe duke shtuar Sektorin e buxhetit dhe financës. Gjithashtu në vijim të ndryshimeve ligjore, të cilat krijuan Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, organika e DPM, pësoi ndryshime në numër, ku u pakësua me 16 punonjës, konkretisht këta ishin inspektorët që kryenin inspektimin metrologjik. Në përfundim struktura e DPM-së përgjatë periudhës 2018-2020, ka patur në organikën e saj 104 punonjës.

Duke analizuar raportet e numrit të punonjësve brenda strukturës organike, me detyrat e DPM të përcaktuara në ligjin e posaçëm, ngarkesën e punës të përcaktuara në Rregulloren e brendshme, performancën e tyre, si dhe me ndikimin e veprimtarisë tyre në mbrojtjen e konsumatorëve nga abuzimet me matjen dhe peshën, rezultoi se një numër i konsiderueshëm punonjësish në DMSHI dhe në DSCP ngelen të pambuluar plotësisht. Aktualisht ngritja e pesë sektorëve në DMSHI me nga 3, 4 dhe 5 specialistë (gjithsej 20 punonjës), shkakton mbivendosje të detyrave të përgjegjës të sektorit me ato të specialistëve brenda tij, pra mungesë efieciencie në përdorimin e burimeve njerëzore. Kështu, Përgjegjësi i sektorit në DMSHI harton planet e punës, punon për përmirësimin e paketës ligjore, kryen studime, harton materiale trajnuese etj., njëlloj si specialisti i matjeve elektrike, specialisti i matjes së fuqisë dhe energjisë elektrike, matjeve të temperaturës etj., duke përfshirë dhe ambientet moderne të laboratorëve dhe mbajtjes së etalonëve matës që lehtësojnë kërkesat e aktivitetit të secilit prej tyre, duke marrë në konsideratë dhe faktin që veprimtaria e tyre ndikon indirekt instrumentet matës në terren.

Sipas të dhënave nga DPM, në periudhën 2018-2020, ka patur disa mangësi në plotësimin e strukturës, konkretisht nga 104 punonjës, në vitet 2018 dhe 2019, ka patur 7-10 vënde vakante, kryesisht në specialistët metrolog dhe të laboratorëve.

Tabela nr.13 Plotësia e strukturës së DPM 2018-2020

Viti	Numri i të punësuarve sipas strukturës së miratuar	Numri i punonjësve faktikë
2018	104	94
2019	104	97
2020	103	100

Burimi: DPM, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

<sup>45</sup> Ligji nr. 9875, datë 14.02.2008 ÷Për metrologjinë o i ndryshuar, neni 7





Referuar të dhënave të vendosura në dispozicion mbi trajnimin e burimeve njerëzore, formimin arsimor të burimeve njerëzore të punësuar pranë DPM, kryesisht të specialistëve-metrolog të DLM, si dhe kërkesat që duhet të përmbush metrologu i autorizuar, përcaktuar në Urdhrin e Ministrit të METE nr. 192, datë 09.03.2008 òPër përcaktimin e kritereve të përgjithshme që duhet të përmbushë kandidati për t'u kualifikuar si metrolog i autorizuar<sup>46</sup>, ku përveç arsimit të lartë është përcaktuar që preferohen diplomimi si inxhinier në degët mekanike, elektrike, elektronike, ndërtim ose në matematikë, fizikë, kimi dhe biokimi, rezultoi se:

## 10. Gjetje nga auditimi

Në fund të vitit 2020, të punësuarit në sektorin e Drejtorisë së Metrologjisë Ligjore (DML), që kryejnë verifikimin metrologjik, që nuk kanë formimin arsimor sipas kërkesave të Urdhrit të Ministrit të METE nr. 192, datë 09.03.2008<sup>47</sup>, janë rreth **25 punonjës nga 53** të punësuar efektivisht, ose rreth 47%;

- Specialistët metrolog të DML nuk janë testuar nëpërmjet provimit të kualifikimit për njohuri të mjaftueshme në fushën e metrologjisë ligjore, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në Urdhrin e Ministrit të METE nr. 192, datë 09.03.2008 òPër përcaktimin e kritereve të përgjithshme që duhet të përmbushë kandidati për t'u kualifikuar si metrolog i autorizuar;

- DPM nuk ka një program vjetor të miratuar, për zhvillimin e aftësive profesionale të personelit të saj, kryesisht të specialistëve metrolog të saj, me përjashtim të specialistëve të laboratorëve pranë Drejtorisë së Përgjithshme, referuar Ligjit nr.9875, datë 14.02.2008 òPër metrologjinë, i ndryshuar, neni 8 pika 15;

- Nga DPM nuk janë miratuar rregullat dhe mënyra për kualifikimin dhe trajnimin e personelit të saj, referuar Ligjit nr.9875, datë 14.02.2008 òPër metrologjinë, i ndryshuar, neni 8 pika 15;

- Specialistët e laboratorëve të masës, që gjenden pranë Sektorëve Rajonal Lezhë, Fier dhe Korçë (në Sektorin Rajonal të Tiranës, nuk ka ambjente dhe pajisje laboratorike) të DPM, përgjatë periudhës 2018-2020, nuk kanë kryer asnjë shërbim laboratorik<sup>48</sup>;

- Rregullorja e brendshme nr.104/1, datë 07.02.2014 e DPM-së, **nuk** është rishikuar dhe si pasojë nuk reflekton ndryshimet që ka pësuar DPM në strukturën dhe funksionet e saj, për shkak të ndryshimeve ligjore në Ligjin nr.9875, datë 14.02.2008, òPër Metrologjinë, i ndryshuar. Gjithashtu nga shqyrtimi i saj, rezultoi se nuk ka një ndarje të qartë të detyrave sipas pozicionit të punës, ku disa detyra janë të njëjta për pozicionin e drejtorit, përgjegjësit dhe specialistit të sektorit, psh., në DMSHI, ku edhe specialisti përgjigjet për propozime të ndryshimeve ligjore, hartimin e materialeve trajnuese, etj.

## Konkluzione

**10.** Mos reflektimi në rregulloren e brendshme të DPM-së, i ndryshimeve në strukturën e saj, si dhe mungesa e përcaktimit të qartë të detyrave sipas pozicioneve të punës, cenon në mënyrë direkte realizimin e objektivave të institucionit, duke mbartur risqe të mbivendosjes së detyrave, paqartësi në procedurat e punës, si dhe mbikëqyrjen e proceseve, etj.

**10.1.** Mungesa e rekrutimit të burimeve njerëzore në DML, sipas kërkesave të përcaktuara për metrologun e autorizuar, si dhe trajnimeve për zhvillimin e vazhdueshëm të njohurive të tyre, në gjykimin e grupit të auditimit, ndikon negativisht në cilësinë dhe saktësinë e shërbimit të verifikimit të instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar.

**10.2.** Mungesa e kryerjes së shërbimeve laboratorike prej specialistëve përkatës, në Sektorët Rajonal të DPM, tregon për mungesë efieiene në mirëadministrimin e tyre, si dhe efektiviteti në realizimin e qëllimeve për të cilën ata janë punësuar.

## Rekomandime

**10.1.** DPM të marrë masat e nevojshme, për hartimin dhe miratimin e rregullores së brendshme, duke reflektuar ndryshimet në legjislacion, ndryshimet në strukturë, si dhe duke qartësuar detyrat për çdo pozicion pune.

<sup>46</sup> Urdhër i Ministrit të METE nr. 7991/1 prot., date 04.11.2011 òPër disa ndryshime në Urdhrin nr. 192, date 09.03.2009

<sup>47</sup> Për përcaktimin e kritereve të përgjithshme që duhet të përmbushë kandidati për t'u kualifikuar si metrolog i autorizuar

<sup>48</sup> Pasqyruar në tabelën nr.1 në Kapitullin Shtojcat.



## Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022

**10.2.** DPM të marrë masat e nevojshme, që të kryejë trajnime për zhvillimin e vazhdueshëm të njohurive të tyre.

**Në vijimësi**

### **Mirëadministrimi i burimeve financiare në DPM.**

Mirëadministrimi i burimeve financiare nënkupton planifikimin, organizimin, drejtimin dhe kontrollin e veprimtarive financiare të tilla si shpenzimet operative, investimet, por edhe alokimin e tyre në përputhje me qëllimet e institucionit, si dhe vendosjen në eficiencë dhe efektivitet të plotë të fondeve të shpenzuara. Fushëveprimi i menaxhimit financiar përfshin investimet (procedurat e prokurimit, projektet etj.), rritjen e të ardhurave nga të gjitha burimet e mundshme, optimizmin e shpenzimeve operative etj., me qëllim realizimin e objektivave të institucionit publik me kosto optimale dhe shërbimin ndaj qytetarëve në kohë dhe sa më me cilësi.

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë gjatë kryerjes së detyrave të veta ligjore për verifikimin e instrumenteve matëse e atë sasior të produkteve të parapaketuara dhe të shisheve; kryerjen e kalibrimeve, mbajtjen dhe ruajtjen e disa nga etaloneve kombëtare të njësisive të matjes në laboratorët e saj etj., ka nevojë për investime. Pikërisht realizimi i investimeve me efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet, të përdorura nga staf me përgatitjen e nevojshme dhe me një bazë ligjore të konsoliduar, në gjykimin e grupit të auditimit, ndikon në zhvillimin e metrologjisë, si dhe të mbrojtjes së konsumatorit nga abuzimet tregtare me instrumentet matës.

-Sa më sipër nga shqyrtimi dhe vlerësimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se:

### **11. Gjetje nga auditimi**

Spektori Rajonal Tiranë (zyra laboratorë dhe ambiente shërbimi-479 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe bodrumi 429,7 m<sup>2</sup>) me vlerë 21,076,136 lekë është në pronësi të DPM-së, por në përdorim të Drejtorisë së Akreditimit. Spektori i shërbimit nr.1 Tiranë, me numrin më të madh të specialistëve metrologë të autorizuar (21 punonjës) dhe që mbulon tre prefekturat Tiranë, Durrës dhe Elbasan, është zhvendosur në një apartament banimi me sipërfaqe 68 m<sup>2</sup>, duke ndikuar ndjeshëm në performancën e veprimtarisë së këtyre specialistëve për mungesë të hapësirave të vendit të punës dhe ruajtjes dhe pajisjeve të nevojshme.

- Në sektorin e shërbimeve nr.2 në Fier, laboratorin e masës me vlerë 3,606,157 lekë nuk është vendosur në përdorim dhe duke qenë në kushte të tilla, të gjitha pajisjet e punës humbin së shpejti karakteristikat teknike duke dalë jashtë përdorimit. Veç kësaj është jashtë punë pajisja e kontrollit për matje vëllimore me vlerë 1,991,600 lekë.

- Në sektorin e shërbimeve nr.3 në Lezhë, pajisjet laboratorike me vlerë 6,966,960 lekë nuk janë përdorur për qëllime metrologjike, për arsye të mungesës së aplikimeve për shërbime nga palët e treta.

- Në sektorin e shërbimeve nr.4 Korçë ndodhet pajisja ene vëllimore për kontroll karburanti me vlerë 1,974,000 lekë, për të cilën nuk lind nevoja e përdorimit, pasi është zëvendësuar me autolaboratorë për karburantet, por edhe me ndryshimet ligjore, tashmë këtë lloj verifikimi DPM nuk mund ta kryej më.

- Procedura e faturimit të shërbimit të verifikimit të instrumenteve matës kryhet sipas një rregulloreje të brendshme të vitit 2010, miratuar me Urdhrin nr.373, datë 20.10.2010, të Drejtorit të Përgjithshëm të DPM në detyrë për atë periudhë, ku në zbatim të saj, në 60-70% të rasteve, është i njëjti punonjës (pra specialisti metrolog) që kryen verifikimin e instrumentit matës, lëshon faturën për pagesën e shërbimit të verifikimit, si dhe arkëton me para në dorë tarifën e shërbimit, pra jo nëpërmjet bankës. Kjo mënyrë veprimi është në kundërshtim me përcaktimin e bërë në shkronjën 6c në pikën 4 të nenit 3 në Ligjin nr.9367, datë 07.04.2005 për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike, i ndryshuar, pikat 7, 61, 63 dhe 64 të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, i ndryshuar. Theksojmë se të ardhurat që mund të gjenerojë në ditë një metrolog nga verifikimi i instrumentave matës variojnë nga 1,000 lekë ó 20,000 lekë.



## **Konkluzione**

**11.** Mungesa e marrjes së masave, për vënien në funksion të pajisjeve laboratorike në Sektorët Rajonal të DPM, në gjykimin e grupit të auditimit, ka sjellë që investimet e kryera për këto pajisje në vlerën 12,547 mijë lekë, të mos jenë eficiente dhe efektive, duke mos i shërbyer qëllimit, për të cilin ato janë shpenzuar.

**11.1.** Lejimi nga DPM, që i njëjti metrolog të kryejë verifikimin, lëshojë faturën e arkëtimit, si dhe për më tepër të arkëtojë me para në dorë, tarifën e shërbimit të verifikimit, në gjykimin e grupit të auditimit, tregon dobësi në planifikimin dhe zbatimin e parimeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, çka përbën kusht për gjendjen në konflikt interesi, por edhe krijon hapësira për abuzim/keqpërdorim të fondeve publike.

## **Rekomandime**

**11.1.** DPM të marrë masat e nevojshme, për ngritjen e një grupi pune, me qëllim vlerësimin e mundësisë së përdorimit/jo të pajisjeve laboratorike pranë Sektorëve Rajonal, si dhe në rast se këto pajisje nuk mund të gjejnë përdorim nga DPM, në kryerjen e funksioneve rutinore të saj, të transferohen pranë rezervave të shtetit.

### **Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022**

**11.2.** DPM të marrë masat e nevojshme për shfuqizimin e Urdhrit nr.373, datë 20.10.2010 ëPër plotësimin dhe administrimin e dokumentacionit financiar dhe atij me numër serie që përdoret nga strukturat e DPM-së, si dhe pagesa e tarifës së shërbimit të bëhet nëpërmjet bankës.

**Menjëherë**

### **4.1.2.3.A ka ndikuar në mbrojtjen e konsumatorëve veprimtaria e metrologjisë ligjore pranë DPM?**

Sistemi i metrologjisë ligjore në Shqipëri përfshin elementë të kontrollit metrologjik dhe elementë gjurmueshmërisë metrologjike. Elementet e gjurmueshmërisë janë vendimtare për matjet e bëra në të gjithë zinxhirin e instrumenteve matës të peshave dhe matjeve, pasi japin sigurinë që këto matje janë ato që pretendojnë të jenë, pra matje të sakta. Elementet e gjurmueshmërisë gjithashtu mbështesin dispozitat e kontrollit ligjor që janë krijuar për të siguruar që matjet e bëra (p.sh. për rregullim, tregti ose qëllime kontraktuale) janë brenda gabimeve maksimale të lejuara të përshkruara në rregulloret teknike të konformitetit. Duke qenë se vendi ynë, nëpërmjet DPM-së është anëtarë në organizatat ndërkombëtare, EURAMET, EELMEC, OIML dhe anëtare e asociuar në BIPM<sup>49</sup>, për metrologjinë në Shqipëri implementimi, përshtatja dhe zbatimi i rregulloreve dhe rekomandimeve të këtyre organizatave, çon në rritjen e cilësisë së shërbimeve metrologjike, si dhe rritjen e përpjekjeve për mbrojtjen e konsumatorit nga abuzimet me peshat dhe matjet.

### **Gjurmueshmëria në infrastrukturën e DPM.**

DPM në rregulloret teknike ka përshkruar njësitë ligjore kombëtare të matjes, për ato fusha të peshave dhe matjeve (të tilla si masa, gjatësia, volumi) që përdoren në ekonominë e vendit. Njësitë e specifikuar bazohen në njësitë e matjes SI, me shtesa të mundshme që mund të përdoren në rrethana të caktuara për të lehtësuar tregtinë e brendshme dhe ndërkombëtare. Përdorimi i njësive nuk duhet të shkaktojë paqartësi në matjet, tregtimin ose etiketimin e parapaketimeve.

DPM administron nëpërmjet laboratorëve të saj të metrologjisë, një pjesë të standarteve kombëtare të matjes në fushat:

1. Etalon në fushën e masës;
2. Etalon në fushën e densitetit;
3. Etalon në fushën e forcës;
4. Etalon në fushën e gjatësisë;
5. Etalon në fushën elektrike;
6. Etalon në fushën e presioni;
7. Etalon në fushën e termometrisë;
8. Etalon në fushën e lagështisë;

<sup>49</sup> <https://www.bipm.org/en/associates>



9. Etalon në fushën e volumeve;

10. Etalon në fushën e kimisë;

Etalonët e laboratorëve të DPM-së kalibrohen pothuajse rregullisht në laboratorë më të lartë të një vendi anëtarë të BIPM. Laboratorët e metrologjisë transferojnë vlerat dhe pasiguritë nga standardet laboratorike të DPM-së, në standarde të nivelit më të ulët për të krijuar dhe mbajtur një zinxhir gjurmueshmërie të standardeve fizike me standardet ndërkombëtare dhe Sistemin Ndërkombëtar të Njësive SI. DPM nëpërmjet DMSHI administron 9 laboratorë:

1. Laboratori i Masës;

2. Laboratori i Forcës;

3. Laboratori i Presionit;

4. Laboratori Volumetrik;

5. Laboratori i Matjeve të temperaturës;

6. Laboratori i Lagështisë;


7. Laboratori i sasive Elektrike;

8. Laboratori i Gjatësisë;

9. Laboratori i matjes Kimike, analiza e alkoolit të frymëmarrjes.

Laboraret e DMSHI-së ofrojnë shërbimet e kalibrimit për standartet referuese të brendshme dhe sipas kërkesave të subjekteve që përdorin instrumenta matës, subjektet prodhuese, subjektet që tregtojnë produkte e mallra, në fushat e masës, gjatësisë, forcës, enëve nën presion, elektrikut, termometrisë, lagështirës, volumeve dhe kimisë.

Fig 1. Siguria e matjeve nëpërmjet gjurmueshmërisë së instrumenteve matës.



Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Shërbimi i metrologjisë për verifikimin periodik, ofrohet nga DML dhe subjekte privatë të autorizuar që verifikojnë ose ri-verifikojnë instrumentet matëse të peshave dhe matjeve. Ato përdorin standarde që vetë duhet të verifikohen (d.m.th., të kalibrohen për të përmbushur kërkesat ligjore). Ky verifikim i standardeve kryhet në një mënyrë të gjurmueshme dhe me një pasiguri të matjes që është e përshtatshme për përdorimin e synuar. Laboratorët që verifikojnë këto standarde kërkohej të jenë të akredituar në përputhje me ISO/IEC 17025. Vetëm laboratorit i akredituar është i autorizuar të lëshojë certifikata kalibrimi në mënyrë që këto certifikata të pranohen në një gjykatë si dëshmi.

Akreditimi i laboratorëve të kalibrimit të DPM-së, i cili duhet të bëhet nga një organ i akreditimit nënshkruar të marrëveshjes EA MLA<sup>50</sup>, konfirmon kompetencën e këtyre laboratorëve, i mundëson atyre që të njihen ndërkombëtarisht dhe iu jep besim në cilësinë e procedurave të kalibrimit të instrumenteve dhe standardeve të matjes.

Nga DPM pavarësisht, kalibrimit të etalonëve të matjes në laboratorë të nivelit më të lartë

<sup>50</sup> <https://ilac.org/ilac-mra-and-signatories/>



European për rritjen e sigurisë së matjeve, përsëri për rritjen e sigurisë së gjurmueshmërisë është shumë e rëndësishme akreditimi i laboratorëve kalibruer i fushave më të rëndësishme të metrologjisë të DPM-së.

DPM është akredituar me certifikatën ISO/IEC 17025 (e vlefshme për testim, jo kalibrim) në Laboratorin e Forcës; Presionit; Volumetrik, Masës, që nga viti 2016 lëshuar nga DPA, por që aktualisht këtij akreditimi i ka mbaruar afati.

Një kërkesë tjetër kryesore për një laborator kalibrimi për t'u akredituar është shpallja më parë dhe aprovimi i CMC, që është krahasueshmëria ndërlaboratorike, shprehja publikisht e aftësisë së kalibrimit dhe matjes përmes një deklarate pasigurie që ndjek një proces të dokumentuar dhe ka një buxhet të pasigurisë të lidhur. Zakonisht përdoret në fushën e akreditimit të laboratorit të kalibrimit për të shprehur aftësinë matëse të laboratorit<sup>51</sup>.

DPM nëpërmjet krahasueshmërisë ndërlaboratorike CMC ka kryer me sukses 7 krahasime ndërlaboratorike të laboratorit të masës, 2 krahasime të presionit 1 krahasim të volumeve, pasi vetëm këto laboratorë plotësojnë kriteret për akreditim<sup>52</sup>.

### Ndikimi i efektivitetit të shërbimit të kalibrimit nga laboratorët e DMSHI-së.

Kalibrimet e standarteve referuese të instrumenteve matës dhe të instrumenteve të ndryshëm matës nga DPM në vendin tonë burojnë nga: a) sektori vullnetar dhe b) sektori i rregulluar.

Në sektorin vullnetar, laboratorët e kalibrimit të DPM-së sigurojnë gjurmueshmëri metrologjike për industrinë dhe komunitetin e biznesit. Akreditimi i laboratorëve, kërkesat kontraktuale ose forcat e tregut përcaktojnë nevojën për kalibrime të tilla. Rikalibrimi është përgjegjësi e përdoruesit dhe do të varet nga shtrirja e përdorimit dhe mirëmbajtja e standardit ose instrumentit.

Në sektorin e rregulluar laboratorët e kalibrimit të DPM-së caktohen ligjërisht për të verifikuar standardet e matjes, materialet referuese ose instrumentet matëse që mbështesin instrumentet në përdorim për qëllime ligjore të DML-së. Qëllimi i certifikatave të kalibrimit të lëshuara nga DPM është konvertimi i rezultateve të matjes në dëshmi, që do përdoret nga përdoruesi i instrumentit matës dhe gjithashtu që do të pranoheshin në një gjykatë për zgjidhjen e mosmarrveshjeve në rrugë gjyqësore, të tilla si matjet e trafikut, matjet mjedisore, matjet e shëndetit dhe matjet që formojnë bazën e kontratave të rëndësishme monetare, etj.

DPM për periudhën 2018-2020 nëpërmjet laboratorëve të saj nën drejtimin e Drejtorisë DMSHI ka kryer kalibrime të sektorit vullnetarë dhe të rregulluar, pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.14 Numri i kalibrimeve të brendshme dhe të jashtme nga laboratorët e DPM-së

Nr	Laboratori DPM	Kalibrime Viti-2018	%/ Totalit	Kalibrime Viti-2019	%/ Totalit	Kalibrime Viti-2020	%/ Totalit
1	Laboratori Gjatësisë	48	3.77	87	6.80	88	6.82
2	Laboratori i masës. Të jashtme	297	23.35	143	11.18	205	15.88
3	Laboratori i masës. Të brendshme (sekt. të rregulluar)	461	36.24	586	45.82	562	43.53
4	Laboratori elektrik	28	2.20	55	4.30	45	3.49
5	Laboratori i temperaturave	109	8.57	22	1.72	14	1.08
6	Laboratori i lagështirës	18	1.42	57	4.46	69	5.34
7	Laboratori i forcës mekanike	16	1.26	16	1.25	12	0.93
8	Laboratori i presionit	114	8.96	94	7.35	85	6.58
9	Laboratori i volumeve	85	6.68	156	12.20	131	10.15
10	Laboratori i kimisë	96	7.55	63	4.93	80	6.20
	<b>Totali</b>	<b>1272</b>		<b>1279</b>		<b>1291</b>	

Burimi: DPM, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar të dhënave sa më lart rezulton se: laboratori i masës kryen 60 % të kalibrimeve; laboratori i volumeve kryen 10 % të kalibrimeve; laboratorët e tjerë kryejnë 30 % të kalibrimeve. Kërkesa e kalibrimeve nga sektori vullnetar është 63% e totalit të kalibrimeve, ndërsa nga sektori i rregulluar është 37% e totalit të kalibrimeve. Instrumentet ose standartet që kalibrohen marrin certifikatën e kalibrimit nga DPM.

Nga të dhënat në planet vjetore të punës të DMSHI rezulton se: DMSHI nuk ka detajuar në planet vjetore numri e kalibrimeve, 2140 kalibrime në vitin 2018, 2190 kalibrime në vitin 2019 dhe 2290


<sup>51</sup> <http://dpa.gov.al/rreth-nesh/#bashkepunimet>

<sup>52</sup> <http://www.bipm.org/kcdb/cmc/quick-search?includedFilters=&excludedFilters=&page=0&keywords=Albania>



kalibrime në vitin 2020, që janë objektivat sipas strategjisë dhe PBA-së. Nga krahasimi i të dhënave të realizimeve faktike sipas tabelës kundrejt objektivave rezultojnë se: për vitin 2018 janë realizuar 59%, për vitin 2019 janë realizuar 58 %, për vitin 2020 janë realizuar 56% e tyre.

Grafiku nr 2. Kalibrime plan-fakt



Burimi: DPM, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar të dhënave më lart, në një analizë të treguesve të performancës të numrit të kalibrimeve/metrologë, që punojnë në laboratorët e DMSHI-së, e cila ka në organikë 1 Drejtor, 5 përgjegjës sektori dhe 14 specialist metrologë, rezultojnë se:

- Për vitin 2018, nga 1272 kalibrime gjithsej, një metrolog realizon 0.29 kalibrime ose 1 kalibrim në 3 ditë;
- Për vitin 2019, nga 1279 kalibrime gjithsej, një metrolog realizon 0.29 një ose 1 kalibrim në 3 ditë,
- Për vitin 2020 nga 1291 kalibrime gjithsej, një metrolog realizon 0.30 kalibrime ose 1 kalibrim në 3 ditë.
- Gjithashtu për sektorë të veçantë ky tregues është akoma më i ulët, konkretisht sektori i matjeve dimensionale 0.07 kalibrime në ditë, sektori i matjeve elektrike 0.13 kalibrime në ditë, sektori i matjeve mekanike 0.14 kalibrime në ditë etj.

➤ Nëse do të bënim një krahasim për numër banorësh dhe numër punonjësish, që kryejnë testime dhe aktivitete të nevojshme metrologjike në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë në Shqipëri me institucionin homolog të saj, Institutin e Metrologjisë Bullgare<sup>53</sup> në shtetin e Bullgarisë rezultojnë se:

-Për 2,873,476 banorë në Shqipëri, për kryerjen e testimeve dhe aktiviteteve metrologjike laboratorike janë të punësuar **20 specialist**, pra në raportin **1 specialist - 143,674 banorë, ndërkohë** në Bullgari është **po i njëjti numër specialistësh**, që kryen testime laboratorike dhe aktivitete metrologjike laboratorike, **por** numri i banorëve është 6,927,000, ose 4,053,524 banorë më tepër. Pra në Bullgari raporti është 1 specialist - 314,850 banorë, **ose e thënë ndryshe 1 specialist në Bullgari mbulon me shërbime metrologjike rreth 171,176 banorë më tepër, se 1 specialist në Shqipëri.**

-Sa më lart treguesit e produktivitetit dhe të kostos tregojnë se, Drejtoria e Metrologjisë Shkencore dhe Industriale pranë DPM-së, realizon kalibrimet me numër të lartë specialistësh, të cilët kanë një ngarkesë më të vogël në punë në krahasim me vende të rajonit. Për këtë nevojitet që DPM të zhvillojë incentive për të rritur numrin e kalibrimeve në mënyrë që të vihen në eficiencë të plotë burimet njerëzore të saj.

## 12. Gjetje nga auditimi

Drejtorja e Metrologjisë Shkencore dhe Industriale nuk ka hartuar një program me tregues të matshëm të performancës për çdo laborator dhe çdo specialist mbi bazën e të cilëve, të analizohej performanca e specialistëve dhe e çdo laborator/fushe, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Rregulloren e brendshme të DPM nr.104/1, datë 07.02.2014, si dhe kapitullin 4 në manualin praktik të Departamentit të Administratës Publike, për njësitë e burimeve njerëzore në institucionet e administratës publike.

<sup>53</sup> <https://www.welmec.org/legal-metrology-information/country-information/country/bulgaria/>



## **Konkluzione**

**12.** Mungesa e implementimit të objektivave strategjike në plane, aktivitete operacionale, si dhe mungesa e indikatorëve të performancës dhe vlerësimit të tyre, rënia e produktivitetit të burimeve njerëzore me rreth 3% (nga viti 2018-2020), ka ndikuar negativisht për arritjen e rezultateve në punë për DMSHI-në në veçanti, si dhe në efektivitetin e institucionit të DPM-së në tërësi.

## **Rekomandime**

**12.1.** DPM të marrë masat e nevojshme që të vlerësojë ngarkesën sipas sektorëve dhe specialistëve të Drejtorisë së Metrologjisë Shkencore dhe Industriale, për një alokim eficient të burimeve njerëzore të kësaj drejtorie. Gjithashtu të vendosë indikatorë të matshëm për vlerësimin e performancës së tyre, si dhe të implementojë dhe detajojë objektivat strategjik deri në nivel specialisti.

**Në vijimësi**

### **Ndikimi i fushave të mbulimit nga metrologjia ligjore DML.**

Ka shumë fusha të ekonomisë që preken nga peshat dhe matjet dhe kërkon që vetë mbikëqyrja metrologjike të jetë e gjithëpërfshirëse. Një nga detyrimet më themelore të DPM-së ndaj konsumatorit është verifikimi i instrumenteve komerciale të peshimit dhe matjes, si dhe monitorimit të subjekteve të autorizuara nga DPM, për kryerjen e këtij shërbimi.

Sistemi i matjes tregtare është i madh dhe segmentet e tregut që të verifikohen sipas peshës dhe matjeve të metrologëve janë pothuajse të pakufizuar. MFE dhe DPM kanë për detyrë të përcaktojnë se cilat zona do të verifikohen dhe ku burimet e verifikimit mund të përdoren më së miri, si dhe të organizojnë fushata informuese për përdoruesit e instrumentave matëse dhe konsumatorin, me qëllim ndërgjegjësimin e përdoruesve të instrumentave matës konform akteve ligjore dhe teknike të tyre.

DPM për periudhën 2018-2020, e ka kryer verifikimin metrologjik bazuar në ligjin nr. 9875, datë 14.02.2008, òPër metrologjinë të ndryshuar, sipas ndryshimeve përkatëse në vitet 2010, 2013, 2015 dhe 2018, si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Infrastruktura e metrologjisë ligjore e DPM, e cila është angazhuar për të kryer verifikimin periodik të instrumentave matës ligjërisht të kontrolluara të peshave dhe matjeve në Shqipëri përbëhet nga:

- a) DML si pjesë e strukturës organizative të DPM-së e cila kryen shërbime metrologjike të verifikimit periodik të instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar ku hyjnë: shpërndarësit e karburantit dhe gazit të lëngshëm (deri në Mars 2020), peshoret automobilistike, peshoret e tregtimit me pakicë nga subjektet tregtare dhe ato farmaceutike, masat volumore, metrat e llojeve të ndryshme, verifikimi i depozitave/tankeve;
- b) Subjektet private të autorizuara nga DPM për verifikimin periodik të instrumentave matës ligjërisht të kontrolluar si matësat e energjisë elektrike dhe matësat e ujit, autobotet;
- c) Subjektet private të autorizuara nga DPM për riparimin e instrumentave matës të peshave dhe matjeve.
- c) Subjekte private me koncension për shpërndarësit e karburantit etj.

Sipas kuadrit rregullator të fushës, janë përcaktuar karakteristikat metrologjike për 14 instrumente matës, ku për 2 kategori instrumentesh nuk kryhen shërbimet e verifikimit dhe për 3 të tjerë janë autorizuar persona juridik privat, si dhe 1 është dhënë me koncension.

*Pavarësisht përcaktimit të fushave në të cilat do të zbatohen dispozitat e ligjit për metrologjinë, nga ana e DML-së, nuk janë ofruar verifikime të instrumenteve matës të cilët përdoren në fushën e kujdesit shëndetësor, mbrojtjes së mjedisit, sigurisë si dhe pagesave për faturat e komunikimit celular/mobile, matje për kohën dhe frekuencën.*

Kuadri rregullator për metrologjinë ligjore nuk është i plotësuar me akte nënligjore ku të përfshihen dhe të përcaktohen karakteristikat e tyre metrologjike, si dhe periudhat për verifikimet e këtyre instrumenteve, duke vijuar me procedurat për kryerjen e verifikimeve, vlerësimin e konformiteteve etj, duke u bazuar në direktivat e BE-së si dhe rekomandimet e OIML-së.

Nga krahasimi, në lidhje me fushat që mbulon metrologjia ligjore në shtetin e Malit të zi, rezultoi se në instrumentet matës ligjërisht të kontrolluar të përcaktuar dhe grupuar sipas fushave përkatëse të



përdorimit, janë përfshirë instrumente matës:

- a) Në tregtinë e mallrave dhe shërbimeve, si dhe kontrollin e produkteve të paketuara paraprakisht dhe matjen e shisheve të enëve 28 instrumente;
- b) Në mbrojtje të shëndetit të njerëzve dhe kafshëve, si dhe sigurisë së përgjithshme 5 instrumente;
- c) Në mbrojtjen e aseteve, mjedisit dhe burimeve natyrore, sigurisë në punë, si dhe parandalimit të aksidenteve 12 instrumente;
- d) Në sigurinë në komunikacion 5 instrumente, pra gjithsej 50 nënfusha e instrumente<sup>54</sup>.

### 13. Gjetje nga auditimi

-Nuk janë përfshirë për verifikim metrologjik periodik fusha kryesore, ku përdorimi i instrumentave ka ndikim të konsiderueshëm në mbrojtjen e konsumatorit si fusha e mjekësisë, ndotjes së mjedisit, sigurisë publike, frekuencave të telefonisë etj, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 5 të nenit 3 dhe pikën 9 të nenit 8 në Ligjin nr.9875, datë 14.2.2008 òPër Metrologjinë o i ndryshuar.

-Nga DPM, përgjatë periudhës 2018-2020, nuk janë kryer verifikimet periodike të lojërave të fatit, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 21 të nenit 8 në Ligjin nr.9875, datë 14.2.2008 òPër Metrologjinë o i ndryshuar.

### Konkluzione

13. Në gjykimin e grupit të auditimit, DPM përmbush kërkesat minimale të verifikimit periodik të metrologjisë ligjore, si dhe nuk ka ofruar mundësinë gjithëpërfshirjes në shërbimet e saj edhe në fusha të tjera, ku përdoren instrumente matëse.

13.1. Mungesa e verifikimit periodik të disa instrumenteve (në mjekësi, mjedis, frekuenca e telefonisë), në gjykimin e grupit të auditimit, mund të ndikojë negativisht në cilësinë e shërbimit nga këto instrumente dhe mbrojtjes së konsumatorit nga pasaktësitë e mundshme të matjes.

### Rekomandime

13.1. DPM në bashkëpunim me MFE, të marrin masat e nevojshme që, duke u bazuar në studime të tregut të instrumenteve matës në vend, peshës së secilit prej tyre në volumin e transaksioneve në ekonomi, të krijojnë kushte për verifikimin e instrumenteve ligjërisht të kontrolluar, si aparaturat mjeksore, ato të mjedisit, aparaturat për sigurinë publike etj, jo vetëm si një detyrim ligjor, por njëkohësisht në funksion të mbrojtjes së konsumatorit dhe rritjes së efektivitetit të investimeve në fushën e metrologjisë.

### Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022 dhe në vijimësi

#### Ndikimi aktivitetit të verifikimit sipas Sektorëve Rajonal të metrologjisë ligjore.

Në DPM struktura përgjegjëse që mbulon verifikimin metrologjik është DML-ja, e organizuar në: Drejtorinë pranë DPM-së (Drejtori dhe 2 specialist), si dhe 4 Qendra Rajonale/Sektorë shërbimesh si vijon:

- Sektori i Shërbimeve nr. 1 (Qendra Rajonale Tiranë), 19 specialistë metrologë, i cili ushtron aktivitetin e tij në Tiranë, Durrës, Elbasan, Kavajë, Peqin, Librazhd, Gramsh dhe Krujë;
- Sektori i Shërbimeve nr. 2 (Qendra Rajonale Fier), 10 specialistë Metrologë, i cili ushtron aktivitetin e tij në Fier, Berat, Vlorë, Kuçovë, Lushnje, Mallakastër dhe Skrapar;
- Sektori i Shërbimeve nr. 3 (Qendra Rajonale Lezhë), 11 specialistë Metrologë, i cili ushtron aktivitetin e tij në Lezhë, Shkodër, Malësi e Madhe, Kurbini, Mirditë, Tropojë, Pukë, Has, Kukës, Dibër, Mat dhe Bulqizë.
- Sektori i Shërbimeve nr. 4 (Qendra Rajonale Korçë), 10 specialistë Metrologë, i cili ushtron aktivitetin e tij në Korçë, Pogradec, Devoll, Ersekë, Përmet, Gjirokastër, Tepelenë, Delvinë dhe Sarandë.

Sektorët rajonalë janë përgjegjës për planifikimin detajimin dhe kryerjen me cilësinë e duhur të verifikimeve periodike të instrumentave ligjërisht të kontrolluar. Natyrisht, drejtori dhe përgjegjësat e sektorëve duhet të veprojnë brenda direktivave të menaxhimit të DPM-së, SNMKMT 2014-2020, për të siguruar konkurrencë të ndershme, mbrojtjen e konsumatorit, si dhe për të lehtësuar tregtinë ndërshtetërore dhe tregtinë ndërkombëtare.

<sup>54</sup> <https://www.welmec.org/legal-metrology-information/country-information/country/montenegro>





Pajisjet referuese të metrologëve në 4 Qendrat Rajonale, të cilët i përdorin për kryerjen e verifikimeve periodike, janë kalibruar nga Laboratorët e DMSHI, duke siguruar kështu transmetueshmërinë e matjeve, deri tek instrumentet matës në përdorim dhe duke rritur besueshmërinë në shërbimet metrologjike të verifikimit periodik.


Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i planeve vjetorë të punës të DML-së të miratuar nga Drejtori Përgjithshëm i DPM-së, rezulton se, për vitet 2018 dhe 2019 **nuk** është përcaktuar numri i verifikimeve periodike që planifikohen të kryhen për vitet 2018, 2019, ndryshe nga viti 2020, në të cilin është planifikuar të verifikohen 46100 instrumente matës të peshave dhe matjeve.

Procedurat për caktimin dhe kryerjen e verifikimeve janë të përcaktuara në aktet nënligjore përkatëse si dhe në rregulloren e brendshme të DPM. Specialistët e DML-së janë të vetëdijshëm se cila është është përgjegjësia e tyre, të verifikojë të gjitha bizneset e rregulluara dhe të testojë të gjitha instrumentet matëse tregtare brenda zonës së caktuar në baza vjetore ose brenda periudhës kohore të përcaktuar nga DML-ja.

DML duhet të kërkojë që specialistët metrologë të paraqesin lëvizjet përgjatë punës, të paktën një muaj përpara. Në raste të tjera, përgjegjësit e sektorëve përkatës duhet t'i caktojnë bizneset për verifikim mbi bazën e një periudhe të caktuar kohore ose grafiku. Sido që të jetë, specialisti metrolog ka lirinë e tij të veprimit, për të ndryshuar itinerarin sipas nevojës bazuar në çështjet që i dalin gjatë punës, sic mund të jenë shqyrtimi me prioritet i ankesave të ndryshme nga konsumatorët dhe kushtet e motit (i cili ndikon në rezultatet e verifikimit). Megjithatë, niveli drejtues i DML-së ka vepruar mbi një bazë planifikimi paraprak nisur nga të dhëna të viteve të mëparshme dhe të një databaze të mbajtur në formatin EXCEL.

Sipas të dhënave nga DML, subjekte private, të cilët kanë në përdorim në aktivitetin e tyre instrumente matës ligjërisht të kontrolluar, për vitin 2018 janë 23180 subjekte, vitin 2019-23139 subjekte, vitin 2020-21683 subjekte. Nga të dhënat e INSTAT-it në Shqipëri në vitin 2018 kanë ushtruar aktivitet 107450 subjekte private, nga të cilat 63407 subjekte tregtare, akomodim dhe shërbim ushqimor. Në vitin 2019 kanë ushtruar aktivitet 104090 subjekte biznesi gjithsej, nga të cilat 59053 subjekte tregtare, akomodim dhe shërbim ushqimor<sup>55</sup>.

Grafiku nr 3. Subjekte të verifikuara/subjekte tregtare gjithsej



Burimi: DPM dhe INSTAT, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Siç vërehet në grafikun e mësipërm, vendosja e objektivit strategjik në SNMKMT 2014-2020 për rritje me 10% në vit të numrit të verifikimeve është bërë mbi një bazë reale të ekzistencës së një tregu më të gjërë në vendin tonë, që ka në përdorim instrumente matëse.

Në përgatitje të itinerareve të punës, metrologët thjesht nisen nga të dhënat e verifikimeve të vitit të kaluar për zonën e caktuar, si dhe përdorin formularë të printuar paraprakisht për të zvogëluar kohën që inspektorit i duhet për plotësimin e informacionit rutinë. Këto formularë nga specialistët e DML-së plotësohen mbi bazë mujore, si pasqyra nr. 6 òMjete Matëse dhe Pronarë të Verifikuarò, pasqyra nr. 7 òInstrumenta Matës dhe Pronarë të Regjistruarò, pasqyra nr. 3 òTë ardhurat dhe Arkëtimetò, Librin e shitjeve për të gjitha faturimet gjatë muajit përkatës, faturat, mandat arkëtimi, pullat ose ndryshe shenja dalluese e verifikimit, libreza e verifikimit të instrumentit matës.

Gjatë periudhës 2018-2020, veprimtaria e DML-së ka konsistuar në kryerjen e verifikimeve periodike të instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar në përdorim nga subjektet përkatëse.

<sup>55</sup> www.INSTAT.com



Duke iu referuar të dhënave të vëna në dispozicion nga DPM rezultojn se, *veprimtaria verifikuese e metrologëve të autorizuar është shoqëruar me luhatje në lidhje me numrin e instrumenteve dhe subjekteve të verifikuar ndërmjet sektorëve, ndërmjet specialistëve metrologë, duke pësuar një rënie të madhe në vitin 2020 me 28% më pak në krahasim me vitin e kaluar.*


Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i dokumentacionit mbi numrin e verifikimeve përgjatë periudhës 2018-2020, rezultoi se:

Në vitin 2018 janë regjistruar 23180 subjekte të cilët disponojnë instrumente matës ligjërisht të kontrolluar dhe nga DML janë kryer 47247 verifikime.

Në vitin 2019 janë regjistruar 23139 subjekte të cilët disponojnë instrumenta matës ligjërisht të kontrolluar dhe nga DML janë kryer 47247 verifikime.

Në vitin 2020 janë regjistruar 21,683 subjekte të cilët disponojnë instrumenta matës ligjërisht të kontrolluar dhe nga DML janë kryer 33,421 verifikime.

Grafiku nr 4. Realizimi Faktik i numrit të verifikimeve sipas sektorëve dhe si DML




Burimi: DPM, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga krahasimi i realizimit faktik ndërmjet viteve, duke marrë për reference 100% vitin 2018, realizimi në përqindje për vitet 2019 dhe 2020 paraqitet në grafikun e mëposhtëm.

Vihet re një ulje nga viti në vit i produktivitetit për të gjithë sektorët, ulje e cila shënon kulmin në vitin 2020.

Grafiku nr 5. Krahasimi i realizimit faktik në % i numrit të verifikimeve



Burimi: DPM, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së


Nga të dhënat e verifikimeve të realizuara (në %) për 4 sektorët rajonal të DPM-së, për vitin 2019 krahasuar me vitin 2018, rezultoi se, numri i verifikimeve ka rënë me 1%. Ndryshe paraqitet situata në vitin 2020 krahasuar me realizimin 2019, është në raport 71%, numri i verifikimeve me një rënie prej 29%. Në analizë sipas sektorëve viti 2020: Sektori nr 1 Tiranë paraqitet me një rënie në 66% të numrit të verifikimeve, sektori nr 2 Fieri me 83 %, sektori nr 3 Lezhë me 71% dhe sektori nr 4 Korçë me 72%.

*Është e rëndësishme të theksojmë se gjatë vitit 2020 ka rënie të numrit të verifikimeve, për shkak të situatës së krijuar prej pandemisë Covid 19, ku u kufizua lëvizja e lirë e qytetarëve. Gjithashtu në Mars të vitit 2020, DPM-së i është hequr shërbimi i verifikimit periodik të shpërndarësve të karbuarantit dhe gazit të lëngshëm, me një efekt prej rreth 12400 verifikimesh më pak, që në krahasim me realizimin 46769 verifikime në vitin 2019 është 25% më pak.*

Treguesit sasiorë të verifikimit sipas llojit të instrumenteve matës 2018-2020, paraqiten në grafikun e mëposhtëm.



Grafiku nr 6 Numri i verifikime sipas instrumentave matës



Burimi: DPM, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Peshoret zënë 23.3% të verifikimeve, Gramarët - 12.5%, Masat vëllimore - 33%, Disibutorët e karburantit, kontalitrat - 21%, Metrat - 0.6%, Dozatorët - 4.8%, Taksimëtrat - 4.2% etj, Autobote, Cisterna, Rezervuarë, Mikroskopë, Regjim automatik, Vozë, Peshore automobilistike të gjitha zënë 1.2% të totalit.


### Ndikimi aktivitetit sipas specialistëve metrologë të metrologjisë ligjore.

Në rregulloren e brendshme janë përcaktuar detyrat e përgjithshme dhe të veçanta për DML-në, si për strukturën në drejtorinë e përgjithshme ashtu dhe për sektorët e shërbimeve. Specialisti metrologë, si staf i sektorëve të shërbimeve, *duhej të hartonte planet e punës mujore, 4-mujore dhe vjetore në përputhje me objektivat strategjike të DPM-së.*

Sa më sipër grupi i auditimit, u përpoq që të bënte një vlerësim të performancës për specialistin metrolog (duke marrë në konsideratë faktorë të cilët ndikojnë në punën e tij, llojet e pajisjeve të punës, dendësia dhe shpërndarja e subjekteve, përgatitja e dokumentacionit të verifikimit, etj). Nga ky vlerësim (pasqyruar në Kapitullin ËAnekseö), rezultoi se:

- Në Sektorin nr.1 Tiranë, ku punojnë 19 specialistë metrologë, për 234 ditë pune normale në vit, për vitet 2018, 2019 dhe 2020, një specialist metrolog ka verifikuar mesatarisht në ditë 4.7 instrumente për vitin 2018, 4.6 instrumente për vitin 2019, 3.1 instrumente për vitin 2020;
- Në sektorin nr. 2 Fier ku punojnë 10 specialistë metrologë, për vitin 2018 - 3.9 verifikime në ditë, për vitin 2019 - 3.8 verifikime, për vitin 2020 - 3.2 verifikime;
- Në sektorin nr. 3 Lezhë ku punojnë 11 specialistë metrologë, për vitin 2018 - 3.8 verifikime në ditë, për vitin 2019 - 3.9 verifikime, për vitin 2020 - 2.8 verifikime;
- Në sektorin nr. 4 Korçë ku punojnë 10 specialistë metrologë, për vitin 2018 - 4 verifikime për metrolog në ditë, vitin 2019 ó 4 verifikime, vitin 2020 - 3 verifikime për metrolog në ditë.

Grafiku nr.7 Numri i verifikimeve mesatare ditore/metrolog/sectorë/DML



Burimi: DPM, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Gjithashtu grupi i auditimit gjatë fazës së terrenit, morri pjesë në procesin e verifikimit të një instrumenti matës ËPeshore elektronikeö. nga prezantimi tek biznesi, verifikimi fizik i instrumentit, verifikimi teknik i saktësisë me materialet referuese, plotësimi i librezës, plotësimi i faturës me TVSH, plotësimi i mandat arkëtimit, proces që zgjati 30 minuta.

Sa më sipër, në vitin 2018 janë 28 specialist metrologë, të cilët kryejnë nën mesataren e vitit 4.1 verifikime në ditë, në vitin 2019 janë 29 specialistë metrologë, të cilët kryejnë nën mesataren 4.1 verifikime ne ditë, si dhe në vitin 2020 janë 20 specialistë metrologë, të cilët kryejnë nën mesataren 3.0 verifikime në ditë. Produktiviteti sipas kohës së domosdoshme për kryerjen e një verifikimi e matur nga grupi i auditimit, duke filluar me procedurën teknike dhe plotësimin e dokumentacionit



që zgjati 30 minuta, rezulton që një specialist metrolog për nivelin e produktivitetit aktual 3 verifikime/8 orë, në fakt i duhen 1 orë e 45 minuta për të kryer 3 verifikime mesatarisht në ditë, duke shtuar dhe 2 orë udhëtim, atëherë për 3 orë e 45 minuta specialisti metrolog i DML-së përfundon punën, duke mbetur pa mbuluar me aktivitet rreth 4 orë e 30 minuta të një dite punë. Në përfundim rezultoi se:

#### **14. Gjetje nga auditimi**

-Në Drejtorinë e Metrologjisë Ligjore dhe në të gjithë sektorët rajonal të DPM-së, informacioni mbi punën e kryer përgatitet manualisht, si dhe nuk administrohet në formë elektronike, duke mbartur risk operacional të humbjes/keqpërdorjes.

-Drejtoria e Metrologjisë Ligjore nuk mban informacion të dokumentuar nga specialistët metrologë, mbi bazë ditore ose javore, i cili të jetë në dispozicion të përgjegjësit të sektorit ose drejtorit të DML-së, me qëllim që specialistët metrologë të regjistrojnë kohën e nisjes dhe të mbërritjes në një subjekt tregtar, dhe në këtë mënyrë koha e kërkuar për të kryer verifikimin të jetë e dokumentuar, në kundërshtim me nenin 11 në Ligjin nr.10296, datë 16.09.2016 ëPër menaxhimin financiar dhe kontrollinö, i ndryshuar.

#### **Konkluzione**

**14.**Mungesa e dokumentimit plotësisht të procesit të punës në terren të metrologut, në gjykimin e grupit të auditimit, mund të ndikojë negativisht në analizimin e ngarkesës në punë dhe monitorimin e progresit në detyrat e caktuara, si dhe në krahasimin e performancës së një metrologu me një tjetër.

#### **Rekomandime**

**14.1.** Drejtoria e Metrologjisë Ligjore të marrë masat e nevojshme, që procesi i punës në terren të metrologëve, të jetë i dokumentuar plotësisht, ku të pasqyrohet i gjithë informacioni i nevojshëm për kryerjen e verifikimit, me qëllim vlerësimin e ngarkesës në punë, planifikimin real të detyrave për secilin metrolog, si dhe vlerësimin e performancës së tyre.

**Në vijimësi**

#### **Ndikimi i trajnimit dhe kontrollit të cilësisë të DML-së.**

Një qëllim i DML-së në verifikimin e instrumenteve matës të peshave dhe matjeve është arritja e uniformitetit midis metrologëve të ndryshëm në të gjitha aktivitetet e tyre të verifikimit. Metrologët e rinj kërkohet të mësojnë një larmi të madhe të procedurave të verifikimit në një numër të madh disiplinash.

DML në planet e sajë mujore ka parashikuar të trajnojë specialistët e saj, por nuk rezultoi të ketë një program trajnimi të përcaktuar që përshkruan sesi trajnohen metrologët e rinj ose të vjetër në secilën disiplinë. Programi dokumentacioni i trajnimit duhet të rregjistrohet për të treguar se këto sesione trajnimi kanë ndodhur dhe që identifikon marrësit e trajnimit. Për më tepër, një proces i përcaktuar trajnimi duhet të zhvillohet për azhornimin e inspektorëve të rinj dhe me përvojë kur ndryshojnë procedurat e testimit të instrumentave metrologjikë.

Trajnimi i nevojshëm për specialistët metrologë të verifikimit mund të vendoset në dy kategori; trajnime për metrologët e rinj dhe trajnime të avancuara. Një metrolog i ri ka nevojë për trajnim në ligjet themelore, rregulloret, instrumentet matëse, teknologjinë e matjes, aplikimet e matjes dhe teknikat e verifikimit për t'i mundësuar inspektorit të kryejë verifikime të pavarura në përputhje me procedurat e pranura të testimit metrologjik, politikat dhe interpretimet e kërkesave të peshave dhe matjeve.

#### **Programe komunikimi dhe fushata ndërgjegjësuere të bizneseve dhe konsumatorit, nga DML.**

Për DPM-në një faktor kyç për suksesin, është komunikimi i rregullt dhe në kohë me bizneset që rregullohen nga legjislacioni i metrologjisë. Përfitimet janë të mëdha, pasi pronarët e bizneseve duhet të dinë për peshat, matjet, ligjet dhe rregulloret, si dhe të dinë se çfarë të presin nga verifikimet, inspektimet. Në qoftëse ata janë të informuar për ndryshimet, do të kuptojnë përgjegjësitë e tyre për të përmbushur kërkesat dhe të kuptojnë që mosrealizimi i detyrimeve ligjore mbi metrologjinë ndikon negativisht bizneset e tyre, ndërkohë edhe ushtrimi i detyrës së



specialistëve të metrologjisë bëhet më i lehtë.

Një aktivitet tjetër i rëndësishëm që krijon mbështetje për DML-në janë fushatat për ndërgjegjësimin e konsumatorit si një përpjekje për marrëdhënie me publikun dhe shtrirje në terren. Konsumatorët rrallë shohin specialistë metrologë që kryejnë verifikime në terren, kështu që ata mund të mos e dinë që programi ekziston. Rrjedhimisht DPM duhet të bëjë një përpjekje për të "treguar historinë e saj" për t'i bërë konsumatorët të vetëdijshëm se si, nga programet e peshave dhe matjeve të DPM-së përfiton konsumatori. Të njëjtat përpjekje për marrëdhëniet me konsumatorin mund t'i edukojnë konsumatorët sesi ata mund të mbrohen më mirë në marrëdhëniet tregtare. Një publik i ditur do të thotë gjithashtu se konsumatorët nëpërmjet ankesave do të dinë kë të kontaktojnë për të raportuar një problem të perceptuar/ndeshur në treg. Forcimi i besimit të konsumatorit dhe bërja e tij aleat, do të ndihmonte në përmirësimin e punës së DML-së dhe minimizimin e pasaktësive në peshat dhe matjet.

-Sa më sipër, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se:

### **15. Gjetje nga auditimi**

-DPM nuk ka hartuar një program komunikimi me subjektet private dhe publike që përdorin instrumente matës ligjërish të kontrolluar për pjesëmarrjen, ndërgjegjësimin dhe njohjen e rëndësisë dhe detyrimeve të tyre për verifikimin metrologjik të instrumenteve matëse, sipas kërkesave në planin e veprimit afatgjatë të SNMKMT 2014-2020.

-DML nuk ka marrë masa për ngritjen dhe vendosjen në funksion të një sistemi të brendshëm të menaxhimit të cilësisë sipas përcaktimeve të bëra në rregulloren e brendshme nr.104/1, datë 07.02.2014 dhe rekomandimeve të OIML<sup>56</sup>, për metrologjinë ligjore.

### **Konkluzione**

**15.** Në gjykimin e grupit të auditimit, mungesa e sistemit të menaxhimit të cilësisë për Drejtorinë e Metrologjisë Ligjore, ka sjellë që ky shërbim të mos kalojë në filtra të kontrollit të cilësisë, specialistët metrolog të mos trajnohen në mënyrë të vazhdueshme dhe për pasojë mund të ndikojë negativisht në cilësinë dhe besueshmërinë e shërbimit të verifikimit metrologjik;

**15.1.** Mungesa e komunikimit/fushatave ndërgjegjësuëse me bizneset dhe konsumatorët, në gjykimin e grupit të auditimit, mund të ndikojë negativisht në informimin për të drejtat dhe detyrimet e tyre, e për rrjedhojë rritjen e vështirësisë për DPM në kryerjen e aktivitetit, si dhe mund të cenojë rolin e saj në mbrojtjen e konsumatorit nga abuzimet me peshën dhe matjen.

### **Rekomandime**

**15.1.** DPM të marrë masat e nevojshme, duke iniciuar procesin, që specialistët metrolog të DML-së, të jenë pjesë e sistemit të menaxhimit të cilësisë së institucionit, dhe për të vijuar më tej me akreditimin e trupës verifikuese në përputhje me kërkesat e standardit ISO/IEC 17020, me qëllim ngritjen dhe forcimin e shërbimit të verifikimit metrologjik.

**15.2.** DPM të marrë masat e nevojshme që të kryejë fushata ndërgjegjësimi me konsumatorët dhe bizneset, me qëllim rritjen e nivelit të informimit, për të drejtat dhe detyrimet e tyre në marrëdhëniet tregtare.

### **Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2022 dhe në vijimësi**

#### **Spektori i parapaketimeve dhe shisheve enë matëse.**

Kuadri rregullator në funksion të veprimtarisë së metrologjisë ligjore, përfshin parapaketimet dhe shisheet enë matëse, ligjërish të kontrolluara, ku më konkretisht detyrimet ligjore janë përcaktuar në Ligjin nr.9875, datë 14.02.2008 òPër metrologjinë o i ndryshuar, VKM nr.1161, datë 13.08.2008 òPër miratimin e rregullores për shisheet enë matëse o dhe VKM nr. 1352, datë 3.10.2008 òPër miratimin e rregullores për parapaketimet o. Në lidhje me fushën që mbulon parapaketimet, BE ka nxjerrë direktivat nr.76/211/EEC, 75/107/EEC dhe 2007/45/EEC, si dhe amendimet përkatëse. Gjithashtu në mbështetje të këtyre direktivave janë nxjerrë dhe udhëzuesit përkatës të ÈELMEC dhe të OIML.

Në DPM, sektori që mbulon parapaketimet dhe shisheet enë matëse (me përbërje 1 përgjegjës dhe 1

<sup>56</sup> [https://www.oiml.org/en/files/pdf\\_d/d009-e04.pdf](https://www.oiml.org/en/files/pdf_d/d009-e04.pdf)



specialist) është pjesë e Drejtorisë së Sigurimit të Cilësisë dhe Parapaketimeve, e cila është krijuar me Urdhrin e Kryeministrit të RSH-së nr. 23, datë 23.02.2012, òPër miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë. Në rregulloren e brendshme për organizimin dhe funksionimin e DPM-së, lidhur me DSCP, janë përcaktuar detyrat deri në nivel specialisti.

-Sa më sipër, nga shqyrtimi dhe vlerësimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, kryesisht të atij mbi realizimin e aktiviteteve vjetore të planifikuara, rezultoi se:

## 16. Gjetje nga auditimi

-Përgjatë periudhës 2018-2020 sektori dhe laboratorit i parapaketimeve nuk ka kryer asnjë aktivitet, si testim të produkteve të parapaketuara/shisheve enëmatëse;

-Nga DPM, përgjatë periudhës 2018-2020, nuk janë kryer trajnime për specialistët e sektorit të parapaketimeve, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në rregulloren e brendshme nr.104/1, datë 07.02.2014;

## Konkluzione

16. Mungesa e kryerjes së funksioneve thelbësore nga ky sektor, dhe përfundimi i tij më së shumti në kryerjen e detyrave administrative (përgatitje dhe mirëmbajtje e dokumentacionit, autolaboratorit të parapaketimeve, etj) në gjykimin e grupit të auditimit, nuk kontribuon në qëllimin për të cilin ai është krijuar, si dhe ndikon negativisht në efektivitetin e veprimtarisë së DPM-së në tërësi.

## Rekomandime

16.1. DPM të marrë masat e nevojshme, që punonjësit e sektorit të parapaketime të vihen në funksion të plotë të realizimit të objektivave institucional, duke i angazhuar në detyrat e këtij sektori/detyra të sektorëve të tjerë brenda DPM, për aq sa është e mundur.

**Brenda 6-mujorit të parë të vitit 2020 dhe në vijimësi**

## Ndikimi i sektorit privat në shërbimet e verifikimit periodik e monitorimi i subjekteve të autorizuar nga DPM.

Pjesë e sistemit të metrologjisë janë subjektet private të autorizuar nga DPM, për kryerjen e shërbimeve metrologjike, për të cilat DPM nuk zotëron kapacitetet e nevojshme.

Autorizimi i subjekteve private nga DPM, për shërbimin metrologjik të verifikimit të instrumenteve matës, ku caktohen përgjegjësitë verifikuese/rregullatore, kërkon që DPM si autoriteti rregullator të kryejë monitorime periodike në terren për të siguruar që kompanitë e shërbimeve po përmbushin përgjegjësinë e tyre, duke ndjekur procedurat e sakta të testimit të instrumenteve, duke bërë riparimet e tyre, si dhe raportimin e rezultateve të testit.

Gjithashtu, duke ditur se kompanitë private të shërbimeve metrologjike, shpesh kanë një konflikt interesi, ndërmjet qëllimit të tyre "fitimprurës" dhe përgjegjësisë së tyre lidhur me verifikimin periodik të instrumenteve matës përkatës, është një arsye më shumë, që monitorimet ndaj tyre të konsiderohen dhe zbatohen me kujdes.

Në kuadër të përfshirjes së sektorit privat në shërbimet e metrologjisë ligjore në Shqipëri, janë autorizuar aktualisht 15 kompani private të certifikuar me certifikatë ISO 17020 si trupa verifikuese. Nga këta 3 subjekte/laboratorë privatë për verifikim të matësve të energjisë elektrike, 4 për verifikimin e matësve të ujit të pijshëm, 4 për verifikim të cisternave rrugore; 2 për shërbim riparimi dhe testimi të përkohshëm të distributorëve të karburantit, si dhe 2 për peshoret automobilistike.

Nga një analizë e numrit të verifikimeve periodike për tre vitet periudhë auditimi dhe të problematikës së nxjerre nga aktiviteti rezultoi si më poshtë:

Tabela nr.15 Subjekte të autorizuar dhe verifikimet metrologjike 2018-2020, ofruar prej tyre

Nr	Subjekte të Autorizuara nga DPM	Verifikime 2018	Verifikime 2019	Verifikime 2020
1	Subjekte riparuese të peshoreve	44	34	32
2	Subjekte riparuese të shperndarësve të karburantit	0	10	1,861
3	Subjekte të cisternave rrugore	355	457	362
4	Subjekte të matësve të energjisë elektrike	194,503	208,104	196,268



5	Subjekte të matësave të ujit	4,124	11,874	225
6	Koncensionit shpërndarësve të karbuantit dhe gazit të lëngshëm	0	0	124,34
	<b>Totali</b>	<b>199,026</b>	<b>220,479</b>	<b>211,182</b>

Burimi: MFE dhe DPM, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga shqyrtimi i disa dosjeve të autorizimeve subjekteve private, rezultoi se kompanitë e autorizuar nuk bëjnë një planifikim periodik, të numrit të verifikimeve metrologjike, mbi bazën e të cilit të vlerësohet aktiviteti dhe performanca e tyre. Prandaj grupi i auditimit në vlerësimin e performancës së këtyre subjekteve, është udhëhequr nga të dhënat e INSTAT-it dhe krahasimi ndërmjet viteve.

Nga të dhënat e pasqyruara në tabelën e mësipërme, vërehet se kemi një mbulim të kënaqshëm me verifikim periodik të matësave elektrike me një numër konstant, po ashtu edhe të çisternave rrugore. Ndërsa verifikimi i matësave të ujit është në nivele mjaft të ulëta, ku për vitin 2020, verifikimi i matësave të ujit, renditet i fundit, në krahasim me verifikimet e instrumenteve të tjerë, dhe për këtë përgjegjës janë Ndërmarrjet e Ujësjetës Kanalizimeve.

Referuar të dhënave të raportit të monitorimit të Entit Rregullator të Ujit<sup>57</sup> për vitin 2019, në këtë sektor, raportohen 199,543 klientë pa matës uji, nga të cilët 8,201 janë të kategorisë jo familjarë. Ky numër shumë i lartë i klientëve të cilët faturohen afrofe, është tregues që Ndërmarrjet e Ujësjetës Kanalizimeve nëpër Bashki, vazhdojnë të përballen me sfidën më të madhe të eliminimit të faturave afrofe dhe pajisjen e klienteve me matës uji. Referuar të dhënave nga INSTAT-i fondi i ndërtesave të banuara dhe i ndërtesave tregtare në vendin tonë është 1,008,243<sup>58</sup>, për pasojë edhe potenciali i numrit të matësave të ujit është 800 mijë matës uji. Realizimi i verifikimit periodik për matësat e ujit, në raport me sasinë potenciale afërsisht 800,000 matës uji që janë në përdorim, është 0.5% për vitin 2018, 1.5% për vitin 2019 dhe 0.03% për vitin 2020.

Referuar kërkesave ligjore të verifikimit periodik sipas Udhëzimit të ish Ministrisë së Energjitikës, Tregëtisë dhe Ekonomisë nr.193 datë 09.03.2009, verifikimi i matësave të ujit duhet të kryhet çdo 5 vjet (Njehsorë të matjes së ujit të ftohtë).

Sipas të dhënave sa më lart nga DPM, ERRU e INSTAT verifikimi i matësave të ujit, si një shërbim i cili e ndikon direkt në saktësinë sasisë së konsumit të ujit të pijshëm nga konsumatorët, është i pambuluar me verifikim metrologjik, për pasojë edhe konsumatorët ose Ujësjetës Bashkive janë të pa mbrojtur nga pasaktësitë që mund të vijnë nga matjet e ujit nga matës të pa kontrolluar. DPM përjashtimisht dërgimit të disa shkresave Bashkive dhe strukturës qendrore të Ujësjetës Kanalizimeve në vitin 2018, për gjithë periudhën 2019-2020 nuk ka ndërmarrë ndonjë nismë ose masë për ndryshimin e gjendjes dhe rritjes së efektivitetit të verifikimit të matësave të ujit.

## 17. Gjetje nga auditimi

- Përgjatë periudhës 2018-2020, verifikimi metrologjik i matësave të ujit, krahasuar me numrin e matësave të ujit në përdorim, nuk është kryer në ritmet e duhura nga subjektet private të autorizuar nga DPM, për ofrimin e këtij shërbimi, në kundërshtim me Udhëzimin nr.193 datë 09.03.2009 ËMbi frekuencën e verifikimit periodik të instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar.

## Konkluzione

17. Mungesa e verifikimit metrologjik të matësave të ujit, nuk realizon qëllimin e Ligjit të metrologjisë, për mbrojtjen e konsumatorit nga abuzimet me peshën dhe matjet, si dhe në gjykimin e grupit të auditimit, mund të rriten mundësitë e faturimit jo real të konsumit të ujit.

## Rekomandime

17.1. DPM në bashkëpunim me MFE, të marrin masat e nevojshme, që të kryhet verifikimi metrologjik i matësave të ujit, me qëllim mbrojtjen e konsumatorëve.

### Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022 dhe në vijimësi

#### 4.1.2.4.A ka qenë efektiv bashkëpunimi ndërinstitucional i DPM?

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga DPM, mbi bashkëpunimin ndërinstitucional, rezultoi se ka qenë në nivele të ulëta, ku mund të citojmë dy

<sup>57</sup> [https://www.erru.al/doc/Raporti\\_vjetor\\_2020.pdf](https://www.erru.al/doc/Raporti_vjetor_2020.pdf)

<sup>58</sup> <http://www.instat.gov.al/al/temat/censet/censet-e-popullsise%20C3%AB-dhe-banesave/#tab2>



vizita studimore të studentëve të Universitetit të Vlorës, Fakultetit të Shkencave të Natyrës, disa shkresa të DPM drejtuar ISHMT, për marrjen e masave ndaj subjekteve private që kanë refuzuar të kryejnë shërbimin e verifikimit, por që kanë mbetur pa përgjigje.

-Sa më sipër, më konkretisht, përgjatë periudhës 2018-2020, rezultoi se:

### 18. Gjetje nga auditimi

Referuar përcaktimeve të bëra në nenin 8 të Ligjit nr.9875, datë 14.02.2008 òPër metrologjinë, i ndryshuar, si dhe objektivave strategjik në SNMKMT 2014-2020, **ka munguar bashkëpunimi me:**

- Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit për iniciimin e procedurave të akreditimit të laboratorëve;
- Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut për shkëmbimin e informacionit mbi problematikat e instrumenteve matëse, gjatë verifikimit/inspektimit të tyre;
- Institutin e Fizikës Bërthamore, për kryerjen e matjeve/verifikimeve të instrumenteve matës ôdozimetëro, i cili kontrollon dozat e rrezatimit jonizues;
- Universitete dhe Fakultete të ndryshme, si ai i Politeknikut, i Shkencave të Natyrës, me qëllim sigurimin e shërbimeve elektronike dhe mekanike në lidhje me riparimin, projektimin dhe ndërtimin e pajisjeve të matjeve;
- Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, me qëllim shkëmbimin e informacionit, mbi importet e kryera të instrumenteve matës, duke shërbyer për plotësimin dhe përditësimin e databasës që admistrion DPM për instrumentet matës dhe në këtë mënyrë rritjen e numrit të verifikimeve të instrumenteve;
- Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë (DPP), me qëllim verifikimin e saktësisë së matjeve të radarëve të shpejtësisë. Theksojmë se DPM i ka kërkuar informacion DPP-së, për llojin e radarëve që ka në përdorim, me qëllim që të sigurojë pajisjet e nevojshme për kryerjen e kalibrimit dhe verifikimit të tyre, por që nga DPP nuk është kthyer përgjigje, çka do të thotë se deri në fund të vitit 2020 nuk është kryer verifikimi i radarëve që masin shpejtësinë e automjeteve/motomjeteve;
- Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve, për marrjen e masave konkrete me qëllim verifikimin e aparatëve matës të ujit, instrument, i cili deri më sot nuk është verifikuar;
- Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, për kalibrimin e aparaturave që përdoren në analizat laboratorike të ushqimeve, me qëllim rritjen e saktësisë së rezultateve të gjeneruara.

### Konkluzione

18. Mungesa e bashkëpunimit ndërinstucional të DPM, për shkak të saj apo të institucioneve të sipërpërmendura, në gjykimin e grupit të auditimit, ndikon negativisht në veprimtarinë e institucionit, mbulimin me verifikim metrologjik të disa instrumenteve matës, dhe në përfundim në mbrojtjen e konsumatorit.

### Rekomandime

18.1. MFE të marrë masat e nevojshme, që të ngrejë një grup pune, i cili të hartojë VKM përkatëse duke ia referuar edhe direktivës së BE-së<sup>59</sup>, për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve që janë pjesë e infrastrukturës së cilësisë dhe mbrojtjes së konsumatorit, si ISHMT, DPA, DPS, KMK, etj, për shkëmbimin e informacionit, zbuluar dhe hetuar shkeljet e legjislacionit përkatës, me qëllim mbrojtjen e interesave ekonomike të konsumatorëve.

### Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2022

Në nenin 10 të Ligjit nr.9875, datë 14.02.2008 òPër metrologjinë, i ndryshuar, parashikohej që pranë DPM-së, të krijohej dhe funksiononte Këshilli i Metrologjisë, si një organ këshillimor i Drejtorit të Përgjithshëm të DPM-së. Referuar urdhërit nr.517, datë 07.07.2008, të ndryshuar, të ish Ministrit të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës, është përcaktuar mënyra e organizimit dhe funksionimit të Këshillit, me 13 anëtarë në përbërje, si dhe detyrat e tij, si më poshtë vijon:

- Dhënien e rekomandimeve për zhvillimin e metrologjisë shkencore, industriale dhe ligjore, si dhe të infrastrukturës së përgjithshme kombëtare të metrologjisë;

<sup>59</sup> Regulation (EU) 2017/2394 of the European Parliament and of the Council of 12 December 2017





- Kryerjen e analizave cilësore dhe sasiore të nevojave të zhvillimit të aktivitetit kombëtar të kalibrimit të instrumenteve matës, të etalonëve kombëtar dhe të materialeve referues;
- Promovimin dhe zhvillimin e bashkëpunimit ndërinstucional dhe ndërdisiplinar në fushën e metrologjisë;
- Dhënien e mendimeve për përmirësime të legjislacionit për metrologjinë, etj.

Në vijim të këtij urdhëri nga Drejtori i Përgjithshëm i DPM, njëkohësisht Kryetar i Këshillit, përgjatë muajit Mars të vitit 2019, i është dërguar shkresë 13 institucioneve të ndryshme (MFE, ISUV, AKU, DPD, DPT, DPA, DPS,<sup>60</sup> etj), me qëllim propozimin prej tyre të personave që do të jenë pjesë e Këshillit, në rolin e anëtarit.

-Sa më sipër grupi i auditimit në intervistën drejtuar DPM-së, shtroi pyetjen nëse ka funksionuar Këshilli i Metrologjisë përgjatë periudhës 2018-2020, ku rezultoi se:

### **19. Gjetje nga auditimi**

Përgjatë periudhës 2018-2020 nuk ka funksionuar Këshilli i Metrologjisë, referuar përcaktimeve të bëra në nenin 10 të Ligjit nr.9875, datë 14.02.2008 òPër metrologjinë, i ndryshuar.

- MFE nuk ka miratuar kërkesën e Drejtorit të Përgjithshëm të DPM-së, për miratimin e përbërjes nominale dhe funksionimin në kushte normale të Këshillit të Metrologjisë, me arsyetimin se, nuk ka një bazë ligjore, në të cilën të mbështetet pagesa e anëtarëve të Këshillit. Ndodhur në këto kushte nga MFE, me qëllim funksionimin e kësaj strukture, duhet të ishin marrë masat e nevojshme, për propozimin e ndryshimeve ligjore në Ligjin nr.9875, datë 14.02.2008, ose përfshirjen e Këshillit të Metrologjisë, në VKM nr. 656, datë 31.10.2018<sup>61</sup>, në të cilën përcaktohet masa e shpërblimit për rreth 70 lloje organesh kolegjiale.

### **Konkluzione**

**19.** Mungesa e marrjes së masave nga MFE për vënien në funksion të Këshillit të Metrologjisë, në gjykimin e grupit të auditimit, tregon mungesë bashkëpunimi, papërgjegjshmëri në kryerjen e detyrave të saj, si institucioni politikbërës, por edhe në mbështetjen për zhvillimin e metrologjisë.

### **Rekomandime**

**19.1.** MFE në bashkëpunim me DPM të marrin masat e nevojshme, për ngritjen dhe funksionimin normal të Këshillit të Metrologjisë.

**Menjëherë**

## **5. PËRMBLEDHJA**

Auditimi i Performancës me temë òPerformanca e DPM, është kryer në bazë të shkresës njoftuese nr.612, datë 27.05.2021 për fillimin e Projektit të Auditimit, si dhe Programit të Auditimit nr. 612/2, datë 29.07.2021, miratuar nga Kryetari i KLSH-së. Nisur nga rëndësia ekonomike-sociale e metrologjisë, e cila është pothuajse në çdo veprim të jetës së përditshme të njeriut, KLSH e gjykoj të nevojshme kryerjen e një auditimi performance pranë institucioneve përgjegjëse për zhvillimin e saj. Sa më sipër, subjektet që u përfshin në këtë auditim ishin, Ministria e Financës dhe Ekonomisë, si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë.

Gjatë fazës studimore, me qëllim identifikimin sa më qartë të funksioneve dhe veprimeve, të secilit prej subjekteve të mësipërme, për zhvillimin e sistemit të metrologjisë, grupi i auditimit zhvilloi bashkëbisedime me punonjës të nivelit të ndryshëm në hierarkinë institucionale, si dhe bëri kërkesa për dokumentacion, të nivelit strategjik, ligjor dhe operacional. Në përfundim të kësaj faze, pas konsultimit të dokumentacionit, mbi veprimtarinë e secilit prej subjekteve, u arrit në përgatitjen e programit të auditimit. Në programin auditues, u ndërtua piramida e pyetjeve të auditimit, e cila pati si fokus, vlerësimin e efektivitetit dhe eficiencës së masave të marra (duke u fokusuar në vlerësimin e kuadrit rregullator, strategjitë, burimeve njerëzore dhe financiare, bashkëpunimin

<sup>60</sup> Ministria e Financës dhe Ekonomisë, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit.

<sup>61</sup> Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njëjësive të qeverisjes qendrore.



ndërinstitucional) për zhvillimin e sistemit të metrologjisë, për periudhën 2018-2020.

Me qëllim dhënien e përgjigjes pyetjes kryesore, grupi i auditimit, e detajoi atë në disa nënpyetje, të cilat u fokusuan në realizimin e objektivave strategjik të këtij sektori, plotësimin dhe përafrimin me praktikën më të mira të kuadrit rregullator, mbështetjen financiare, bashkëpunimin ndërinstitucional, funksionimin e strukturave përgjegjëse, etj. Përgjatë fazës së terrenit të auditimit, për grumbullimin e dokumentacionit u hartuan disa intervista drejtuar Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë, si dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë.

Sa më sipër, rezultoi se, megjithëse prej vitesh është ndërtuar sistemi kombëtar i metrologjisë, efektiviteti i kërkuar prej tij, ende nuk rezulton të jetë në nivelin e duhur. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, përgjatë periudhës 2018-2020, ka shfaqur mungesë efieciencie dhe efektiviteti, në ushtrimin e detyrave, me qëllim zhvillimin dhe fuqizimin e sistemit të metrologjisë. Nga ana tjetër, me gjithë përpjekjet e bëra nuk është arritur niveli i kërkuar i përgatitjes teknike profesionale të stafit të strukturave verifikuese të metrologjisë dhe i bashkëpunimit të tyre me institucionet që janë pjesë e infrastrukturës së cilësisë.

Gjithashtu ndërmarrja e disa nismave ligjore nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë, në periudhë afatgjatë rrezikojnë të ndikojnë negativisht në cilësinë e shërbimit metrologjik të ofruar, por edhe në garantimin e mbrotjes së konsumatorit nga abuzimet me peshën dhe matjen.

Me qëllim zhvillimin, si dhe mbrojtjen e plotë të konsumatorit, është i nevojshëm konsolidimi i këtij sistemi në fushat ekzistuese dhe zgjerimi me fusha të reja veçanërisht në atë të shëndetësisë, të cilësisë së produkteve ushqimore, të sigurimit teknik, etj.

Në përfundim të punës audituese, disa nga konkluzionet më të rëndësishme që u arritën në këtë auditim, janë si më poshtë vijon:

- Mungesa e hartimit dhe miratimit të akteve nënligjore të mësipërme, në gjykimin e grupit të auditimit, ka rezultuar në mungesë të përafrimit të plotë, të legjislacionit shqiptar për metrologjinë me legjislacionin e BE, e për rrjedhojë në mbështetjen e plotë të tregtisë ndërkombëtare për instrumentet ligjërish të kontrolluar dhe parapaketimet, si dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve metrologjike për konsumatorët.

- Publikimi në faqen zyrtare të MFE, të Projektligjit të Metrologjisë për konsultim publik, variant, i cili nuk lidhet me Ligjin e miratuar nr.126/2020, kryesisht në heqjen e disa prej kompetencave të DPM-së, cituar më sipër, si dhe mungesa e kryerjes së vlerësimit ekonomik-financiar të Ligjit nr.126/2020 òPër metrologjinë, në gjykimin e grupit të auditimit tregon mungesë transparence të MFE-së përballë palëve të interesit, si dhe në periudhë afatgjatë mund të ndikojë negativisht në të ardhurat e buxhetit të shtetit.

- Përcaktimet e mësipërme të Ligjit nr.126/2020 òPër Metrologjinë, në gjykimin e grupit të auditimit, bazuar edhe në praktikën e mira mund të pengojnë lëvizjen e lirë të mallrave, të cenojnë cilësinë dhe transparencën e shërbimit të verifikimit të shpërndarësve të karburantit, ofruar prej koncesionarit, si dhe të ndikojnë negativisht në mbrojtjen e konsumatorit nga abuzimet me peshën dhe matjet. Theksojmë se, përjashtimi që i bëhet institucionit publik në ushtrimin e plotë të funksionit të inspektimit, psh., në rastin e karburanteve dhe gazit të lëngshëm, praktikisht i bën të pakontrollueshme instrumentet matës, përdoruesit e tyre dhe cilësinë e shërbimit të verifikimit që ofrohet nga koncesionari, duke rritur mundësinë e dëmtimit të interesave të konsumatorit.

- Për më tepër që sipas shkronjës òcò të pikës 3 në nenin 48, inspektorit të ISHMT, i është hequr e drejta e bllokimit të instrumentit matës (kur ky instrument verifikohet nga koncesionari/subjekti i autorizuar). Kjo do të thotë se, të drejtën e bllokimit òpra marrjen e masës administrative të instrumentit matës, ligji iò ka njohur koncesionarit/subjektit të autorizuar, i cili më përpara ka kryer shërbimin e verifikimit të këtij instrumenti. Ndërkohë theksojmë se, subjektet e autorizuar nga DPM, vetë DPM dhe koncesionari, **kanë të drejtë vetëm verifikimin metrologjik të instrumentit, jo edhe marrjen e masave administrative.** Në këto kushte, në gjykimin e grupit të auditimit, ligjvënësi nuk mund të jetë i sigurt, që koncesionari/subjekti i autorizuar do të bllokojë një instrument, të cilin më përpara e ka verifikuar vetë ai.

- Dhënia me koncesion e shërbimit të verifikimit të shpërndarësve të karburantit dhe gazit të lëngshëm, në kushtet e mungesës së vlerësimit real nga MFE, të situatës financiare, teknike,



organizative dhe cilësisë së shërbimit metrologjik të ofruar prej disa vitesh nga DPM, ka ndikuar negativisht në efektivitetin dhe eficiencën e investimeve në vlerën prej 63,975,994 lekë, të kryera në DPM, për blerjen e autolaboratorëve dhe pajisjeve të nevojshme për kryerjen e këtij shërbimi. Gjithashtu dhënia me koncesion e shërbimit të verifikimit të shpërndarsve të karburantit dhe gazit të lëngshëm, **do të ndikojë direkt në reduktimin e të ardhurave të buxhetit të shtetit.**

- Gjithashtu në lidhje me përcaktimin e frekuencës e verifikimit metrologjik, në kushtet e mungesës së një metodologjie të saktë dhe shkencore për llogaritjen e riskut të instrumenteve matës, për saktësinë e tyre të matjes, mund të bëhet shkak për arbitraritet dhe shkelje të konkurrencës së lirë nga operatori i koncesionit, si dhe rritje të kostos së shërbimit të verifikimit të shpërndarësve të karburantit dhe gazit të lëngshëm.

- Mungesa e specialistëve metrolog në njësinë e monitorimit të shërbimit metrologjik të ofruar prej subjektit privat, si dhe hartimi i raporteve të monitorimit mbështetur mbi raportet e vetë koncesionarit, kanë bërë që informacioni për zbatimin e kontratës dhe cilësinë e shërbimit të mos sigurojë një panoramë të plotë dhe të saktë të situatës, çka mund të sjellë vendimmarrje të gabuar në të ardhmen nga Autoriteti Kontraktor - MFE, në lidhje me zbatimin e kontratës nga subjekti privat.

- Mungesa e hartimit të kriterëve dhe rregullave për përcaktimin e zonës, në të cilën do të ushtrojë veprimtari të metrologjisë ligjore subjekti privat i autorizuar prej DPM-së (që do të thotë se një subjekt i autorizuar për kryerjen e shërbimeve metrologjike mund të ushtrojë aktivitet edhe në gjithë territorin e Shqipërisë), në gjykimin e grupit të auditimit vështirëson mundësinë e hyrjes në treg të subjekteve të tjera, duke ndikuar negativisht në konkurrencën në treg dhe në cilësinë e shërbimit të ofruar.

- Mungesa e realizimit plotësisht të objektivave strategjik nga DPM në bashkëpunim me MFE, si dhe e hartimit të strategjisë së posaçme për zhvillimin e metrologjisë, në gjykimin e grupit të auditimit, tregon mungesë koordinimi dhe punë të dobët, ndërmjet këtyre dy institucioneve në bashkërendimin e veprimeve dhe marrjen e masave konkrete për realizimin e objektivave strategjik, të cilët në fund synojnë zhvillimin e sistemit të metrologjisë, si dhe mbrojtjen e konsumatorit.

- Mungesa e ngritjes së disa laboratorëve, deklarimit në BIPM të fushave të tjera të matjes (termometrisë dhe gjatësisë), si dhe e përfshirjes së disa instrumenteve të tjerë në procesin e verifikimit metrologjik, në gjykimin e grupit të auditimit, ndikojnë negativisht në vendosjen e kohës së saktë në telekomunikacion, televizione, transport, etj., si dhe saktësinë e matjes së instrumenteve matës në fushën e energjetikës, industrisë nxjerrëse dhe përpunuese të mineraleve, hidrokarbureve, të shëndetësisë dhe për rrjedhojë në mbrojtjen e konsumatorit.

- Mungesa e rekrutimit të burimeve njerëzore në DML, sipas kërkesave të përcaktuara për metrologun e autorizuar, si dhe trajnimeve për zhvillimin e vazhdueshëm të njohurive të tyre, në gjykimin e grupit të auditimit, ndikon negativisht në cilësinë dhe saktësinë e shërbimit të verifikimit të instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar.

- Mungesa e marrjes së masave, për vënien në funksion të pajisjeve laboratorike në Sektorët Rajonal të DPM, në gjykimin e grupit të auditimit, ka sjellë që investimet e kryera për këto pajisje në vlerën 12,547 mijë lekë, të mos jenë eficiente dhe efektive, duke mos i shërbyer qëllimit, për të cilin ato janë shpenzuar.

- Mungesa e verifikimit metrologjik të matësve të ujit, nuk realizon qëllimin e Ligjit të metrologjisë, për mbrojtjen e konsumatorit nga abuzimet me peshën dhe matjet, si dhe në gjykimin e grupit të auditimit, mund të rriten mundësitë e faturimit jo real të konsumit të ujit.

- Mungesa e bashkëpunimit ndërinstucional të DPM, për shkak të saj apo të institucioneve të sipërpërmendura, në gjykimin e grupit të auditimit, ndikon negativisht në veprimtarinë e institucionit, mbulimin me verifikim metrologjik të disa instrumenteve matës, dhe në përfundim në mbrojtjen e konsumatorit.

- Mungesa e marrjes së masave nga MFE për vënien në funksion të Këshillit të Metrologjisë, në gjykimin e grupit të auditimit, tregon mungesë bashkëpunimi, papërgjegjshmëri në kryerjen e detyrave të saj, si institucioni politikbërës, por edhe në mbështetjen për zhvillimin e metrologjisë.

Grupi i auditimit me qëllim përmirësimin e situatës në të ardhmen rekomandoi marrjen e masave



për plotësimin e kuadrit rregullator, hartimin e strategjisë së posaçme për metrologjinë, ndryshimet ligjore në Ligjin nr.126/2020 ËPër metrologjinë, ndryshimin e përcaktimeve të bëra në kontratën e dhënies me koncesion të shërbimit të verifikimit metrologjik, ngritjen dhe funksionimin e Këshillit të Metrologjisë, etj.

## 6.SHTOJCAT/ANEKSE

**Pretendimi i subjektit:** Me shkresën nr.612/7 prot., datë 28.12.2021 nga MFE janë paraqitur observacione mbi Projekt Raportin e Auditimit.

**Rekomandimi 1.1:** *MFE dhe DPM të marrin masat e nevojshme për hartimin dhe miratimin e projektvendimit të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores "Per etalonet kombëtarë të matjes"; "Për njesitë e tjera të matjes jashtë sistemit SI"; "Per miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe metrologjike për instrumentet matëse ligjërish të kontrolluara"; si dhe ndryshimeve në Udhëzimin e Ministrit të MZHETTS nr.1897/3, datë 03.08.2016 "Për miratimin e rregullores "Për kërkesat dhe procedurat e miratimit, regjistrimit dhe monitorimit të sistemit të kontrollit sasior të prodhuesve të parapaketimeve me shenjë konformiteti", me qëllim përafrimin e legjislacionit shqiptar të metrologjisë me Guidën nr. 1 versioni 2 (01/2015) EURAMET, Direktivën nr. 2009/3/KE, Direktivën nr. 2014/32/KE, OIML G21 të legjislacionit të BE-së.*

*-Sipas observacioneve të MFE*

Në vijim jepet informacioni mbi statusin e projektakteve të cituar në rekomandim, që propozohen nga DPM:

Projektvendimi ËPër përcaktimin e kërkesave dhe kushteve që duhet të plotësojë një standard matjeje për tË deklaruar etalon kombëtar matjeje ò Është përgatitur draft vendimi i cili është në proces bashkërendimi me ministritë.

Projektvendimi ËPër njesitë e matjes - Paketa e dërgimit për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Ministrave, është ngarkuar në sistemin e-akte në datën 28.10.2021

Ndryshimet në Udhëzimin e Ministrit të MZHETTS nr.1897/3, datë 03.08.2016 ËPër miratimin e rregullores ËPër kërkesat dhe procedurat e miratimit, regjistrimit dhe monitorimit të sistemit të kontrollit sasior të prodhuesve të parapaketimeve me shenjë konformiteti ò **Akt i miratuar, Udhëzim nr. 1, datë 15.01.2021** ËPër disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr. 1897/3, datë 03.08.2016 ËPër miratimin e rregullores ËPër kërkesat dhe procedurat e miratimit, regjistrimit dhe monitorimit të sistemit të kontrollit sasior të prodhuesve të parapaketimeve me shenjë konformiteti, i ndryshuar ò

**Rekomandimi 2.1:** *MFE të marrë masat e nevojshme për kryerjen e analizës ekonomike-financiare të Ligjit nr.126/2020 "Për metrologjinë", me qëllim dokumentimin e plotë të procedurës së hartimit dhe miratimit të këtij ligji.*

*-Sipas observacioneve të MFE*

Ligji i metrologjisë, me nr.126/2020, n asnjë moment n nenet e tij nuk jep shërbime apo ligjëron asnjë kontratë koncesioni apo t fiksoj vet m nj form juridike p r shërbimin e verifikimit t instrumenteve matës t hidrokarbureve dhe gazit t l ngsh m. N çdo rast p rzgjedhja e form s s kryerjes s sh rbimit b het n zbatim t legjislacionit p rkat s n var si t llojit t procedur s s ndjekur nga institucioni shtet ror. Sqarojmë se, shërbimi i verifikimit të instrumentave matës për hidrokarburet dhe gazin është dhënë me koncesion në datën 21.08.2019, përpara miratimit të ligjit në fuqi, ndërkaq ligji i metrologjisë nr.126/2020 është miratuar në datën 15.10.2020. Analiza financiare dhe ekonomike për këtë shërbim është bërë në momentin kur Autoriteti Kontraktor ka marrë vendimin për dhënien me koncesion të këtij shërbimi, referuar dispozitave të legjislacionit në fuqi për koncesionet/PPP. Për këtë arsye, shihet e panevojshme hartimi i një analize tjetër ekonomike finaciare mbi shërbimin e verifikimit të instrumentave matës të naftës dhe gazit, pasi në konstatimet e bëra në projekt raportin e auditimit të performancës i referohet këtij shërbimi.

**Rekomandimi 4.1:** *Me qëllim mbrojtjen e konsumatorit nga abuzimet me peshën dhe matjen, si dhe përafrimin e Ligjit të metrologjisë me direktivat e BE-së, MFE të marrë masat e nevojshme si dhe*



vlerësimin rast pas rasti të gjetjeve më sipër, me qëllim propozimin në Këshillin e Ministrave të ndryshimeve ligjore në Ligjin nr.126/2020 "Për metrologjinë".

**Rekomandimi 5.1:** *MFE të marrë masat e nevojshme që pas propozimit në Këshillin e Ministrave të ndryshimeve ligjore me Ligjin nr.126/2020 "Për metrologjinë", të ngrëjë një grup pune për të analizuar mbivendosjet e detyrave të Koncesionarit me Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, me qëllim eliminimin e tyre.*

*-Sipas observacioneve të MFE*

Ligji nr.126/2020 ËPër metrologjinë është miratuar në 15.10.2020. Aktet nënligjore në zbatim të tij janë drejt miratimit, sipas propozimit të DPM dhe në koordinim nga MFE. Ka kaluar vetëm një vit kalendarik nga miratimi i këtij ligji. Institucionet të cilat e hartojnë, implementojnë dhe vleresojnë ligjin, duhet të kenë kohën e mjaftueshme në dispozicion për të kryer këtë vlerësim sipas sipas fushës së përgjegjësisë duke parë se si ligji i metrologjisë nr.126/2020 do të ketë impakt në treg. Për këtë arsye, rivlerësimi i ligjit në një periudhë kaq të shkurtër është i pamjaftueshëm për të dalë në një vlerësim të qenësishëm.

Lidhur me ndryshimet ligjore të propozuara në nenin 18 ju informojmë se, këto formulime sipas pikave të këtij neni të referuara nga draft Raport janë bërë nga komisioni parlamentar i veprimtarisë prodhuese.

Lidhur me ndryshimet e tjera ligjore të propozuara në draft Raport, jepen në observacionet më poshtë të strukturave përkatëse.

*-Sipas observacioneve të Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT):*

Gjetjet e raportit të auditimit, seksioni i tretë ËNdikimet e përmbajtjes së kontratës koncesionare në efikasitetin e shërbimit metrologjik ku konkludon se ËShoqërisë koncesionare i është dhënë e drejta e inspektimit dhe marrjes së masës administrative të bllokimit të instrumenteve matës, ndërkohë që ajo është shpallur fituese që në krye të herës, vetëm për ofrimin e shërbimit të verifikimit të instrumenteve matës, ndërsa funksionin e inspektimit metrologjik, e kryen Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut. Këto përcaktime bien në kundërshtim me pikën 1 në nenin 7 të Ligjit nr. 126/2020 ËPër metrologjinë, si dhe Kreun II, IV, dhe V në Ligjin nr.10433, datë 16.6.2011 ËPër inspektimin në Republikën e Shqipërisë, si dhe konkluzionet sipas pikës nr.5 ËOfrimi i mundësisë subjektit privat që tashmë kryhen shërbimin e verifikimit metrologjik, që të kryejë edhe inspektimin/bllokimin e instrumenteve matës, në gjykimin e grupit të auditimit mund të krijojë hapësira për konflikt interesi, duke ndikuar negativisht në transparencën, trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues të subjekteve, që tregtojnë karburant, si dhe për rrjedhojë, uljen e cilësisë së shërbimit e mbrojtjen e konsumatorit dhe nr. 6 ËGjithashtu në lidhje me përcaktimin e frekuencës e verifikimit metrologjik, në kushtet e mungesës së një metodologjie të saktë dhe shkencore për llogaritjen e riskut të instrumenteve matës, për saktësinë e tyre të matjes, mund të bëhet shkak për arbitraritet dhe shkelje të konkurrencës së lirë nga operatori i koncesionit, si dhe rritje të kostos së shërbimit të verifikimit të shpërndarësve të karburantit dhe gazit të lëngshëm, nuk kanë mbivendosje të kontratës koncesionare me fushën e veprimit të ISHMT, **sepse mbyllja e instrumentave matëse në këtë fushë nga koncesionari kryhet si rrjedhojë e zbatimit të procedurës së verifikimit miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit si dhe udhëzimit nr. 2, datë 08.02.2013 "Për tarifatat dhe pagesat e shërbimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë. Në këtë kontekst mbyllja shoqërohet me faturë tatimore, si rrjedhojë ky veprim konsiderohet shërbim dhe jo masë administrative sipas ligjit nr.10433 "Për Inspektimin në RSH".**

Për këtë arsye, rekomandimi "MFE të marrë masat e nevojshme që pas propozimit në Këshillin e Ministrave të ndryshimeve ligjore me Ligjin nr.126/2020 "Për metrologjinë", të ngrëjë një grup pune për të analizuar mbivendosjet e detyrave të Koncesionarit me Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, me qëllim eliminimin e tyre", nuk pranohet nga ISHMT.

*-Sipas observacioneve të Drejtorisë së Koncesioneve/MFE:* Lidhur me Seksionin III ËNdikimet e përmbajtjes së kontratës koncesionare në efikasitetin e shërbimit metrologjik sqarojmë se:

Për sa i përket gjetjes nr.8 ku keni konstatuar se: "Shoqërisë koncesionare i është dhënë e drejta e inspektimit dhe marrjes së masës administrative të bllokimit të instrumenteve matës, ndërkohë që ajo është shpallur fituese që në krye të herës, vetëm për ofrimin e shërbimit të verifikimit të instrumentave matës, ndërsa funksionin e inspektimit metrologjik, e kryen Inspektoriati Shtetëror i



Mbikëqyrjes së Tregut. Këto përcaktime bien në kundërshtim me pikën 1 në nenin 7 të Ligjit nr.126/2020 "Për metrologjinë", si dhe kreun II, IV dhe V në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" dhe rekomandimit tuaj se: "MFE duhet të marrë masat e nevojshme që pas propozimit në Këshillin e Ministrave të ndryshimeve ligjore në Ligjin nr.126/2020 "Për metrologjinë", të ngrejë një grup pune për të analizuar mbivendosjet e detyrave të Koncesionarit me ISHMT, me qëllim eliminimin e tyre." shprehemi se:

Në kontratën e koncesionit nr.15326 datë 21.08.2019 në nenin 3 të saj është i përcaktuar qartë objekti i saj që është kryerja nga Koncesionari/Shoqëria koncesionare e shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm të naftës në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe realizimi i objektit të koncesionit do të kryhet në përputhje me kushtet e përcaktuara në kontratë, shtojcat e saj, si dhe legjislacionin shqiptar në fuqi.

Gjithashtu në nenin 21.1.7 dhe 21.1.8 të kësaj kontrate është parashikuar se: "Shoqëria koncesionare ka të drejtën e bllokimit të menjëhershëm të instrumentit matës në rastet e mosplotësimit të kërkesave teknike dhe metrologjike ligjore dhe/ose vendosjen e një shiriti dhe/ose shenje tjetër dalluese, me efekt njoftimin e qytetarëve, që shpërdaresi përkatës pas verifikimit ka rezultuar me probleme dhe që nuk duhet të përdoret më nga Subjekti i Detyruar, deri në heqjen e shiritit dhe/ose shenjave të tjera dalluese nga Koncesionari/Shoqëria Koncesionare, që do të bëhet pas riparimit të shpërdaresit dhe kryerjes së verifikimit pas riparimit. Në rastet kur nga verifikimi rezulton që instrumenti matës ligjor i kontrollueshem nuk plotëson kërkesat teknike/metrologjike, Koncesionari/Shoqëria Koncesionare njofton Autoritetin Kontraktues."

Referuar sa më sipër, është e qartë se sipas kontratës është përcaktuar se kryerja e bllokimit të instrumentit matës në rast të mosplotësimit të kërkesave teknike metrologjike është një e drejtë që i është dhënë koncesionarit, e cila është plotësisht në përputhje me parashikimet e ligjit nr.126/2020 "Për metrologjinë" ku në nenin 48 pika 2 përcaktohet se: "Në rastet kur kryerja e shërbimeve, objekt i këtij ligji, realizohet ekskluzivisht nga persona juridikë privatë, të autorizuar me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi, inspektimi metrologjik përfshin vetëm ekzaminimin fizik dhe dokumentar të produkteve apo proceseve objekt të këtij ligji. Vetëm në raste përjashtimore dhe gjithmonë me vendim gjykatë, inspektimi metrologjik mund të përfshijë edhe ekzaminimin laboratorik për të realizuar kontrollin e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni". Kontrata e koncesionit në asnjë pikë të saj nuk i ka dhënë të drejtën koncesionarit për marrjen e masave administrative të cilat ligji ua ka ngarkuar institucioneve të tjera ligjzbatuese (ISHMT).

Konkretisht po neni 48 pika 3 e ligjit përcakton se: "Në rastet kur inspektori vëren shkelje të këtij ligji, të çdo kontrate dhe/ose instrumenti, i cili ka fuqinë zbatuese të ligjit dhe ka si objekt kryerjen e shërbimeve të përcaktuara në këtë ligj, dhe të rregulloreve të miratuara ose informohet për çdo shkelje të tij nga subjekte të autorizuar për të kryer veprimtari metrologjike në një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi, merr vendim aty për aty, por në çdo rast jo më vonë se 7 ditë nga konstatimi i shkeljes apo marrjes së informacionit nga subjektet e autorizuar prej ligjit dhe, sipas rastit, vendos një ose disa nga dënimet e mëposhtme:

- a) dënim me gjobë, që vendoset për të gjitha shkeljet e konstatuara në përputhje me nenin 54 të këtij ligji;
- b) pezullim të kryerjes së veprimtarive që janë në kundërshtim me këtë ligj ose me rregullat e nxjerra në zbatim të tij;
- c) bllokim të instrumentit matës në rast moskonformiteti, përveç rasteve të kryerjes së verifikimit nëpërmjet inspektimit nga persona juridikë privatë, të autorizuar me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi;
- ç) urdhërim të korrigjimit të parregullsive dhe mangësive të konstatuara brenda një periudhe kohe të specifikuar;
- d) ndalimin e vendosjes në treg apo heqjen nga tregu të instrumenteve matëse ligjorisht të kontrolluara, parapaketimeve dhe shisheve enë matëse.

Pra, kryerja e veprimit të bllokimit e shoqërisë koncesionare konsiston në përmbushjen e të drejtave dhe detyrimeve në zbatim të përcaktimeve të kontratës së koncesionit në harmoni të plotë me parashikimet e ligjit nr. 126/2020 dhe detyrimeve të kontratës së koncesionare. Në vijim të veprimit të



bllokimit, shoqëria koncesionare në zbatim të kontratës njofton Autoritetin Kontraktues në rastet kur nga verifikimi rezulton që instrumenti matës ligjor i kontrollueshëm nuk plotëson kërkesat teknike/metrologjike.

Rregullimet e mëtejshme ligjore lidhur me sanksionet për veprimet e kryera nga subjektet në kundërshtim me ligjin, janë përcaktuar në mënyrë eksplicite në nenin 54 ligji nr 126/2020.

Në këtë kuadër, ju sqarojmë se vetë pika 1 e nenit të sipërcituar e cila shpreh se: *“Kur inspektorët metrologë vërtetojnë se subjekti ka shkëlur dispozitat e këtij ligji, nëpërmjet konstatimit të drejtpërdrejtë ose raportimit të personave juridikë privatë, të autorizuar në një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi për të ofruar shërbime sipas këtij ligji, kanë të drejtë të vendosin gjobë sipas pikave 2 e 3 të këtij neni, krahas dënimeve të tjera, të zbatueshme sipas këtij ligji, dhe të kërkojnë nga subjekti marrjen e masave për ndreqjen e shkëljes, duke vendosur afat për realizimin e ndreqjes”*, tregon qartë që midis kontratës së koncesionit sipas të cilës shërbimi i kontrollit ligjor të instrumenteve matës i është dhënë subjektit juridik privat ËN.I.ö sh.p.k dhe ligjit nr. 126/2020 *ËPër metrologjinë*, jo vetëm që nuk ka mbivendosje detyrash dhe funksionesh por ekziston një bashkërendim dhe harmonizim i plotë në zbatimin tërësor të tyre.

Lidhur me këtë, për të provuar komunikimin zyrtar mes shoqërisë koncesionare dhe ISHMT për funksionet e inspektimit të bllokimit të pajisjeve jashtë kriterëve ligjore metrologjike, ju informojmë se:

Me anë të shkresës nr.98 datë 29.09.2021 shoqëria koncesionare i është drejtuar ISHMT dhe për dijeni MFE duke përcjellë raportim mbi subjektet të cilat kanë tejkalluar afatet ligjore të parashikuara për instrumentat matës jo në përdorim, të mbyllura me dëshirë me kërkesë të subjektit të detyruar si dhe me anë të shkresës nr.100 datë 30.09.2021 shoqëria koncesionare ka përcjellë listën e plotë të subjekteve të detyruara, duke paraqitur numrin total të instrumentave dhe përqindjen e instrumentave jo-konform për periushën 31 Mars 2020 deri në 31 Gusht 2021, duke kërkuar marrjen e masave në zbatim të legjislacionit në fuqi për trajtimin e ketyre rasteve, konkretisht marrjen masave sanksionuese dhe largimin e k tyre pajisjeve nga pikat e tregtimit të subjekteve detyruar si pajisje q nuk p rmbushin k rkesat ligjore dhe metrologjike.

**Për sa më sipër, në Raportin Përfundimtar të Auditimit, kërkojmë nga ana juaj ndryshimin e gjetjeve të konstatuara nga ju në Projekt Raportin e Auditimit bazuar në informacionin dhe të dhënat e paraqitura dhe dokumentuara nga ana jonë, për çështjet objekt i veprimtarisë së Drejtorisë së Koncesioneve në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.**

Rekomandimi 6.1: *MFE të marrë masat e nevojshme që të hartojë një manual të posaçëm për procedurat e monitorimit të zbatimit të kontratës së shërbimit metrologjik, ku pjesë e tij të jetë edhe monitorimi në terren i shërbimit të verifikimit metrologjik, sipas një analize risku.*

*Gjithashtu, të marrë masat e nevojshme, që në përbërjen e njësisë së monitorimit pranë MFE, të përfshihen specialist metrologë të DPM-së/ISHMT-së, me qëllim rritjen e efektivitetit të monitorimit, si dhe pasqyrimin e plotë dhe të saktë të shërbimit të ofruar prej subjektit privat.*

-Sipas observacioneve të Drejtorisë së Koncesioneve/MFE:

Lidhur me Seksionin IV ëNdikimi i shërbimit të verifikimit periodik dhe monitorimit të aktivitetit të koncesionaritë sqarojmë se:

Përsa i përket gjetjes nr.9 ku keni konstatuar se: *“Njësisia e monitorimit të zbatimit të kontratës nuk ka në përbërjen e saj specialist të fushës, në rastin konkret metrolog, me qëllim mbikëqyrjen nga ana teknike të shërbimit që ofrohet nga subjekti juridik privat, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 8 në Ligjin nr.126/2020 “Për metrologjinë”, dhe guidave të OIML D1 paragrafi 5.3.5 Përfshirja e sektorit privat/tregtar në metrologji Weights and Measures Program Requirements- Kërkesat e programit të peshave dhe matjeve, të NIST.”*

Shprehemi se me lidhjen e kontratës së koncesionit nr.15326 prot., datë 21.08.2019, Ministria e Financave dhe Ekonomisë bazuar në përcaktimet e nenit 13.2.1 të kësaj kontrate ka vijuar me hapat për ngritjen e Njësisë së Zbatimit të Projektit të kontratës së koncesionit duke ju k rkuar k tyre institucioneve kompetente dhe teknike që mbulojnë fushën e metrologjisë dërgimin e përfaqësuesve të tyre sipas profileve p rkat se profesionale për të qenë pjesë e kësaj structure monitorimi. Këto institucione në vlerësimin e tyre kanë dërguar emrat e përfaqësuesve të tyre dhe mbi bazën e tyre nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me anë të Urdhrit nr.358 datë 08.10.2019 është ngritur



Njësia e Zbatimit të Projektit e cila ka në përbërjen e saj përfaqësues nga Drejtoria e Koncesioneve në MFE, Inspektoriati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut si dhe Agjencia për Trajtimin e Koncesioneve si institucion i specializuar në fushën e koncesioneve.

Lidhur me rekomandimin tuaj për këtë gjetje, që në përbërjen e NJZP duhet të përfshihen specialistë metrologë të DPM/ISHMT, me qëllim rritjen e efektivitetit të monitorimit, si dhe pasqyrimin e plotë dhe të saktë të shërbimit të ofruar prej subjektit privat, shprehemi të gatshëm për ta zgjeruar strukturën monitoruese të kësaj kontrate duke përfshirë edhe përfaqësues të tjerë teknikë të fushës së metrologjisë nga institucionet shtetërore të përmendura nga ana juaj.

Lidhur me gjetjen nr.10 se përgjatë periudhës Mars-Dhjetor 2020, raportet periodike të koncesionarit nuk përmbajnë informacion se sa verifikime të instrumentave matës janë kryer realisht shprehemi se shoqëria koncesionare në raportimet periodike 3-mujore të përcjella pranë MFE në bazë të detyrimeve kontraktuale dhe konkretisht në Raportin Prill- Qershor 2020 të dërguar me shkresën nr.81 datë 13.07.2020 protokolluar me tonën nr.13128 datë 13.07.2020, Raportin Korrik-Tetor 2020 të dërguar me shkresën nr.119 prot., datë 06.10.2020, protokolluar me tonën nr. 18517 datë 06.10.2020 dhe Raportin Vjetor të vitit 2020 të dërguar me shkresën nr. 6 prot., datë 11.01.2021, protokolluar me tonën nr. 808 datë 18.01.2021 ka raportuar lidhur me numrin e të gjitha verifikimeve të kryera në zbatim të objektit të kontratës së koncesionit. Më konkretisht, shoqëria koncesionare ka raportuar lidhur me numrin e verifikimeve fillestare të kryera, verifikime jashtë rradhe, verifikime periodike, kontrole të sigurimit të regjimit automatik dhe audite të instrumentave matës ligjerisht të kontrolluar.

Lidhur me gjetjen nr.11 se raportet e monitorimit të përgatitura nga njësia e monitorimit të zbatimit të kontratës për titullarin e MFE, përgjatë periudhës Mars-Dhjetor 2020 përmbajnë informacionin copy-paste/të njëjta me informacionin që pasqyrohet në raportet periodike të subjektit juridik privat, pra praktikisht nuk është bërë një monitorim i shërbimit dhe cilësisë së ofrimit të tij, sipas përcaktimeve të bëra në kontratën nr.15326 datë 21.08.2019 shprehemi se:

Nasnj rast, Njësia e Monitorimit të Zbatimit të kontratës e ngritur me Urdhrin nr.358, datë 08.10.2019, nuk ka marr apo kopjuar dokumentet e prodhuara nga shoqëria koncesionare për monitorimin e kontratës. NJZP është një strukturë e ngarkuar me mbikëqyrjen e ecurisë së zbatimit të kësaj kontrate dhe informimin e Autoritetit Kontraktues në lidhje me aspektet e ecurisë dhe zbatimit të saj. Në referencë të detyrave të saj, Njësia e Zbatimit të Projektit ka kryer një sërë detyrash lidhur me monitorimin e zbatimit të kontratës ku fillimisht në zbatim të përcaktimeve kontraktuale ka shqyrtuar Projektin e Zbatimit të dorëzuar nga shoqëria koncesionare me shkresën nr.40 datë 12.11.2019, i cili pasi është vlerësuar si në përputhje me projektin e zbatimit të dorëzuar gjatë procedurës konkurruese, është miratuar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr.21477/1 datë 17.12.2019. Në vijim, shoqëria koncesionare òN.Iò sh.p.k ka përcjellë njoftimin se ka realizuar të gjithë investimin e parashikuar duke kërkuar nga Autoriteti Kontraktues kryerjen e verifikimit të realizimit të këtij investimi në zbatim të nenit 17.1 të kontratës së koncesionit. Edhe kjo detyrë është ndjekur nga Njësia e Zbatimit të Projektit, e cila ka zhvilluar një inspektim në ambientet e shoqërisë koncesionare òN.Iò sh.p.k, për verifikimin e realizimit të investimit dhe ka shqyrtuar të gjithë dokumentacionin mbështetës të vënë në dispozicion nga ana e shoqërisë koncesionare për realizimin e planit të investimeve. Këto investime janë miratuar nga ana e Titullarit të MFE me anë të shkresës nr.1488/1 datë 11.03.2020. Pas këtij momenti shoqëria koncesionare, në datën 31.03.2020 ka filluar ofrimin e shërbimit të verifikimit të instrumentave matës së karburantit dhe gazit të lëngshëm në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Lidhur me mbikëqyrjen e përgjithshme të shërbimit kontrata e koncesionit në nenin 13.3 të saj ka parashikuar se: òAutoriteti Kontraktues, ka të drejtë të ushtrojë mbikëqyrje të përgjithshme nepermjet shqyrtimit të raporteve që dorezon Koncesionari/Shoqëria Koncesionare dhe kerkesave për sqarime mbi keto raporte, gjatë realizimit dhe vënies në punë me synim që të verifikojë se ecuria e projektit, cilësia dhe konformiteti të jenë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe të dokumentacionit të tij." Referuar këtij parashikimi kontraktual, Njësia e Zbatimit të Projektit si strukturë monitoruese e kësaj kontrate, pasi ka shqyrtuar raportet periodike e përcjella nga shoqëria koncesionare òN.Iò sh.p.k ka informuar titullarin e institucionit lidhur me ecurinë e zbatimit të kontratës.





Gjithashtu, kjo strukturë në bashkëpunim edhe me Drejtorinë e Koncesioneve pranë MFE, çdo problematikë të përcjellë nga shoqëria koncesionare lidhur me ecurinë e zbatimit të kontratës e ka adresuar për ndjekje dhe kompetencë pranë institucioneve përgjegjëse ligjzbatuese, sipas rastit duke u kërkuar marrjen e masave të menjëhershme për trajtimin e këtyre problematikave.

Konkretisht, nga ana e MFE i janë përcjellë vazhdimisht Inspektoriati Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut që nga momenti i fillimit të ofrimit të shërbimit një pjesë e konsiderueshme e problematikave të përcjella nga shoqëria koncesionare, që lidhen me fushën e veprimtarisë së këtij institucioni që në bazë të ligjit kryen funksionin e inspektimit dhe mbikëqyrjes së tregut. (shkresat nr. 18896/1 datë 22.10.2020, nr. 20344/1 datë 18.11.2020, nr. 21381/1 datë 25.11.2020, nr. 23379/1 datë 31.12.2020, nr. 13160 datë 22.07.2021, nr. 13867/1 datë 10.08.2021, nr. 15189/1 datë 22.10.2021, nr. 16565/1 datë 21.10.2021, nr. 19364/1 datë 16.11.2021, nr. 21110/1 datë 17.12.2021). Inspektoriati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut me anë të shkresës nr. 2654 prot., datë 29.10.2021, protokolluar me tonën nr. 15189/2 datë 05.11.2021 ka përcjellë informacion në lidhje me masat e marra për shqyrtimin e kërkesave të përcjella nga MFE dhe shoqëria koncesionare òN.Iò sh.p.k për problematikat e hasura gjatë zbatimit të kontratës së koncesionit *“Për shërbimin e kontrollit ligjor të Instrumentave Matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumentave shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm”*, duke bërë me dije se pjesa më e madhe e tyre ka marrë zgjidhje, duke garantuar gëzimin e qetë të koncesionit nga shoqëria koncesionare, ashtu siç parashikohet dhe në kontratën e nënshkruar mes palëve.

Lidhur me problematikat e përcjella nga shoqëria koncesionare gjatë zbatimit të kontratës përveç Inspektoriati Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, ka patur edhe një korrespondencë me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Qendrën Kombëtare të Biznesit (shkresa nr. 10385/1 datë 22.10.2021), ku në kuadër të luftës kundër informalitetit si dhe shmangies së pasojave financiare që mund ti vijnë buxhetit të shtetit si rrjedhojë e mosvjeljes së detyrimeve përkatëse nga subjektet që operojnë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, është koordinuar zhvillimi i një takimi me qëllim adresimin përfundimtar dhe gjithpërfshirës të problematikave të hasura gjatë zbatimit të kontratës së koncesionit.

Lidhur me gjetjen nr. 12 se nga Njësia e Monitorimit të Zbatimit të Kontratës nuk është përgatitur raporti vjetor i monitorimit të shërbimit të verifikimit, sipas përcaktimeve të bëra në kontratën nr. 15326, datë 21.08.2019 shprehemi se kjo gjetje nuk sht e sakt pasi referuar nenit 13.2.2:

*“Autoriteti Kontraktues, nëpërmjet NJZP-së ka të drejtë që në periudha kohore prej 24 (muajsh) muajsh gjatë gjithë periudhës së koncesionit, të monitorojë në vend objektin e koncesionit për të verifikuar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata në të gjitha fazat e zbatimit të saj. Pavarësisht këtij parashikimi, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të ushtrojë këtë monitorim në çdo kohë në rast se ka informacione të arsyeshme dhe të besueshme në lidhje me mosekzekutimin e detyrimeve të kësaj Kontrate. Çdo monitorim do të kryhet me një njoftim parapaparak prej të paktën një muaji.”*, lidhur me këtë parashikim, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka vlerësuar se pas plotësimit të periudhës 1-vjeçare të ofrimit të shërbimit nga ana e shoqërisë koncesionare, me anë të Urdhërit nr. 79 datë 29.04.2021 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë të ngrejë një grup pune *“Për monitorimin dhe kontrollin në vend lidhur me monitorimin e zbatimit të kontratës së koncesionit nr. 15326, datë 21.08.2019”*, në përbërje të të cilit ka patur edhe përfaqësues të Njesisë së Zbatimit të Projektit.

Nga ana e Grupit të Punës është kryer monitorimi dhe verifikimi në vend i objektit të koncesionit bazuar në dokumentacionin dhe informacionin e vendosur në dispozicion nga ana e shoqërisë koncesionare òN.Iò sh.p.k lidhur me përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në kontratën e koncesionit *“Për shërbimin e kontrollit ligjor të Instrumentave Matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumentave shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm*. Në përfundim të këtij inspektimi nga ana e grupit të punës është përgatitur edhe Raporti i Inspektimit ku është paraqitur informacioni lidhur me verifikimin e të gjithë aktivitetit vjetor të shoqërisë koncesionare òN.Iò sh.p.k. Gjithashtu, në raportin e verifikimit në vend nga ana e grupit të punës janë dhënë edhe rekomandimet përkatëse për shoqërinë koncesionare. Ky raport është v n n dispozicion te titullari i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Referuar sa më sipër, theksojmë se Ministria e Financave dhe Ekonomisë në rolin e Autoritetit



Kontraktues në këtë kontratë koncesioni, nëpërmjet strukturave të saj (Njesia e Zbatimit të Projektit, Drejtoria e Koncesioneve, Inspektoriat Shtetëror i Mbikqyrjes së Tregut, etj) ka ngritur një proces efektiv monitorimi lidhur me zbatimin e kontratës së koncesionit nr. 15326, datë 21.08.2021. Gjithashtu, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka qenë e angazhuar në vijimësi për zbatimin sa më efektiv të kësaj kontrate koncesioni, duke koordinuar dhe adresuar të gjitha problematikat e zbatimit të saj tek të gjitha institucionet e tjera ligjzbatuese sipas rastit duke kërkuar edhe marrjen e masave përkatëse sipas konstatimit të shkeljeve nga subjektet përkatëse.

**Për sa më sipër, në Raportin Përfundimtar të Auditimit, kërkohet nga ana juaj ndryshimin e gjetjeve të konstatuara nga ju në Projekt Raportin e Auditimit bazuar në informacionin dhe të dhënat e paraqitura dhe dokumentuara nga ana jonë, për çështjet objekt i veprimtarisë së Drejtorisë së Koncesioneve në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.**

Rekomandimi 18.1: *MFE të marrë masat e nevojshme, që të ngrëjë një grup pune, i cili të hartojë VKM përkatëse duke i'u referuar edhe direktivës së BE-së, për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve që janë pjesë e infrastrukturës së cilësisë dhe mbrojtjes së konsumatorit, si ISHMT, DPA, DPS, KMK, etj, për shkëmbimin e informacionit, zbuluar dhe hetuar shkeljet e legjislacionit përkatës, me qëllim mbrojtjen e interesave ekonomike të konsumatorëve.*

-Sipas observacioneve të MFE

Legjislacioni i brendshëm parashikon një hierarki aktesh mbi rregullimin e marrëdhënieve të komunikimit institucional ndërmjet organeve të administratës publike. Konkretisht, ligji nr. 44/2015 òKodi i procedurave administrative, në kapitullin e parimeve të përgjithshme, neni 10, parashikon òParimin e dhënies së ndihmës aktive. Neni 71 òNdihma administrative, parashikon qartësisht të drejtën e organit publik kërkuar për të marrë ndihmë juridike nga organi administrativ që disponon informacionin e kërkuar. Pika 1 e këtij neni parashikon qartësisht që: *“Organi publik, mund t'i kërkojë ndihmë adminiatrative një organi tjetër publik, për kryerjen e një apo disa veprimeve të nevojshme, në kuadër të një procedure administrative.*

Në vijim të parimit së sipërcituar, ligji nr. 90/2012 òPër organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore, neni 24 pika 1 òBashkëpunimi dhe bashkërendimi me organet e administratës shtetërore, përcakton në mënyrë eksplicite detyrimin e institucioneve të administratës shtetërore të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin dhe me institucionet e tjera shtetërore e me njësitë e qeverisjes vendore për sigurimin e të dhënave, informacioneve dhe ndihmën e nevojshme për kryerjen e funksioneve të tyre.

Në zbatim të këtij neni Këshilli i Ministrave ka miratuar VKM nr. 867/2014 òPër procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore, objekt i të cilit është rregullimi i mënyrës së bashkëpunimit nëpërmjet kërkimit të të dhënave, informacionit, ndihmës së nevojshme, ngritjes së grupeve të përbashkëta të punës për hartimin e strategjive, politikave, akteve dhe krijimit të njësisve të përbashkëta për të kryer detyra administrative ndërmjet institucioneve të administratës shtetërore me qëllim mirëfunksionimin e aparatit dhe veprimtarisë shtetërore, si edhe realizimin e detyrave. Ky akt në përputhje dhe me parimin e efektivitetit dhe efikasitetit parashikon dhe afatet procedurale për dhënien e informacionit dhe kthimin e përgjigjeve dhe detyrimin për marrjen e masave disiplinore ndaj nëpunësve të cilët nuk zbatojnë këtë detyrim.

Për pasojë, për sa kohë, legjislacioni i brendshëm rregullon jo vetëm në parim, por dhe në procedurë rrethanat dhe situatat e krijuara për dhënien e ndihmës juridike, marrjen e informacionit dhe të dhënave gjatë procedimit administrativ, kërkesa për rregullim me akt të veçantë për shkëmbimin e informacionit ndërmjet strukturave të institucioneve që mbulojnë infrastrukturën e cilësisë është e ezauruar.

Rregullorja 2006/2004/BE e referuar në rekomandimin 18.1 të projekt raportit të auditimit, është rregullore që Bashkimi Europian e ka shfuqizuar dhe nuk është më në fuqi (Regulation 2006/2004 is no longer in force, Date of end of validity: 16/01/2020; Repealed by 32017R2394). Rregullorja 2006/2004/BE së bashku me Vendimin e Komisionit 2007/76/EC, janë zëvendësuar me Rregulloren 2017/2394/BE mbi bashkëpunimin administrativ, e parashikuar në VKM nr. 550 datë 29.09.2021 (pjesë e CEFTA për tregtinë elektronike, për ndryshimet e vitit 2024) òMiratimi në parim i projektvendimit të Komitetit të Përbashkët të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qëndrore (CEFTA) òPër lehtësimin e tregtisë elektronike dhe ku bën pjesë dhe kjo rregullore.



Kjo rregullore nuk do të impaktojë vetëm institucionet e infrastrukturës së cilësisë, por gjithë institucionet në RSH që kanë rol në çështjet e mbrojtjes së konsumatorit, në përputhje me ligjin nr. 9902, dt.17.04.2008 ðPër mbrojtjen e konsumatorëve, i ndryshuar.

Rekomandimi 19.2: MFE në bashkëpunim me DPM të marrin masat e nevojshme, për ngritjen dhe funksionimin normal të Këshillit të Metrologjisë.

-Sipas observacioneve të MFE

DPM ka propozuar për miratim projektvendimin ðPër përbërjen, organizimin, funksionimin dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Metrologjisë, në zbatim të pikës 2, të nenit 10 të ligjit nr. 126, datë 15.10.2020 ðPër Metrologjinë. Aktualisht, projektvendimi është në proces bashkërendimi me ministritë.

**Qëndrimi i Audituesve Shtetëror të KLSH-së:** Lidhur me observacionet e MFE për gjetjet e mësipërme, sqarojmë se:

Observacioni që lidhet me kryerjen e monitorimit vjetor është reflektuar në raportin përfundimtar të auditimit;

Observacioni që lidhet me përmbajtjen e informacionit të raporteve të monitorimit të përgatitur nga koncesionari krahasuar me raportet e monitorimit të përgatitur nga njësia e që monitoron kontratën koncesionare, është ndryshuar terminologjia e përdorur;

Observacioni që lidhet me direktivën e BE-së 2006/2004 e referuar në rekomandimin mbi hartimin e VKM për bashkëpunimin ndërinstytucional ndërmjet institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorit, është reflektuar vetëm për ndryshimin e rregullores, duke pasqyruar rregulloren e re të BE-së, e cila në thelb nuk ndryshon nga rregullorja e mëparshme.

Observacionet e tjera nuk merren në konsideratë, ku sqarojmë se:

Afati i vendosur për zbatimin e rekomandimit për kryerjen e përmirësimeve ligjore, do të thotë që brenda këtij afati të iniciohet procedura, por përfundimi dhe finalizimi i ndryshimeve ligjore mund të kërkojë më tepër kohë, pasi ky proces nuk është vetëm në kontrollin e MFE, por edhe të strukturave të tjera, komisionet parlamentare, të cilat kërkojnë kohën e tyre në shqyrtimin e ndryshimeve që do propozohen nga MFE;

Grupi i auditimit ka rekomanduar paralelisht ndryshimet në ligj dhe në kontratën koncesionare sa i përket bllokimit të shpërndarësve të karburantit dhe gazit të lëngshëm, në rastin kur ato nuk janë në konformitet. Pra nuk ka rekomanduar vetëm përmirësimin e kontratës për këtë çështje, por edhe nenin përkatës në ligjin e metrologjisë, rekomandim të cilin e kemi mbështetur edhe në Ligjin e inspektimit, pra se kush ka të drejtë të marrë masë administrative. Për më tepër që edhe procedura e verifikimit miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, që ju referoni e cila nuk ka numër, datë, por edhe udhëzimi nr. 2, datë 08.02.2013 ðPër tarifatat dhe pagesat e shërbimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, nuk prevalojnë për nga fuqia juridike në krahasim me ligjin. Gjithashtu theksojmë se në asnjë rast në udhëzimin nr.2 nuk përcaktohet se subjekti që kryhen verifikimin bën edhe bllokimin e instrumentit. Cítimi juaj se bllokimi është shërbim nuk qëndron, shërbim është vetëm verifikimi i instrumentit për të cilën koncesionari lëshon faturën tatimore.

Lidhur me rekomandimin mbi hartimin e VKM për bashkëpunimin ndërinstytucional, jemi mbështetur në Strategjinë Ndërsektoriale për Mbikëqyrjen e Tregut dhe Mbrojtjen e Konsumatorit 2014-2020. Në këtë strategji është vendosur si objektiv hartimi i VKM së mësipërme. Gjithashtu në vijim citojmë paragrafin e fundit (Kapitulli 5.8 ðNdërtimi i infrastrukturës...ð të raportit të monitorimit të strategjisë së mësipërme në muajin Qershor të vitit 2021, i cili na është vendosur në dispozicion nga MFE me shkresën nr.612/3 prot., datë 16.09.2021, si vijon:

Në ndjekje të zhvillimeve evropiane që ka pësuar ky legjislacion, produktet e parashikuara për këtë objektiv në strategji:

Hartimi dhe zbatimi i një akti nënligjor ðPër bashkëpunimin midis autoriteteve kombëtare përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e konsumatorëve, që transponon rregulloren evropiane të bashkëpunimit të mbrojtjes së konsumatorëve 2006/2004 ó CPCN (rrjetin evropian të bashkëpunimit për mbrojtjen e konsumatorëve).

Zhvillimi i infrastrukturës, krijimi i një baze të dhënash dhe një sistem komunikimi;

Aktivitete trajnuese për specialistët e strukturave zbatues dhe palë të tjera të interesuara;

Janë mbajtur në konsideratë gjatë procesit të hartimit të dy dokumenteve LGA dhe IAGA, për



kapitullin 28, në kuadër të procesit përgatitor për hyrjen në BE.

Për krijimin e rrjetit të brendshëm të komunikimit, si një bazë e rëndësishme për të ardhmen, do të shërbejë puna e bërë në përcaktimin e institucioneve përgjegjëse për çdo akt të acquis së fushës së mbrojtjes së konsumatorëve, si dhe ngritja e grupit ndërinstitucional të punës për kapitullin 28.

-Pra sa më sipër edhe vetë MFE në raportin përfundimtar të monitorimit të strategjisë, përsëri citon direktivën 2006/2004, në të cilën është mbështetur grupi i auditimit, si dhe parashikon hartimin dhe miratimin e një akti nënligjor në të ardhmen për bashkëpunim ndërmjet këtyre institucioneve.

Gjithashtu theksojmë se rregullorja e re e BE-së nr.2017/239 përsëri ka si objekt të saj bashkëpunimin ndërmjet institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorit, si dhe që në krye të herës e specifikon shprehimisht:

Rregullorja (KE) Nr. 2006/2004 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (3) **parashikon rregulla të harmonizuara dhe procedurat për të lehtësuar bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve kombëtare që janë përgjegjëse për zbatimin të ligjeve ndërkufitare për mbrojtjen e konsumatorëve.** Neni 21a i Rregullores (KE) Nr. 2006/2004 parashikon rishikimin e efektivitetin e asaj Rregulloreje dhe mekanizmat e saj operacional. Pas një shqyrtimi të tillë, Komisioni arriti në përfundimin se Rregullorja (KE) Nr. 2006/2004 nuk është e mjaftueshme për të adresuar në mënyrë efektive sfidat Tregut Dixhital.

-Është e vërtet që VKM nr. 867/2014 ËPër procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore, ka si objekt rregullimin e mënyrës së bashkëpunimit nëpërmjet kërkimit të të dhënave, informacionit, ndihmës së nevojshme, ndërmjet institucioneve të administratës shtetërore, por rekomandimi që jep KLSH në këtë rast, synon ti jap një rëndësi më të lartë dhe ta kthejë në qendër të vëmendjes mbrojtjen e konsumatorit, ku theksojmë se MFE nuk humbet nëse harton një VKM të posaçme vetëm për institucionet mbrojtjes së konsumatorit. Theksojmë se, grupi i auditimit kërkoi në qendrën e botimeve zyrtare për VKM nr.550 datë 29.09.2021, por nuk u gjend asnjë VKM me të dhënat e cituara nga ju.

**Pretendimi i subjektit:** Me shkresën nr.612/6 prot., datë 24.12.2021 nga DPM janë paraqitur observacione mbi Projekt Raportin e Auditimit.

**Drejtoria e Sigurimit të Cilësisë dhe Parapaketimeve, shprehet si më poshtë vijon:**

1. Në lidhje me gjetjen sipas pikës 1/paragrafi 5 (faqja 24) të cilësuar nga grupi i kontrollit që "DPM nuk ka marrë masat për hartimin dhe miratimin e Udhëzimit të Ministrit "Miratimin e rregullores 'Për kërkesat dhe procedurat e miratimit, regjistrimit dhe monitorimit të sistemit të kontrollit sasior të prodhuesve të parapaketimeve me shenjë konformiteti", i cili do të përafrojë pjesërisht OIML G21 Edicion 2017 (E) Guidë për përcaktimin e kërkesave për sistemin e certifikimit të parapaketimeve, i cili ka qënë i planifikuar të miratohej në vitin 2020, referuar Planit Kombëtar të Integrimi, Evropian".

Përsa me lart, sektori i parapaketimeve dhe DPM i ka marrë masat dhe ju bën me dije që ky udhëzim është miratuar. Udhëzimi i është bërë me dije edhe grupit të auditimit (Udhëzimi nr. 1, datë 15.01.2021). Më poshtë është site i DPM-së prej të cilit ju mund të gjeni ndryshimet që ka pësuar udhëzimi për miratimin e rregullores nr.1897/3, datë 03.08.2016 ËPër kërkesat dhe procedurat e miratimit, regjistrimit dhe monitorimit të sistemit të kontrollit sasior të paketuesve të parapaketimeve me shenjë konformiteti, i ndryshuar. (<https://www.dpm.gov.al/wp-content/uploads/2021/04/Udhëzim-nr.-1897-3-date-03.08.2016.pdf>). Bashkëlidhur gjeni edhe me email që Sektori i Parapaketimeve dhe DPM i ka dërguar strukturave përkatëse në Ministri.

2. Në lidhje me gjetjet sipas pikës 36 të cilësuar nga grupi i kontrollit që "Përgjatë periudhës 2018-2020 sektori dhe laboratorit i parapaketimeve nuk kanë kryer asnjë aktivitet, si kalibrim apo miratim të sistemit të kontrollit të sasisë së subjekteve që prodhojnë parapaketime (ky aktivitet varet nga vullneti i prodhuesve, pasi nëpërmjet kërkesës së tyre bëhet miratimi i sistemit të kontrollit të sasisë dhe monitorimi në vijimësi, pra nuk është i detyrueshëm).

Përsa me lart, ju bëjme me dije se sektori i parapaketimeve nuk ka në detyrat funksionale realizimin e kalibrimeve, por përgatitjen e infrastrukturës së nevojshme për plotësimin e kërkesave të përgjithshme që përcaktohen në direktivën 76/211/EEC "Për parapektimet".



3. Në lidhje me gjetjet sipas pikës 37 të cilësuar nga grupi i kontrollit që "Nuk janë kryer matje të kontrollit statistikor në linjat e prodhimit të parapaketimeve në mbështetje të metrologëve gjatë kryerjes së shërbimit të verifikimit të dozatorëve (makina mbushëse) në kundërshtim me objektivat e vendosur në planet vjetore të punës 2018-2020, për DSCP, miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i DPM-seö.

Përsa më lart, ju bëjmë me dije se Drejtori i Përgjithshëm i DPM-së ka nxjerrë Urdhërin nr. 125, datë 09.05.2018 ëPër ngarkim me detyrë shtesë të cilin e gjeni bashkëlidhur këtij observacioni ku përcaktohet qartë detyra që kryen specialisti i sektorit të parapaketimeve në lidhje me matjet e kontrollit statistikor në linjat e prodhimit të parapaketimeve. Gjithashtu bashkëlidhur do gjeni një tabelë të gjithë kontrolleve që janë kryer nga specialisti i sektorit të parapaketimeve për periudhën 2018-2020, me emra subjektsh, adresë, nr protokoll-matje.

**Viti 2018:**

Qyteti	Nr. i subjekteve	Protokoll matje
Tiranë	46	108
Durrës	9	30
Elbasan	5	7
<b>TOTALI</b>	<b>60</b>	<b>145</b>

**Viti 2019:**

Qyteti	Nr. i subjekteve	Protokoll matje
Tiranë	97	325
Durrës	20	
Elbasan	9	
Kavaje	5	
Kruje	6	
<b>TOTALI</b>	<b>137</b>	<b>325</b>

**Viti 2020:**

Qyteti	Nr. i subjekteve	Protokoll matje
Tiranë	84	254
Durrës	11	
Elbasan	7	
Kavajë	6	
Krujë	3	
<b>TOTALI</b>	<b>111</b>	<b>254</b>

4. Në lidhje me gjetjet sipas pikës 38 të cilësuar nga grupi i kontrollit që "Nuk janë kryer trajnime nga DPM, pergjatë periudhes 2018-2020 për specialistët e sektorit të parapaketimeve, në kundërshtim me percaktimet e bëra në rregulloren e brëndshme nr.104/1, date 07.02.2014".

Përsa më sipër, ju bëjmë me dije se sektori i parapaketimeve ka në përmbajtje të tij, një përgjegjës sektori dhe dy specialiste. Për periudhën e audituar janë realizuar:

**Për vitin 2018:**

Në muajin janar, shkurt janë marrë trajnime nga ekspertja Sllovene në lidhje me:

Metrologjinë Ligjore dhe Mbikqyrjen e Tregut sipas rregulloreve WELMEC, Direktivat MID, NAWI.

Aplikimi në Slloveni në lidhje me verifikimin e instrumentave matëse, kontrollin e produkteve të parapaketuara dhe mbikqyrja e tregut.

Kërkesat bazë për produktet e parapaketuara sipas Direktivave 75/107/EEC, 76/211/EEC.

Në muajin mars dhe dhjetor është ndjekur trajnimi nga ekspertja e PTB-së znj. Irene Flouda mbi standardin e ri 17025:2017.

Në datë 10 maj 2018 është marrë pjesë në Konferencën e Metrologjisë Ligjore (NE17), për vëndet ballkanike në Beograd të Serbisë.

Në muajin korrik sektori i parapaketimeve ka kryer trajnime për metrologët e Sektorit të Shërbimeve Nr.4 Korçë, mbi zbatimin e procedurës të kontrollit sasior të parapaketimeve.

Si person kontakti i grupit WELMEC 6, është punuar dhe dërguar informacion në këtë organizatë në formë elektronike mbi Matjen e parafinës rreth djathit kaçkavallë, përkatesisht mbi menyren e deklarimit të sasisë nominale në etiketën e parafinës duke marrë informacion nga subjektet



prodhuese shqiptare.

### **Për vitin 2019:**

Në muajin nëntor në sektorin e shërbimit Nr.2 Fier, nga sektori i parapaketimeve u zhvillua trajnimi me metrologët e këtij sektori mbi instrumentet matëse në linjat e paketimit.

Sektori i parapaketimeve mori pjesë në takimin e grupit të punës WELMEC 6 (për parapaketimet) që u zhvillua në Teddington të UK në 13-14 Mars 2019, ku u njoh me draftet e rishikimit të guidave të WELMEC 6.7 òKontrolli i tregutò dhe WELMEC 6.8 òPesha e thatëò si dhe çeshtjet teknike në lidhje me deklarimin e sasisë nominale në mënyra të ndryshme për produktet që aplikojnë shenjën e konformitetit "e" te òmultipaketimeveò . Gjithashtu në këtë takim u demonstrua metoda e testimit nga PROFEL për produktin Brokoli i ngrirë, në ambientet e Zyrës për Sigurinë dhe Standardeve të Produktit.

Si person kontakti për grupin e punës të WELMEC 6 (për parapaketimet) është ndjekur korrespondenca në formë elektronike dhe është punuar për plotësimin e formularit mbi legjislacionin kombëtar të shtetit tonë mbi produktet e parapaktuara të tregtuara sipas gjatësisë, numrit, peshës së thatë për sasi të nominale nën 5 g ose ml dhe mbi 10 kg ose L.

### **Për vitin 2020:**

Në kuadër të kapitullit 1 "Levizja e Lirë e Mallrave", sektori i parapaketimeve në cilësinë e anëtareve të GNPIE, gjatë vitit 2020 kanë punuar për plotësimin/rishikimin, përditësimin/saktësimin e infomacionit për LGA për direktivat e parapaketimeve dhe ajo e shisheve enë matëse. Po kështu janë ndjekur të gjitha takimet mujore dhe trajnimet të zhvilluara online me qëllim konsolidimin dhe validimin e LGA-së.

Si person kontakti për grupin e punës të WELMEC 6 (për parapaketimet) është ndjekur korrespondenca në formë elektronike dhe është punuar për shqyrtimin e ndryshimeve të bëra nga grupi i punës të draft guides WELMEC 6.8 òVerifikimi i peshës së tharë në parapaketimeò.

### **Drejtoria e Metrologjisë Ligjore**

**1.Referuar gjetjes Nr.28,** (faqja 44) *“Procedura e faturimit të shërbimit të verifikimit të instrumentave matës kryhet sipas një rregullorje të brendshme të vitit 2010, miratuar me Urdhrin nr.373, datë 20.10.2010, të Drejtorit të Përgjithshëm të DPM në detyrë për atë periudhë, ku në zbatim të saj, në 60-70% të rasteve, është i njëjti punonjës (pra specialiti metrolog) që kryen verifikimin e instrumentit matës, lëshon faturën për pagesën e shërbimit të verifikimit, si dhe arkëton me para në dorë tarifën e shërbimit, pra jo nëpërmjet bankës. Kjo mënyrë veprimi është në kundërshtim me përcaktimin e bërë në shkronjën ”c” në pikën 4 të nenit 3 në Ligjin nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, pika 7, 61, 63 dhe 64 të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar. Theksojmë se të ardhurat që mund të gjenerojnë në ditë një metrolog nga verifikimi i instrumentave matës variojnë nga 1 000 - 20 000 lekë”.*, sipas ligjit Nr.9875, datë 14.02.2008 òPër metrologjinëò dhe ligjit aktual në fuqi Nr.126/2020, datë 15.10.2020, përcakton se shërbimet që ofrohen nga DPM, kryhen kundrejt një tarife të përcaktuar në Urdhëzimin e përbashkët Nr.2, datë 08.02.2013, i Ministrisë të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës Nr.9543/2 Prot, datë 08.02.2013 dhe Ministrisë të Financave Nr. 2386/1 Prot, datë 25.02.2013, òPër Tarifën dhe pagesat e shërbimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisëò. Në rastin e metrologëve, arkëtimi është kryer po nga këta persona, sipas Procedurës së faturimit të shërbimit të verifikimit të instrumentave matës kryhet sipas një rregullorje të brendshme të vitit 2010, miratuar me Urdhërin Nr.373, datë 20.10.2010, të Drejtorit të Përgjithshëm të DPM në detyrë për atë periudhë, si mënyra e vetme për kryerjen e procesit të shërbimit në mirëmenaxhim të kohës së punës. Përsa i përket arkëtimin me para në dorë, ky është një fenomen i hasur në shkallë të gjerë vite më parë sepse së pari, ishte e vështirë nga ana e subjekteve të kryenin pagesën e tarifës përmes rrugëve bankare( Nje pjese e madhe subjektesh jane ne zona rurale) duke sjell vonesa të zgjatura në përfundimin e procedurave të verifikimit, duke sjell problem tek metrologët për mosrakordim mes verifikimeve të kryera realisht dhe atyre të deklaruara në fund të muajit dhe duke i deklaruar çdo muaj si fatura të likujduara; së dyti, pjesa më e madhe e instrumentave matës që verifikohen nga metrologët kanë tarifa në vlera të ulëta dhe janë subjektet që e kërkojnë vet ta kryejnë pagesën me para në dorë për të shmangur komisionet bankare. Gjithnjë e më tepër kjo situatë po përmirësohet,



së pari, me hartimin e akteve nenligjore ne zbatim te ligjit te ri te metrologjise do shfuqizohet rregullorja e brendshme, janë subjektet të cilat janë ndërgjegjësuar dhe e kërkojnë që pagesa të bëhet nëpërmjet rrugëve bankare dhe kjo mundësohet edhe prej sistemeve elektronikisht, duke shmangur radhët në banka dhe vonesat për përfundimin e procedrave nga ana e metrologëve; së dyti, procesi i fiskalizimit ka ndikuar shumë në këtë drejtim duke e përmirësuar situatën dukshëm.

**2. Referuar pikës IV. Ndikimi i shërbimit të verifikimit periodik dhe monitorimit të aktivitetit të Koncesionarit,** (faqja 33), paragrafi i fundit, theksohet: *“Në referim të ligjit nr.126/2020 “Për metrologjinë” dhe më konkretisht përcaktimeve të tij në nenin 8, DPM ndër të tjera autorizon subjektet private për të kryer shërbime metrologjike dhe i monitoron ato. Praktikisht jemi në një situatë pothuajse të njëjtë, por me një ndryshim që, në gjykimin e grupit të auditimit nuk cenon thelbin e saj. Pra kemi një subjekt privat, të cilit i është dhënë me koncesion shërbimi i verifikimit metrologjik, si dhe nga ana tjetër subjektet private, të cilave i është dhënë autorizimi (formë tjetër ligjore, pra jo me koncesion) nga DPM, për të kryer shërbime të verifikimit metrologjik, ndërkohë që në rastin e parë, monitorimi kryehet nga një njësi, e cila nuk ka në përbërjen e saj specialist të fushës, ndërsa në rastin e dytë monitorimi kryhet nga metrolog, të cilët janë specialist të fushës.”*, ju bëjmë me dije se në grupin e punës i cili kryen vizitën monitoruese në subjektet e autorizuar nga DPM, ka në përbërje specialist të fushës, por jo metrolog. Anëtarët e grupit të punës janë pesë, konkretisht janë: një specialist nga DML, një specialist nga sektori i Financës, një specialist nga Sektori Juridik, një specialist nga Sektori i Menaxhimit të Cilësisë dhe një specialist nga DMSHI, që mund të jetë nga Sektori i Masës, volumeve apo elektrikut, kjo sipas natyrës së autorizimit të subjektit që do monitorohet.

**3. Referuar tabelës për realizimin e objektivave, në faqjen 36 tek elementi i tretë, Produktet e DPM, pika 4.** *“Numri i verifikimeve periodike të instrumentave ligjërish të kontrolluar 55.902 në vitin 2018, 61.492 në vitin 2019, 67.641 në vitin 2020”*, këto vlera janë të ndryshme me ato të përmendura në pikën 1. Hyrje në subjektet në auditim, pika 12. Shërbimet e kalibrimit dhe verifikimit, faqja 9, në të cilën vlerësohet se numri i instrumentave që mbulonte DPM variojnë nga 35000-45000, ndërsa në këtë pikë këto shifra që i referohen DML-së janë shumë më të larta sesa dy drejtorisë së bashku. Shifrat reale të instrumentave matës që janë verifikuar nga DML për këtë periudhë 3-vjeçare janë: 47 240 instrumenta në vitin 2018, 46 903 instrumenta në vitin 2019 dhe 33 422 në vitin 2020.

**4. Referuar Tabelës Nr.9. Numri i produkteve objektiva plan/fakt sipas viteve. Pika 4. Verifikime,** (faqja 37). Të dhënat e planeve vjetore për verifikimet nuk janë ato të cilat janë miratuar nga DPM. Sipas planeve të miratuara: për vitin 2018 janë planifikuar 45 589 verifikime (jo 55902), për vitin 2019 janë planifikuar 45 942 verifikime (jo 61 492) dhe për vitin 2020 janë planifikuar 45 957 verifikime (jo 67641).

**5. Referuar gjetjes 17,** (faqja 42), *“Në fund të vitit 2020, rezulton që të punësuarit në sektorin e Drejtorisë së Metrologjisë Ligjore (DML) që kryejnë verifikimin metrologjik, të cilët nuk kanë formimin arsimor sipas kërkesave të Urdhrit të Ministrit të METE nr.192, datë 09.03.2008 “Për përcaktimin e kriterëve të përgjithshme që duhet të përmbushë kandidati për t’u kualifikuar si “metrolog i autorizuar”, janë rreth 25 punonjës nga 53 të punësuar efektivisht, ose rreth 47%”*, DML ju bën me dije se Urdhëri i ministrit të METE nr.192, datë 09.03.2008 òPër përcaktimin e kriterëve të përgjithshme që duhet të përmbushë kandidati për t’u kualifikuar si òmetrolog i autorizuar është shfuqëzuar, si dhe përshtetimi i punës dhe kërkesat e posaçme në të cilat përfshihet edhe arsimi, në shpalljet që janë bënë në Departamentin e Administratës Publike (DAP) për punësimin e kandidatëve nuk kanë ndryshuar dhe kualifikimin e kandidatëve nëse i plotësojnë ose jo kriteret e vendosura e realizon DAP. Përsa i përket shifrës prej 47% të të punësuarve në sektorët e shërbimeve nuk përmbushin arsimin përkatës është ndikuar nga fakti që një pjesë e personelit kanë qenë në detyrë para se Institucioni të kalonte pjesë e shërbimit civil, si dhe sipas ligjit dhe Urdhërit të atëhershëm punonjësit të cilit kishin më tepër se një vit pune në pozicion kalonin automatikisht si nëpunës civil, ndërsa ata që kishin më pak se një vit duhet t’u nënshtrohen periudhës së provës deri në emërim në detyrë. Në këto kushte nuk ishte e ligjshme largimi i punonësve pas vendosjes së kriterëve për pozicionin e metrologut të autorizuar.

**6. Referuar gjetjes 22,** (faqja 43) *“Specialistët e laboratorëve të masës, që gjenden pranë*



*Sektorëve Rajonal Lezhë, Fier dhe Korçë (në Sektorin Rajonal të Tiranës, nuk ka ambiente dhe pajisjeve laboratorike) të DPM, përgjatë periudhës 2018-2020, nuk kanë kryer asnjë shërbim laboratorik”, DML ju bën me dije se në këto laboratore për periudhën 2018-2020, nuk janë kryer shërbime verifikimi në laborator, por specialistët që mbulojnë laboratorët kanë punuar në terren, në zonat më të afërta me sektorin dhe arsyeja që nuk janë kryer verifikime në laborator lidhet me faktin që subjektet e zgjedhin kryerjen e verifikimit në vendpërdorim sepse shmangin dëmtimet e mundshme gjatë transportit të tyre nga subjekti në laborator dhe sërish anasjelltas, si dhe për efekt kohe e kanë më të lehtë të verifikojnë instrumentin në vendodhjen e tyre.*

**7. Referuar Gjetjes Nr. 30,** (faqja 50), *“Nuk janë përfshirë për verifikim metrologjik periodik fusha kryesore, ku përdorimi i instrumentave ka ndikim të konsiderueshëm në mbrojtjen e konsumatorit si fusha e mjekësisë, ndotjes së mjedisit, sigurisë publike, frekuencës të telefonisë etj., në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 5 të nenit 3 dhe pikën 9 të nenit 8 në Ligjin nr.9875, datë 08.2.2018 “Për Metrologjin”, i ndryshuar”, DML ju bën me dije se zgjerimi i fushave të reja për verifikim metrologjik kërkon investime të mëdha dhe kohë për kryerjen e trajnimeve të nevojshme, që specialistët të përgatiten për kryerjen e shërbimeve në mënyrë cilësore.*

**8. Referuar ndikimit të aktivitetit të verifikimit sipas Sektorëve Rajonal të metrologjisë ligjore, paragrafi 5,** (faqja 51) *“Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i planeve vjetore të punës së DML-së të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i DPM-së, rezulton se për vitet 2019 dhe 2019 nuk është përcaktuar numri i verifikimeve periodike që planifikohen të kryhen për vitet 2018, 2019, ndryshe nga viti 2020, në të cilin është planifikuar të verifikohen 46100 instrumente matës të peshave dhe matjeve”, DML ju bën me dije se për çdo vit krijohet një projekt oplan nga secili sektor, i cili më pas shqyrtohet në DML për të bërë ndryshimet e nevojshme, më pas miratohet me Urdhër nga Drejtori i Përgjithshëm i DPM, i cili i dërgohet Sektorëve për të bërë detajimin për çdo zonë shërbimi, për çdo muaj dhe çdo 4 mujor, për treguesit Instrumente, Subjekte dhe të ardhura. Konkretisht për vitin 2018 janë planifikuar 45 589 verifikime, për vitin 2019 janë planifikuar 45 942 verifikime dhe për vitin 2020 janë planifikuar 45 957 verifikime.*

**9. Referuar ndikimit të aktivitetit të verifikimit sipas Sektorëve Rajonal të metrologjisë ligjore, paragrafi 8,** (faqja 51) *“Sipas të dhënave të DML, subjekte private, të cilët kanë në përdorim në aktivitetin e tyre instrumente matës ligjërisht të kontrolluar, për vitin 2018 janë 23180 subjekte, vitin 2019 -23139 subjekte, vitin 2020 – 21683 Subjekte. Nga të dhënat e INSTAT-it në Shqipëri në vitin 2018 kanë ushtruar aktivitet 107450 subjekte private, nga të cilat 63407 subjekte tregtare, akomodim dhe shërbime ushqimore. Në vitin 2019 kanë ushtruar aktivitet 104090 subjekte biznesi gjithsej, nga të cilat 59053 subjekte tregtare, akomodim dhe shërbime ushqimore”, DML ju bën me dije se numrit të subjekteve që i referoheni si objekt i punës sonë nuk janë praktikisht ekzistente, kjo sepse së pari, kur një subjekt është në proces mbyllje të aktivitetit ai vazhdon të qëndroj në sistem për një kohë të gjatë edhe pse nuk ushtron aktivitet, ndërsa për hapjen e tij procedurat janë shumë të shpejta, ndërsa aktivitetin subjekti mund ta filloj më vonë, arsyeja e dytë është se jo të gjitha subjektet tregtare, akomoduese dhe shërbim ushqimore përdorin instrumente matëse, kështuqë numri real i subjekteve objekt i fushës së metrologjisë ligjore është më i ulët sesa deklarohet nga INSTAT-i.*

**10. Referuar Ndikimit të aktivitetit të verifikimit sipas Sektorëve Rajonal të metrologjisë ligjore, paragrafi 9,** (faqja 51), *“Siç vërehet në grafikun e mësipërm, vendosja e objektivit strategjik në SNMKMT 2014-2020 për rritjen me 10% në vit të numrit të verifikimeve është bërë mbi një bazë reale të ekzistencës së një tregu më të gjerë në vendin tonë, që ka në përdorim instrumenta matëse”, DML ju bën me dije se vendosja e një objektivit strategjia për rritjen me 10% në vit të numrit të verifikimeve nuk është bërë në baza reale sepse së pari, edhe në rast se numri i bizneseve çdo vit vjen në rritje, kjo rritje nuk është e njëjtë edhe për subjektet të cilat janë objekti i fushës së veprimit të metologjisë ligjore, kjo gjë vërtetohet edhe nga grafiku i paraqitur, nqs në vitin 2018 kemi referuar si numër total biznesesh 107 450, nga këto 63 407 subjekte tregtare, akomodim dhe shërbim ushqimore, në vitin 2019 numri totali i bizneseve 104 090 dhe 59053 subjekte tregtare, akomodim dhe shërbim ushqimore. Së pari, nga viti 2018 në 2019 nuk kemi rritje të numrit të subjekteve, siç pretendohet sepse viti 2019 ka 3360 subjekte më pak se viti 2018, 104090-107450=-3360, pra kur numri i subjekteve ulet në total nga një vit në vitin pasardhës si*





mund të rris DML me 10% numrin e subjekteve ku do ushtroj veprimtari. Nga ana tjetër analizojmë numrin e subjekteve tregtare, akomodim dhe shërbim ushqimor, në vitin 2018 ka qenë 63 407, ndërsa në vitin 2019 59 053,  $59053-63407=-4354$ , pra kur numri i subjekteve në total nga viti 2018 në 2019 ulet me 3 360 Subjekte, numri i subjekteve tregtare, akomodim dhe shërbim ushqimore ulen me 4 354, pra ulen 994 më tepër sesa numri total. Nisur nga arsyetimi i mësipërm zbatimi i strategjisë me rritjen me 10% të numrit të verifikimeve nuk është e realizueshme.

**11. Referuar ndikimit të aktivitetit të verifikimit sipas Sektorëve Rajonal të metrologjisë ligjore, paragrafi 10,** (faqja 51), *“Në përgatitjen e itinerareve të punës, metrologët thjesht nisen nga të dhënat e verifikimeve të vitit të kaluar për zonën e caktuar, si dhe përdorin formularë të printuar paraprakisht për të zvogëluar kohën që inspektorit i duhet për plotësimin e informacionit rutinë. Këto formularë nag specialistët e DML-së plotësohen mbi bazë mujore, si pasqyra nr.6 “Mjete Matëse dhe Pronarë të Verifikuar”, pasqyra nr.7 “Instrumenta Matëse dhe Pronarë të Regjistruar”, pasqyra nr.3 “Të ardhurat dhe Arkëtimet”, Libri i shitjeve për të gjitha faturimet gjatë muajit përkatës, faturat, mandate arketimi, pullat ose ndryshe shenja dalluese e verifikimit, libreza e verifikimit të instrumentit matës”.* DML ju bën me dije se metologët në subjekt plotësojnë librezën me të dhënat e verifikimi të instrumentit matës ligjërisht të kontrolluar, shënojnë dhe vendosin pullën në instrumentin e verifikuar, plotësojnë Faturën Tatimore të Shitjes (TVSH) me të dhënat e subjektit dhe instrumentit, plotësojnë mandatin e arkëtimit, që i bashkëlidhet TVSH, si dhe plotësojnë certifikatat sipas instrumentit që verifikojnë. Ndërsa për deklarimin e punës së tyre mujore, plotësojnë Librin e shitjes, databazës, pasqyrën Nr.3, Nr.8, Pasqyrën Nr.6 dhe Pasqyrën Nr.7, të cilat deklarohen në sektor, DML dhe financën e DPM, brenda afateve të përcaktuara.

**12. Referuar gjetjes Nr.32,** (faqja 54), *“Në Drejtorinë e Metrologjisë Ligjore dhe në të gjithë sektorët rajonal, informacioni mbi punën e kryer përgatitet manualisht, si dhe nuk administrohet në mënyrë elektronike, duke mbartur risk operacional të humbjes/keqpërdorjes”.* DML ju bën me dije se pavarësisht faktit të mungesës së një regjistri elektronik, të dhënat e gjithë verifikimeve të kryera nuk kanë mundësi të humbin apo të keqpërdoren, kjo pasi çdo punonjës ruan në formë elektronike dhe fizike gjithë punën e tij, po ashtu ruhen në sektor, si dhe gjithë dokumentacionet mbi punën e çdo punonjësi dërgohen dhe ruhen në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë, pjesa që është e mundur në formë elektronike dhe fizike, ndërsa kopjet e faturave Tatimore të Shitjes, mandate arkëtimet ruhen fizikisht.

**13. Referuar gjetjes nr.33,** (faqja 54), *“DML nuk mban informacion të dokumentuar nga specialistët metrologë, mbi bazë ditore ose javore, i cili të jetë në dispozicion të përgjegjësit të sektorit ose drejtorit të DML-së, me qëllim që specialistët metrologë të regjistrojnë kohën e nisjes dhe të mbërritjes në një biznes, dhe në këtë mënyrë koha e kërkuar për të kryer verifikimin të jetë e dokumentuar, në kundërshtim me nenin 11 në Ligjin nr.10296, datë 16.09.2016 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar”.* DML ju bën me dije se përgjegjësit e sektorit dhe drejtori i DML-së, e dinë zonën e kryerjes së shërbimit të verifikimit të secilit punonjës, gjithashtu kanë edhe planet për çdo muaj të secilit prej tyre, për treguesit instrumenta, subjekte dhe të ardhura, e cila e bën më të lehtë kontrollin e punës së secilit. Nga ana tjetër si përgjegjësi i sektorit dhe drejtori i DML-së i dinë kushtet e terrenit dhe të papriturat që të sjell puna në të dhe mbi të gjitha kohën e nevojshme që duhet për kryerjen e një verifikimi sipas llojit të instrumentit matës. Deri në muajin tetor nuk është punuar me një plan javor për çdo specialist, por duke filluar prej muajit nëntor është duke u mbajtur një plan javor, për gjithë detyrat që planifikohen të realizohen për javën, si dhe detyrat e realizuar në javën që është mbyllur.

**14. Referuar Paragrafit “Ndikimi i trajnimit dhe kontrollit të cilësisë të DML-së”,** (faqja 54) *“DML në planet e saj mujore ka parashikuar të trajnojë specialistët e saj, por nuk rezultoi të ketë një program trajnimi të përcaktuar që përshkruan sesi trajnohen metrologët e rinj ose të vjetër në secilën disiplinë. Programi dokumentacioni i trajnimit duhet të regjistrohet për të treguar se këto sesione trajnimi kanë ndodhur dhe që identifikon marrësit e trajnimit”.* DML ju bën me dije se pavarësisht se nuk janë dokumentuar apo vërtetuar me certifikata, trajnimet për punonjësit e rinj ndiqen gjithmonë, në të cilët përfshihen njohja me legjislacionin e metrologjisë, punën e tyre, zonën në të cilën do të ushtrojnë shërbimin, planin vjetor dhe mujor, si dhe ajo që është më e rëndësishme ndjekin të paktën 2 javë pune praktike, gjithë procedurat e kryerjes së verifikimeve në terren,



plotësimin e dokumentacionit, certifikatave etj., kjo nën drejtimin e një nëpunësi më të vjetër civil, si dhe për punonjësit të cilët janë pranir në shërbim civil, përgjatë 1 viti të periudhës së provës, janë nën mbikëqyrjen e nëpunësit më të vjetër civil, në njësi ku ai është punësuar.

**15. Referuar gjetjes nr.40,** (faqja 57), *Verifikimi metrologjik i matësve të ujit, përgjatë periudhës 2018-2020 nuk është kryer nga subjektet private të autorizuar nga DPM, për ofrimin e këtij shërbimi, në kundërshtim me Udhëzimin nr.193, datë 09.03.2009 "Mbi frekuencën e verifikimit periodik të instrumenteve matës ligjersht të kontrolluar", DML ju bën me dije se sikurse pasqyrohet edhe në tabelën nr.16. Subjekte të autorizuar dhe verifikimet metrologjike 2018-2020, ofruar prej tyre, Subjektet e autorizuar për verifikim të matësve të ujit kanë ushtruar aktivitet për periudhën 2018-2020, edhe pse jo në ritmet e duhura dhe kjo nuk është për arsye të DPM, sepse nga ana jonë janë marr dhe janë përdoruar të gjitha format e njoftimi, informimit dhe bashkëpunimit me Drejtorinë e Ujësjesave në Bashkitë e Republikës së Shqipërisë, por nuk ka patur bashkëpunim nga ana e tyre.*

## **Drejtoria e Metrologjisë Shkencore dhe Industriale**

### **Gjetja nr. 1**

Lidhur me hartimin dhe miratimin e projekt Vendimit Për njësitë e tjera të matjes jashtë sistemit SI për të përafuar direktivën nr. 2009/3 të KE e cila bën fjalë për temperaturën termodinamike sqarohet:

VKM nr. Nr.1162, datë 13.8.2008 për njësitë e tjera të matjes jashtë sistemit SI është e përafuar me direktivën nr. 2009/3 të KE-së, që kur kjo direktivë ishte draft. Direktiva e vitit 2009/3 CE ka bërë detyrim ligjor përkufizimin e ri të Temperaturës termodinamike që, faktikisht është miratuar nga Organizata Botërore që në vitin 2007 (Rezoluta e CIGPM) por që nga Komisioni Europian u miratua në akt ligjor në vitin 2009. Me pak fjalë përafrimi i direktivës së vitit 2009 është realizuar me kohë.

### **Gjetje 15.**

Referuar planit të veprimit afatgjatë 2016 ó në SNMKMT, nuk janë realizuar objektivat strategjik.

#### ***Hartimi i VKM-s "Për etalonet kombëtare" :***

Strategjia Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Mbikqyrjen e Tregut për periudhën 2015-2020, është hartuar dhe miratuar në vitin 2014, periudhë në të cilën është vendosur si objektivi miratimi i VKM-së për deklarimin e etaloneve kombëtare që ishte i vetmi akt nënligjor që mungonte për të plotësuar paketën ligjore për metrologjin bazuar në Ligjin nr 9875/2008. Ky objektivi është realizuar me hartimin dhe miratimin e VKM-së nr. 1052, datë 23.12.2015 "Për deklarimin e etaloneve kombëtare të matjeve dhe mbajtësit e tyre". Përsa i takon projekt VKM-së për etalonet që është draftuar gjatë vitit 2021 të përmendur në Projekt-Raport, ky draft mbështetet në Ligjin e ri nr. 126/2020. Në përfundim, nuk qëndron gjetja se nuk është realizuar ky objektivi i SNMKMT.

#### ***Hapja e 14 fushave të reja:***

Drejtoria e Metrologjisë Shkencore dhe Industriale (DMSHI) ka hapur fusha të reja të matjeve përkatësisht:

Spektori i Matjeve Dimensionale ka zhvilluar 7 fusha të reja (kalibrimi i metrit shirit, vizoreve metalike, nivelës, diametrit, skuadrës, matjes së lartësisë, blloqe fundore) vetëm në periudhën 2018 ó 2020.

Spektori Elektrik, Termometrisë dhe Lagështires ka zhvilluar 3 fusha të reja për kalibrimin e termometrave me rrezatim, termometra në bllok të thatë dhe termometra në ajër.

#### ***Të sigurojë trajnime të rregullta në 30 fusha, përfshirë metrologjinë dhe pasigurinë:***

Drejtoria e Metrologjisë Shkencore dhe Industriale ka realizuar për specialistet e saj trajnime në fusha dhe tematikë të ndryshme përkatësisht:

- Është bërë e mundur pjesëmarrja e specialistëve të DMSHI-së në Seminarin ndërjegjësues për Harmonizimin rregullator për lehtësimin e Akreditimit të organizuar nga DPA.

- Është bërë e mundur pjesëmarrja e specialistëve të DMSHI-së në Trajnimin për ISO/IEC 17011:2017 të organizuar nga DPA.

- Është bërë e mundur pjesëmarrja e specialistëve të DMSHI-së në Trajnimin për ISO/IEC



17020:2012 dhe akreditimi i trupave inspektuese organizuar nga DPA.

-Disa specialistë të DMSHI-së kanë marrë pjesë në trajnimin e organizuar nga Tajex në bashkëpunim me DPA me fokus në dhënie opiniononi dhe interpretime për standartin ISO/IEC 17025:2017

-Në kuadër të projektit me PTB-në, nga ana e Drejtorisë së Metrologjisë Shkencore është mundësuar dërgimi i dy specialistëve për trajnim pranë Institutit Boshnjak IMBIH. Ky trajnim është zhvilluar në fushën e matjeve elektrike dhe pjesëmarrësit kanë mundësuar praktikisht kalibrime të multimetrit dhe matësve të energjisë elektrike.

- Në kuadër të projektit me PTB-në, është mundësuar trajnimi 4 ditor për dy specialistë të Laboratorit të Matjeve Mekanike në Institutin Grek të Metrologjisë. Trajnimi u realizua për kalibrimin e dhënësve të forcës.

- Në kuadër të projektit me PTB-në, pranë Drejtorisë së Metrologjisë Shkencore është dhënë konsulencë për suportin e laboratorit të Temperaturës me qëllim deklarimin e aftësive matëse kalibruese, ekspertja gjermane Znj.Magda Kamper.

- Në kuadër të projektit me PTB-në, pranë Laboratorit të Matjeve Dimensionale është dhënë konsulencë nga eksperti i PTB-së Z.Christos Bantis për suportin e këtij laboratorit, ndryshimin, implementimin e procedurave teknike sipas standartit të ri ISO/IEC 17025:2017.

-Trajnim për standartin ISO/IEC 17025:2017 e organizuar nga projekti me PTB-në, në bashkëpunim me DMSHI-në gjate muajit Mars 2018.

-Trajnim për ~~Decision Rules~~ në përputhje me Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë nga projekti me PTB.

-Pjesëmarrje në Komitetet Teknike të EURAMETIT sipas fushave përkatëse nga cdo laborator.

-Pjesëmarrje në takimet vjetore të EURAMET dhe OIML-së.

Jane realizuar dhe trajnime të tjera të cilat nuk po i listojmë por që vërtetohen lehtësisht me certifikata pjesëmarrje apo me certifikatat përkatëse të trajnimit.

Drejtoria e Metrologjisë Shkencore dhe Industriale ka ofruar dhe trajnime për palët e interesuara ndër vite dhe konkretisht:

-Trajnim 5 ditor në fushën e presionit për Agjensinë e Metrologjisë së Kosovës,AMK.

-Trajnim për subjekt të jashtëm në fushën e presionit,gjatësisë dhe elektrikut

-Trajnim për subjekt të jashtëm në fushën e presionit dhe forcës.

#### ***Njohja e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë në laboratorët e termometrisë nga EURAMET***

Nuk jemi dakord me këtë gjetje pasi Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ka miratuar Sistemin e Menaxhimit të cilësisë në EURAMET TC-Q, në 2019, pra dhe sistemi i menaxhimit të laboratoreve është i përfshirë si DPM.

DMSHI ka deklaruar 10 CMC, në KCDB BIPM, nga laboratorët e DMSHI; Masa 7, Volum 2, Presion 1, si dhe njohje ndërkombëtare të matjeve dhe certifikatave të kalibrimit në këto fusha, vetëm në periudhën 2018 ó 2020.

#### ***Të sigurojë 10750 kalibrime, në fushat respektive por ka realizuar 7500 kalibrime:***

Drejtoria e Metrologjisë Shkencore dhe Industriale ka ndjekur të njëjtin ritëm në përmbushjen e detyrave të planifikuara për kalibrim instrumentash, por për arsye të lock-down kërkesat e subjekteve janë përgjysmuar. Ju bëjmë me dije se shërbimi i kalibrimit nuk është detyrim ligjor për subjektet që kanë në përdorim instrumenta matës, por është një shërbim vullnetar. Për sa më sipër nuk mund të planifikohet një numër i saktë kalibrimesh qe mund të realizohet brenda një viti kalendarik. Sektorët e DMSHI-se planifikojnë shërbimet e kalibrimit për cdo vit me pritshmëri, referuar realizimit vjetor të fundit.

#### ***Ngritja e laboratorëve të Kohë – frekuencës, të kontrollit të zhurmave dhe të kontrollit të instrumentave matës në fushën e mjeksisë:***

-Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, Drejtoria e Metrologjisë Shkencore ka marrë iniciativën për ngritjen e laboratorit të kohë frekuencës në vitin 2019. Ju bëjmë me dije se nga ana e DMSHI, specialistët e ngarkuar sipas urdhërave përkatës kanë zbatuar të gjithë procedurën e prokurimit deri në vlerësimin e ofertave ku sipas këtij vlerësimi dhe në mbështetje te Ligjit të prokurimit, asnjë operator ekonomik nuk ka rezultuar fitues. Gjithsesi ngritja e këtij laboratorit ka kosto shumë të lartë dhe nuk garanton një efikasitet referuar kërkesave për kalibrim.



-Lidhur me laboratorin e kontrollit të zhurmave Ju bëjmë me dije se nga viti 2013 e deri me sot ne DPM nuk është protokolluar qoftë edhe një kërkesë e vetme për kalibrimin apo verifikimin e ndonjë instrumenti matës për matjen e zhurmave. Në Republikën e Shqipërisë operojnë laboratore të institucioneve shtetërore dhe private që mbulojnë këtë fushë, kësaj nuk është e nevojshme për investim jo-produktiv.

-Gjatë vitit 2020 në bashkëpunim me Insitutin e Metrologjisë Gjermane (PTB) dhe vendet e rajonit, DMSHI do të merrte pjesë në projektin rajonal ÷Consultancy fund quality infrastructureö (qi) ó south east Europe, Metrology for medical device. Ky projekt do të krijonte mundësinë për realizimin e procedurave teknike për kalibrim të instrumentave matës në mjeksi, krahasime ndërlaboratorike, dhurim instrumentash etj. Në fushën e mjekësisë DMSHI ka hapur një fushë të re për kalibrimin e termometrave me rrezatim. Nga ana e PTB është suportuar kjo fushë duke dhuruar etalonet referencë për kalibrimin e instrumentave të cituar.

***Akreditimi i laboratorëve sipas fushave përkatëse nga trupa akredituese nënshkruese të MLA me EA në fushën e kalibrimeve.***

Drejtoria e Metrologjisë Shkencore falë bashkëpunimit (projektit) me PTB, Institutin Kombëtar të Metrologjisë Gjermane kanë përcaktuar si objektiv kryesor deklarin e aftësive matëse dhe kalibruese në KCDB BIPM.

Falë këtij bashkëpunimi dhe me kosto zero në buxhetin e shtetit, pas shumë auditimeve nga ekspertë ndërkombëtar, është arritur që për herë të parë, DPM-ja të ketë të deklaruara 10 CMC, në KCDB BIPM, nga laboratorët e DMSHI; Masa 7, Volum 2, Presion 1, si dhe njohje ndërkombëtare të matjeve në këto fusha. Çertifikatat e kalibrimit të lëshuara nga këta laboratorë njihen ndërkombëtarisht.

Laboratorët e etaloneve kombëtare të matjeve në DMSHI e domonstrojnë dhe dokumentojnë aktivitetin e tyre në përputhje me kërkesat e standartit ISO/IEC 17025:2017 ~~÷Kërkesat e përgjithshme për kompetencën e laboratorëve të testimit dhe kalibrimit÷~~ dhe të Marrëveshjes së Njohjes së Ndërsjelltë të etaloneve të matjeve dhe certifikatave të kalibrimit të lëshuara nga Institutet Kombëtare të Metrologjisë (CIPM MRA)

Vetë-deklarimi i Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë, vlerësimi dhe njohja formale e tij nga strukturat Evropiane dhe ndërkombëtare të metrologjisë përbën nivelin më të lartë të vlerësimit të kompetencës teknike të laboratorëve. Kjo provohet me publikimin e CMC-ve në databazën ndërkombëtare të aftësive matëse dhe kalibruese (BIPM KCDB). Këtë të drejtë e kanë vetëm Institutet Kombëtare të Metrologjisë të shteteve pjesmarrëse dhe nënshkruese të Marrëveshjes shumëpalëshe CIPM MRA, që përbëjnë nivelin më të lartë metrologjik dhe sigurimit të gjurmueshmërisë në shtetet përkatëse.

DPM/DMSHI ka demonstruar kompetencën teknike të laboratorëve të saj nëpërmjet deklarin të CMC-ve bazuar në detyrimin ligjor konkretisht në Ligjin nr. 9875, datë 14.02.2005, pika 2 e nenit 14 ku cilësohet:

***Aftësia teknike e laboratorëve të etaloneve kombëtare të matjeve ruhet nëpërmjet pjesëmarrjes në veprimtaritë metrologjike ndërkombëtare dhe provohet me akreditim apo në një mënyrë tjetër të barazvlefshme.*** Referuar terminologjisë së përdorur nga të gjithë udhëzuesit, rekomandimet e organizatave ndërkombëtare të fushës, mënyrë e barazvlefshme me akreditimin është vetë-deklarimi në strukturat evropiane (EURAMET) dhe ndërkombëtare të metrologjisë (BIPM).

Në nivel ndërkombëtar, kompetenca teknike e laboratorëve kalibrues (kur ato janë pjesë e instituteve kombëtare të metrologjisë së shteteve anëtare) në radhë të parë demonstron me deklarin e CMC-ve në databazën ndërkombëtare KCDB, ndërsa akreditimi është mekanizimi që përdoret rëndom për laboratorët e niveleve të tjera që e sigurojnë gjurmueshmërinë nga laboratorët e etaloneve kombëtare të matjeve..

Për më tepër, bashkëlidhur ju vëmë në dispozicion Deklaratën e Përbashkë të katër organizatave botërore të metrologjisë (BIPM dhe OIML), standardizimit (ISO) dhe akreditimit (ILAC) lidhur me njohjen ndërkombëtare të kalibrimeve nënshkruar në vitin 2011, ku cilësohet:

*“BIPM, OIML, ILAC dhe ISO bien dakord si më poshtë në mënyrë që të pranohen në nivel ndërkombëtar, kalibrimet duhet të kryhen :*



*në Institutet Kombëtare të Metrologjisë, të cilët normalisht duhet të jenë nënshkrues të CIPM MRA dhe kanë CMC të publikuara në fushat përkatëse në BIPM KCDB, ose në laboratorë të akredituar nga organet akredituese të cilat janë nënshkruese të ILAC MLA-për kalibrimet.*

*NMI-të që ofrojnë gjurmueshmëri për laboratorët e akredituar normalisht duhet të jenë nënshkruese të CIPM MRA dhe kanë CMC të publikuara në fushat përkatëse të KCDB-së;*

Sa me sipër,

Vetëdeklarimi i SMC dhe publikimi i CMC-ve është metoda që aplikohet nga të gjithë shtetet anëtare të EURAMET dhe të marrëveshjes CIPM MRA, përsa i takon laboratorëve të etaloneve kombëtare të matjeve. DPM e ka përmbushur këtë objektiv bazuar në detyrimin Ligjor, të sipërcituar (Ligji nr 9875 /2008, neni 14, pika 2). Përsa i takon akreditimit të laboratorëve nga DPA sqarojme se akreditimi i laboratorëve kalibruar që lë DPA nuk njihet dhe pranohet jashtë territorit të Shqipërisë. Akreditimi i laboratorëve të DPM-së është pezulluar gjatë vitit 2020, edhe pse ishin planifikuar të akreditoheshin minimalisht 6 laboratorë, temperaturë, lagështi, matje dimensionale, forcë, kimi, elektrik, për shkak të situatës së krijuar nga pandemia COVID 19. I gjithë dokumentacioni i laboratorëve të DMSHI është demonstruar periodikisht pranë ekspertëve të huaj, por për shkak të situatës së krijuar ekspertë kanë shtyrë vizitat vlerësuese. Edhe pse në vitin 2016 DMSHI ka pasur katër laboratorë të akredituar nga DPA (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit) të cilat ishin me vlefshmëri 4 vjecare, **ka hequr dorë nga ky akreditim** pasi DPA nuk është firmëtare e EA-MLA për laboratorët kalibruar.

**Zgjerimi i bazës etalonuese në 7 fusha të reja matje: Laboratorin e masës, elektrikut, rrjedhjeve, optikës, përdredhjes, gjatë dhe presionit.**

-Për laboratorin e temperaturës:

PTB ka mundësuar dhurimin e pajisjeve si kalibrator për kalibrimin e termometrave me rrezatim, 10 sensorë referencë PT 100 për kalibrim në ajër

Aksesorë plotësues për pajisjen reference të laboratorit të lagështisë.

-Për laboratorin e matjeve dimensionale (gjatësisë):

Riparim i pajisjes komparator EMP II të laboratorit të gjatësisë nga prodhuesi Feimess Suhl.

Me certificate kalibrimi nga DAkkS.

Software QM SOFT për database dhe kalibrimin e etaloneve të gjatësisë.

Kjo është pajisja bazë për kalibrime në nivel primar të etaloneve të gjatësisë në kufijtë 0.5 ó 100 mm, me qëllim pjesmarrjen në ndërkrasim ILC dhe finalizimi me deklarin e CMC në fushën e gjatësisë.

- Për laboratorin e volumeve :

PTB ka dhuruar sondë për matjen e presionit Ahlborn 2690-8 me certificate kalibrimi nga PTB.

Aparat për matjen e trashësisë së llamarinës MT 150 me certificate kalibrimi, prokuruar nga DPM.

Metër shirit metalik 100 m me certificate kalibrimi, prokuruar nga DPM.

Metër shirit metalik 200 m me certificate kalibrimi, prokuruar nga DPM.

-Për sa i përket ngritjes së fushës së matjeve për kalibrimin e radarëve DMSHI dhe Sektori i Matjeve Dimensionale, DPM ngriti grupin e punës për këtë qëllim por procesi nuk u finalizua sepse pajisjet, specifikimet dhe kostot për ngritjen e tij ishin pothuaj të pamundura pasi kompanitë prodhuese refuzuan të japin oferta çmimi për pajisjet, referuar numrit dhe llojit të instrumentëve për shërbime kalibrimi.

### **\*Gjurmueshmeria në infrastrukturën e DPM**

Në projekt raportin e auditimit të performancës nga grupi auditues, është shtjelluar aktiviteti i DMSHI dhe konkretisht, në faqen nr 46 është shënuar:

DPM është akredituar me certifikatë ISO/IEC 17025 (e vlefshme për testim, jo kalibrim) në Laboratorin e Forcë, Presionit, Volumeve, Masës, që nga viti 2016 lëshuar nga DPA, por që aktualisht këtij akreditimi i ka mbaruar afati. Për sa më lart kundërshtojmë pasi kërkesat e standartit 17025 zbatohen për laboratorët testues por edhe për laboratorë kalibruar ISO/IEC 17025:2017 ÷General requirements for the competence of testing and calibration laboratories. Gjithashtu DPM ka hequr dorë nga akreditimi i realizuar në vitin 2016 nga Drejtoria e Pë e Akreditimit DPA, duke qenë se kjo e fundit nuk është firmëtare e EA-MLA. Certifikatat e kalibrimit të lëshuara nga



laboratorët nuk njiheshin ndërkombëtarisht apo nga vetë DPA. Të ndodhur në këto kushte DMSHI vendosi të deklaronte aftësite matëse kalibruese CMC edhe pse ishte rrugë më e vështirë dhe e më e gjatë në kohë. **Një kërkesë tjetër kryesore për një laborator kalibrimi për tu akredituar është shpallja më parë dhe aprovimi i CMC, që është krahasueshmë ndërlaboratorike.**

Nuk jemi dakord me gjetjen pasi formulimi nga ana e KLSH nuk qëndron si koncept për ILC (Inter-laboratory comparisons). Gjetja e cituar më sipër nga KLSH është jashtë çdo konteksti dhe përputhshmërie me terminologjinë në metrologji. DPM është shumë e qartë në planifikimin për pjesmarje në ndërkrahime ILC, dhe qasjes përkatëse për deklarim të CMC-ve apo akreditim, nga laboratorët e saj.

#### **\*Ndikimi i efektivitetit të shërbimit të kalibrimit nga laboratorët e DMSHI-së**

**Nga të dhënat në planet vjetore të punës të DMSHI-se rezulton se: DMSHI nuk ka detajuar në planet vjetore numrin e kalibrimeve.**

Drejtoria e Metrologjisë Shkencore dhe Industriale përveç planit të veprimit detajon në plan më vete në formë të detajuar planet e kalibrimit të instrumentave dhe konkretisht mund ti vendosim në dispozicion. Në këtë plan të miratuar, detajohen llojet e instrumentave, numrin e tyre dhe të ardhurat që planifikohen të realizohen. Në zbatim të Ligjit të Metrologjisë dhe rekomandimeve ndërkombëtare, kalibrimi realizohet vetë me kërkesën e përdoruesit të instrumentit matës. Ky shërbim është vullnetar dhe nuk është detyrim ligjor për subjektet që kanë në përdorim instrumenta matës. Teknikisht dhe referuar planeve të NMI (National Metrology Institute) nuk mund të jepet një numër kalibrimesh si planifikim pasi në asnjë rast nuk mund të realizohet. Planet nga sektorët hartohen në bazë të realizimeve vjetore të mëparshme si të pritshëm, ku mund të ketë tejkalim ose më pak kalibrime se planifikimi. Kjo varet nga kërkesat e subjekteve ndaj sistemit të tyre të cilësisë dhe sigurimit të gjurmueshmërisë së matjes për matjet e tyre. DMSHI nuk ka ndonjë rast ku kalibrimi të mos jetë kryer sipas kërkesave të subjekteve. DMSHI rishikon çdo kërkesë dhe bie dakord me subjektin për instrumentat që mbulon me shërbim kalibrimi dhe pas kësaj nis praktikën e procesit të kalibrimit dhe lëshimit të certifikatave përkatëse.

#### **Gjetjet e grupit të auditimit faqe 48**

Nuk jemi dakort me konstatimin dhe krahasimin që auditimi ka bërë me Metrologjitë e tjera për sa më poshtë:

DMSHI dhe Sektorët e saj nuk kryejnë vetëm shërbimin e kalibrimit por një volum pune shumë më të madh si ruajtja, mbajtja e etaloneve kombëtare, kryerja e krahasimeve kyce ndërlaboratorike të organizuara në kuadër të EURAMET, kryerja e ILC të tjera dhe testeve të zotësisë, sigurimi i cilësisë së matjeve dokumentuar sipas kërkesave të standartit 17025:2017. Aktivitet e mësipërme janë aktivitet kryesore me një volum prej 60 % të punës së laboratorëve në të gjithë botën.

Krahasimi me Bullgarinë është komplet i gabuar pasi linku, në të cilin jeni referuar është i organizatë WELMEC, e cila është një organizatë për metrologjinë ligjore në Europë (<https://www.welmecc.org/legal-metrology-information/country-information/country/bulgaria/>). Tek ky link nuk jepet sa numër punonjësish dhe sa shërbime kalibrimi kryen për një vit National Centre of Metrology' (DG NCM), Bullgari, ekuivalente me DMSHI.

Për sa më sipër keni krahasuar Drejtorinë e Metrologjisë Ligjore, Bullgari, pra kryerjen e verifikimeve të instrumentave ligjorisht të kontrolluar, me Drejtorinë e Metrologjisë Shkencore në Shqipëri, kryerjen e kalibrimeve të instrumentave. E thënë ndryshe është krahasuar një shërbim që në cdo vend të botë është detyrim ligjor verifikimi, me një shërbim që në cdo vend të botë është shërbim vullnetar kalibrimi.

Vlen të theksojmë se numri i kalibrimeve të realizuara nuk mund të krahasohet me numër banorësh pasi dhe Institutet Metrologjike ndër më të mirat në botë do të dilnin me një performancë shumë të dobë dhe konkretisht:

-National Metrology Institute (UME), Turqi.

-Popullsia 85,667,433 banorë

-Kalibrime në vit 4500

-Punonjës që realizojnë kalibrimet 225.

Numri kalibrimeve nuk ka lidhje në asnjë rast me numrin e banorëve, por me infrastrukturën e cilësisë së një ekonomie.



### **Qëndrimi i Audituesve Shtetëror të KLSH-së:**

Lidhur me observacionet e bëra nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, si fillim sqarojmë:

-Vlerësimi i riskut pasqyruar në tabelën SWOT, është vlerësim që bëhet mbi gjykimin e audituesit, i cili bazohet në njohuri, analiza dhe eksperiencë.

-Sa i përket observacioneve të bëra nga ju mbi konkluzionet/paragrafë të caktuar në brendësi të Projekt Raportit të auditimit, sqarojmë se konkluzionet janë formulim që vjen nga gjykimi i grupit të auditimit mbi efektet që kanë ndodhur/mund të ndodhin, si rezultat i gjetjes audituese.

-Sa i përket observacioneve të bëra për rekomandimet e auditimit, sqarojmë se për të dhënë qëndrimin tuaj mbi rekomandimet e auditimit, keni mundësinë që pas dërgimit të raportit përfundimtar të auditimit, brenda 20 ditëve, të shpreheni, pra pranimin/jo të tyre, arsyetimin përse nuk pranohet, si dhe masat që do të merrni ju në vazhdim për zbatimin e tyre. Pra nuk jemi ndalur në observacionet e bëra nga ju në rekomandimet e auditimit. Pra jemi ndalur vetëm në observacionet e bëra për gjetjet e auditimit, të cilat lidhen drejtëpërdrejtë me konkluzionet dhe rekomandimet e auditimit. Gjithashtu theksojmë se jemi ndalur në ato observacione, për të cilat ka fakte dhe dokumentacion shoqërues, dhe jo në ato që konfirmojnë gjetjet audituese.

-Në programin e auditimit e kemi përcaktuar se qasja audituese do të orientohet drejt rezultatit dhe drejt problemit, që do të thotë se kemi audituar rezultatet e arritura dhe jo problemin që ka ndikuar në mosarritjen e rezultateve. Pra në realizimin ose jo të objektivave strategjik, kemi audituar nëse janë arritur objektivat apo jo. Informacionin mbi realizimin e tyre, pasqyruar në raportin përfundimtar të monitorimit të zbatimit të Strategjisë për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Mbikëqyrjen e Tregut 2014-2020, e kemi marrë nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë, pasi në intervistën e drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të DPM më datë 13.09.2021, konkretisht pyetja nr.32, nuk kemi marrë përgjigje nga ju.

-Sa i përket termit të përdorur nga grupi i auditimit òmetrologò dhe jo òspecialistò siç jeni shprehur ju, sqarojmë se i jemi referuar termit të përdorur në nenin 46 të Ligjit nr.9875, datë 14.02.2008 òPër Metrologjinëò, i ndryshuar, në fuqi deri në muajin Dhjetor të vitit 2020.

-Lidhur me observacionin e bërë nga **Drejtoria e Sigurimit të Cilësisë dhe Parapaketimeve**, sqarojmë se për trajnimet, i referohemi trajnimeve që organizon vetë institucioni për punonjësit e tij. Pra hartimin dhe miratimin e një programi vjetor të trajnimeve, në zbatim të të cilit dalin programet mujore/3 mujore të trajnimit, ku përcaktohet fokus grupi, tema e trajnimit, trajnuesi. Pra nuk i jemi referuar trajnimeve/takimeve që DPM ftohet nga institucione ndërkombëtare.

### **Observacioni juaj për këtë gjetje nuk merret në konsideratë.**

-Sa i përket observacionit mbi gjetjen audituese se, ònuk janë kryer kalibrime...ò, ku ju shpreheni se sektori i parapaketimeve nuk kryhen kalibrime, sqarojmë se ka qenë një lapsus i grupit të auditimit dhe është korrigjuar, ku termi òkalibrimeò është bërë òtestimeò, referuar përcaktimit të bërë për detyrat e sektorit të parapaketimeve në Rregulloren e Brendshme të DPM nr.104/1, datë 07.02.2014, specialisti kryen testime në laborator....

### **Observacioni juaj merret në konsideratë pjesërisht, pra vetëm për llojin e funksionit.**

-Sa i përket observacionit mbi gjetjen audituese se, nuk janë kryer matje të kontrollit statistikor në linjat e prodhimit të parapaketimeve, sqarojmë se pas shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ju, **observacioni merret në konsideratë**, dhe është bërë ndryshimi përkatës në Raportin e Auditimit.

-Sa i përket observacionit mbi gjetjen audituese se, nuk janë miratuar ndryshimet në udhëzimin të Ministrisë MZHETTS nr.1897/3, datë 03.08.2016, si dhe informacionit të pasqyruar për miratimin e ndryshimeve të këtij udhëzimi, të cilat janë miratuar në muajin Janar të vitit 2021, **merret në konsideratë**.

### **Lidhur me observacionet e bëra nga Drejtoria e Metrologjisë Ligjore:**

-Sa i përket observacionit referuar gjetjes nr.28 "*Procedura e faturimit të shërbimit të verifikimit të instrumentave matës kryhet sipas një rregullorje të brendshme të vitit 2010...*", nuk jemi ndalur pasi ju e keni pranuar problemin e rezultuar.


-Sa i përket observacionit të bërë për tabelën e realizimit të objektivave, **në faqjen 36 tek elementi i tretë, Produktet e DPM, pika 4**, sqarojmë se, numri i planifikuar në tabelën përkatëse, është numri i cili duhej të planifikohet nga DPM për verifikimin e instrumenteve matëse, referuar



objektivit të vendosur në SNMKMT 2014-2020, për të realizuar objektivin, rritje me 10% çdo vit të numrit të verifikimeve. Sa i përket numrit të verifikimeve pasqyruar në kapitullin 2.1 "Hyrje në subjektet në auditim", sqarojmë se ajo është bërë në vlera të përafërta, me qëllim pasqyrimin e informacionit mbi aktivitetin e institucionit, gjithësesi është korrigjuar.

#### **Pra observacioni merret në konsideratë pjesërisht.**

-Sa i përket observacionit referuar gjetjes 17, (faqja 42), "Në fund të vitit 2020, rezultojnë që të punësuarit në sektorin e Drejtorisë së Metrologjisë Ligjore (DML) që kryejnë verifikimin metrologjik, të cilët nuk kanë formimin arsimor sipas kërkesave të Urdhrit të Ministrit të METE nr.192, datë 09.03.2008 "Për përcaktimin e kriterëve të përgjithshme që duhet të përmbushë kandidati për t'u kualifikuar si "metrolog i autorizuar", janë rreth 25 punonjës nga 53 të punësuar efektivisht, ose rreth 47%", si fillim në kërkesën për dokumentacion drejtuar DPM më datë 11.06.2021, konkretisht kërkesa nr.5, përgjigjia e bërë nga zj.Oriela Shishi, përgjegjëse e sektorit juridik dhe integritit në DPM, ka qenë se baza ligjore që lidhet me aktivitetin e DPM, është e publikuar në faqen zyrtare të DPM. Nga verifikimi i kryer në faqen zyrtare të DPM, rezultoi se ky akt nënligjor ka qenë i publikuar. Pra sipas observacionit tuaj, rezultoi se, ju në faqen zyrtare të institucionit publikoni akte nënligjore të shfuqizuara.



Për më tepër që pika 3 e nenit 46 në Ligjin nr.9875, datë 14.02.2008 për metrologjinë në fuqi deri në muajin Dhjetor 2020, në zbatim të të cilës ka dalë edhe urdhri i referuar nga grupi i auditimit nuk është shfuqizuar në asnjë prej 5 ndryshimeve që ka pësuar Ligji nr.9875, datë 14.02.2008 për metrologjinë.

#### **Pra observacioni juaj nuk merret në konsideratë.**

-Sa i përket observacionit të bërë për gjetjen nr.22 "Specialistët e laboratorëve të masës, që gjenden pranë Sektorëve Rajonal Lezhë, Fier dhe Korçë (në Sektorin Rajonal të Tiranës, nuk ka ambiente dhe pajisjeve laboratorike) të DPM, përgjatë periudhës 2018-2020, nuk kanë kryer asnjë shërbim laboratorik", sqarojmë se, që në krye të herës e kemi cituar se këta janë specialist të laboratorit dhe funksioni i tyre lidhet me pajisjet laboratorike, për të cilat janë shpenzuar fonde publike, me qëllim që pranë këtyre sektorëve të kryhen shërbime laboratorike, dhe jo të kryhen vetëm në Drejtorinë e Përgjithshme, ndërkohë që nuk janë kryer pranë këtyre sektorëve.

#### **Pra observacioni juaj nuk merret në konsideratë.**

-Sa i përket observacionit tuaj referuar paragrafi 5, (faqja 51) "Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i planeve vjetore të punës së DML-së të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i DPM-së, rezultoi se për vitet 2018 dhe 2019 nuk është përcaktuar numri i verifikimeve periodike që planifikohen të kryhen për vitet 2018, 2019, ndryshe nga viti 2020, në të cilin është planifikuar të verifikohen 46100 instrumente matës të peshave dhe matjeve", sqarojmë se, i kemi referuar planeve vjetore të punës për DML, në të cilat, përjashtuar vetëm vitin 2020, nuk është pasqyruar numri i verifikimeve që do të kryejnë DML.





### **Pra observacioni juaj nuk merret në konsideratë.**

-Sa i përket observacionit tuaj referuar paragrafit 8, (faqja 51) "*Sipas të dhënave të DML, subjekte private, të cilët kanë në përdorim në aktivitetin e tyre instrumente matës ligjërish të kontrolluar, për vitin 2018 janë 23180 subjekte, vitin 2019 -23139 subjekte, vitin 2020 – 21683 Subjete. Nga të dhënat e INSTAT-it në Shqipëri në vitin 2018 kanë ushtruar aktivitet 107450 subjekte private, nga të cilat 63407 subjekte tregtare, akomodim dhe shërbime ushqimore. Në vitin 2019 kanë ushtruar aktivitet 104090 subjekte biznesi gjithsej, nga të cilat 59053 subjekte tregatë, akomodim dhe shërbime ushqimore*"., sqarojmë se, ju nuk keni pasqyruar asnjë fakt mbi argumentin tuaj.

### **Pra observacioni juaj nuk merret në konsideratë.**

-Sa i përket observacionit tuaj, referuar gjetjes nr.32, "*Në Drejtorinë e Metrologjisë Ligjore dhe në të gjithë sektorët rajonal, informacioni mbi punën e kryer përgatitet manualisht, si dhe nuk administrohet në mënyrë elektronike, duke mbartur risk operacional të humbjes/keqpërdorjes*", sqarojmë se, gjetja audituese nuk lidhet me çfarë dinë/jo përgjegjësi i sektorit/drejtori i drejtorisë, por me krijimin e një databaze, në të cilën të jepet informacioni mbi datën e verifikimit, metrologun, subjektin, instrumentin, vendndodhjen, rezultatet e matjeve, etj.

### **Pra observacioni juaj nuk merret në konsideratë.**

-Sa i përket observacionit tuaj, referuar gjetjes nr.40, (faqja 57), *Verifikimi metrologjik i matësve të ujit, përgjatë periudhës 2018-2020 nuk është kryer nga subjektet private të autorizuar nga DPM, për ofrimin e këtij shërbimi, në kundërshtim me Udhëzimin nr.193, datë 09.03.2009 "Mbi frekuencën e verifikimit periodik të instrumenteve matës ligjërish të kontrolluar"*, grupi i auditimit e ka cituar dërgimin nga DPM të shkresave njoftuese në Bashkitë e RSH-së, por kjo është e pamjaftueshme, pasi mënyra e veprimit në të tilla raste, ka qenë e përcaktuar në nenin 42 të ligjit nr.9875, datë 14.02.2008.

### **Pra observacioni juaj nuk merret në konsideratë.**

### **Lidhur me observacionet e bëra nga Drejtoria e Metrologjisë Shkencore dhe Industriale:**

-Sa i përket observacionit të bërë referuar gjetjes nr. 1 "*Lidhur me hartimin dhe miratimin e projekt Vendimit Për njësitë e tjera të matjes jashtë sistemit SI për të përafshuar direktivën nr. 2009/3 të KE e cila bën fjalë për temperaturën termodinamike*", sqarojmë se, hartimi dhe miratimi i këtij akti ka qenë i parashikuar në PKIE 2019-2021, pra ju vetë e keni parashikuar, pasi keni qenë pjesë e grupit të punës ngritur nëpërmjet Urdhrit nr.94, datë 20.05.2019 të Kryeministrit të RSH-së.

### **Pra observacioni juaj nuk merret në konsideratë.**

-Sa i përket observacionit të bërë mbi realizimin e objektivave strategjik, sqarojmë se pas kryerjes së verifikimit, merret në konsideratë vetëm objektivi për hartimin e VKM-së për etalonët dhe zgjerimin e bazës etalonuese në fushën e gjatësisë dhe sistemit i menaxhimit të cilësisë.

Lidhur me argumentet e tjera sqarojmë se, kalibrimi i metrit shirit, vizoreve, metalike, nivelës, diametrit, skuadrës, matjes së lartësisë, blloqe fundore, termometrave me rrezatim, termometra në bllok të thatë dhe termometra në ajër, nuk janë fusha të reja matje, por nënfusha të fushave kryesore.

Lidhur me argumentin për trajnimet, sqarojmë se objektivi është për industrinë dhe jo për specialist të DPM-së apo për Agjencinë e Metrologjisë së Kosovës. Sa i përket trajnimeve për subjekt të jashtëm në fushën e presionit, gjatësisë dhe elektrikut dhe forcës, sqarojmë se në observacionin e bërë nuk ka dokumentacion bashkëlidhur, që të justifikojë argumentin.

-Lidhur me objektivin për akreditimin e laboratorëve sipas fushave përkatëse nga trupa akredituese nënshkruese të MLA me EA, sqarojmë se, grupi i auditimit është bazuar në një objektivi të vendosur në një dokument zyrtar të miratuar me VKM nr.753, datë 16.9.2015. Në vijim të këtij objektivi, për RSH nënshkrues i marrëveshjes MLA me EA është Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, e cila është nënshkruese e kësaj marrëveshje, për ofrimin e akreditimit të laboratorëve testues. Gjithashtu për të vijuar me argumentin tuaj, që një laborator të akreditohet, janë të nevojshme krahasimet ndërlaboratorike, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga ana juaj, rezulton se për një pjesë të konsiderueshme të pajisjeve laboratorike të DPM nuk janë kryer krahasime ndërlaboratorike. Përshëmbull keni kryer në vitin 2020 për pajisjen *ësensore temperature PT100\_1ö*, pra për 1 instrument nga 10 që keni për fushën e lagështirës, për fushën e rrjedhjeve nuk keni kryer, për



fushën e elektrikut nuk keni kryer, për fushën e volumeve keni kryer në muajin Shkurt të vitit 2021, pra jashtë periudhës objekt auditimi, etj. Për më tepër pasqyrojmë komunikimin elektronik të grupit të auditimit me koordinatorin e ILAC (Organizata Ndërkombëtare për Akreditimin e Laboratorëve), si më poshtë vijon:

From: E.D  
Sent: Wednesday, 13 October 2021 11:09 PM  
To: ilac  
Subject: Albania Accreditation Body

Hello Mrs/Mr

For audit proposed i want to know if the Albania Accreditation Body can issue an accreditation certificate ISO/IEC 17025 for Calibration Laboratories or only for testing laboratories? I will greatly appreciate your reply.

Thank you

From: ilac  
Sent: Friday, October 15, 2021 6:38 AM  
To: E.D  
Cc: ilac  
Subject: RE: Albania Accreditation Body

Dear E

The accreditation body in Albania, DPA, is currently a signatory to the ILAC MRA for the accreditation of testing laboratories using ISO/IEC 17025 and inspection bodies using ISO/IEC 17020: <https://ilac.org/signatory-search/>.

The accreditation of calibration bodies using ISO/IEC 17025 is not currently covered by the signatory status of DPA to the ILAC MRA, this does not however mean DPA does not offer accreditation for this activity. If you would like to discuss this with DPA, the contact details are:

DPA General Directorate of Accreditation Contact Name: Majlinda Xhema, Public Relation and International Affairs

Phone: +355 4 22 69097

Website: <http://www.dpa.gov.al>

Social Media: Accredited Facilities: <http://dpa.gov.al/organe-te-akredituara/> Full Member (ILAC MRA signatory) Information on the acceptance of results via the ILAC MRA is available from <https://ilac.org/ilac-mra-and-signatories/accredited-conformity-assessment-bodies/>

Kind regards

S.K

Senior Coordinator, ILAC Secretariat

PO Box 7507 | Silverwater | NSW 2128 | Australia

+61 2 9736 8374 | [www.ilac.org](http://www.ilac.org) <<http://www.ilac.org/>>

#### **Pra observacioni juaj nuk merret në konsideratë.**

-Sa i përket observacionit tuaj, mbi krahasimin që ka bërë grupi i auditimit të DPM me institucionin e metrologjisë në Bullgari, sqarojmë se në linkun përkatës që ka referuar grupi i auditimit jepet informacioni mbi metrologjinë në këtë Shtet<sup>62</sup>. Konkretisht informacioni i pasqyruar: 176 employees of BIM are in charge of legal metrology activities in the country. 20 of them carry out testing and other activities needed for the type approval process (20 prej tyre kryejnë testime dhe aktivitete të tjera të nevojshme për procesin e miratimit të tipit, detyra të cilat i përkasin DMSHI), and 156 deal with initial verification and reverification as well as metrological expertise of measuring instruments. The personnel of DG MS consist of 72 engineers, physicists and chemists who perform all tasks of SAMTS related to legal metrology. They have past training in EN ISO/IEC 17025 and EN ISO 19011. The majority of inspectors have previous experience as verification officers.

<sup>62</sup> <https://www.welmec.org/legal-metrology-information/country-information/country/bulgaria/>



-Lidhur me zgjedhjen e grupit të auditimit të shtetit të Bullgarisë, sqarojmë se grupi i auditimit gjatë vendosjes së kriterëve, përdorë gjykimin e vet për të filtruar setin më të mirë të mundshëm në bazë të informacioneve që disponon. Praktikrat më të mira/praktikat e mira janë pjesë e kriterëve audituese në Auditimin e Performancës (për më tepër referohu manualit të Auditimit të Performancës, publikuar në faqen zyrtare të KLSH-së). Rasti i Bullgarisë është zgjedhur, pasi është vend i rajonit, shtet anëtar i BE-së, nënshkruës i memorandumit të WELMEC dhe anëtar i EURAMET, etj.

**Pra observacioni juaj nuk merret në konsideratë.**

Tabela nr.1

Sektori Rajonal Lezhë										
Nr	Laboratori	Nr i Personelit	Në funksion		Shërbimet e kryera prej tij në vitin 2020 (Nr)	Të ardhurat e gjeneruara për vitin 2020	Shpenzimet			
			Po	Jo			Paga	Sigurime shënd dhe shoq.	Investime	Elektricitet
1	Mases-Specialist T.N	1			705	990 335 leke te siguruar nga matje ne teren jo laborator	816,480	136,356	-	20,028 lekë
Sektori Rajonal Korçë										
Nr	Laboratori	Nr i Personelit	Në funksion		Shërbimet e kryera prej tij në vitin 2020 (Nr)	Të ardhurat e gjeneruara për vitin 2020	Shpenzimet			
			Po	Jo			Paga	Sigurime shënd dhe shoq.	Investime	Elektricitet
1	Mases-Specialist A.M	1			593	1 213 210 leke te siguruar nga matje ne teren jo laborator	840,000	140,280	-	89,451 leke
Sektori Rajonal Fier										
Nr	Laboratori	Nr i Personelit	Në funksion		Shërbimet e kryera prej tij në vitin 2020 (Nr)	Të ardhurat e gjeneruara për vitin 2020	Shpenzimet			
			Po	Jo			Paga	Sigurime shënd dhe shoq.	Investime	Elektricitet
1	Mases-Specialist I.B	1			405	2 062 700 leke te siguruar nga matje ne teren jo laborator	840,000	140,280	-	10, 828 leke

Burimi: DPM, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

## 7. GRUPI I PUNËS

1. Z. K.K, Përgjegjës grupi.
2. Z. E.D, Anëtar.

**DREJTOR I DEPARTAMENTIT**

A.J